



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikëna Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Shënim 2: Nuk mori pjesë në pikën e parë anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI).*
- 7. Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 8. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Përhëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, sot është mbledhja e radhës e këtij Këshilli.

Paraprakisht ju bëj me dije që për shkak të angazhimeve institucionale, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është prezent në këtë mbledhje, dhe mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Njëkohësisht ju bëj me dije se zoti Kurushi është në një trajnim dhe ka njoftuar që përgjatë mbledhjes do të jetë prezent. Në momentin që do të jetë prezent do të bëhet edhe publike prezenca e tij me të tretët.

Sipas rendit të ditës fillojmë me pikën e parë të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën si relatore znj. Petriti, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore.

Etrita Petriti: Të nderuar!

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neni 221, parashikohet, jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikon dhe i dërgon listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në Kuvendin e Shqipërisë dhe tek Presidenti i Republikës.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, në kuadër të legjislacionit në fuqi ka marrë hapat e nevojshme duke iu referuar pikës 1, të nenit 221 të ligjit të sipërcituar ku përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në shortin e përzgjedhjes së anëtarëve të KED të cilat janë:

a) në kohën e hedhjes së shortit magjistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 10 vjet;

b) nuk ka masë disiplinore në fuqi;

c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;

d) magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme;

e) magjistrati nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

f) magjistrati nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka përgatitur listën për magjistratët e gjykatave të apeleve dhe gjykatave administrative të cilët plotësojnë kriterin e 10 viteve në ushtrimin e detyrës, që nuk kanë masa disiplinore në fuqi dhe që janë vlerësuar të paktën shumë mirë në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme.

Gjithashtu u plotësua dhe lista me magjistratët që në zbatim të legjislacionit nuk plotësonin kriteret për të marrë pjesë në shortin e përzgjedhjes së anëtarëve të KED, dhe më konkretisht nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë në detyrë si dhe magjistratë të shkarkuar nga KPK, të cilët janë të pezulluar për shkak të ligjit nr.84/2016.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka hartuar shkresat për të kërkuar informacion në institucionet si, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) si dhe Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje me pikat “c” “d” “dh” të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, konkretisht nëse plotësojnë kushtet:

- a) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;
- b) magjistrati nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- c) magjistrati nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 01.11.2023 iu kërkua informacion Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e cila me shkresën nr. {...} prot., datë 03.11.2023, protokolluar me tonën nr. {...} prot., datë 06.11.2023 citon se: “Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezulton që të jenë aktualisht në hetim apo të jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjyqtarët (sipas listës së përcjellë nga Drejtoria e Burimeve) të cilët do të përfshihen në shortin për zgjedhjen si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 01.11.2023 është kërkuar informacion Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili me shkresën nr. {...} prot., datë 02.11.2023 protokolluar me tonën nr. {...} prot., datë 02.11.2023 informon se: “Për sa i përket magjistratëve (gjyqtarë) të listuar në shkresën

tuaj, 71 (shtatëdhjetë e një) prej tyre nuk janë dënuar me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktit të interesave”.

Ndërsa, në lidhje me anëtarin e Gjykatës së Lartë z. {...}, me vendimin nr.{...}, datë 03.11.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm “Për marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për deklarin e interesave private” është marrë masa administrative “gjobë”.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. {...}, datë 24.12.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur shfuqizimi në tërësi i aktit administrativ.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 01.11.2023 është kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme, e cila me shkresën nr. {...} prot., datë 03.11.2023 protokolluar me tonën nr. {...} prot., datë 06.11.2023 përcolli përgjigjet e marra nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Nga informacioni i përcjellë rezultoi se nuk ka magjistratë nën hetim ose të dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerje të një vepre penale. Për 4 (katër) magjistratë të përfshirë në listë kishte kallëzime penale të regjistruara (konkretisht {...} dhe {...}, {...}, {...}).

Në bazë dhe të përgjigjeve të marra nga institucionet përkatëse, bashkëlidhur kemi shoqëruar listën e magjistratëve të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në shortin për anëtar KED dhe listën e magjistratëve që nuk plotësojnë kriteret.

Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Burimeve është përgatitur edhe projektvendimi me titull “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024”.

Në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet miratimi i listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Ndërkohë, në pikën 2 të projektvendimit, nga detyrimi që përcaktohet në ligj, konkretisht në pikën 4, neni 221, të ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, është përcaktuar që listat e kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për t’u përfshirë në shortin për anëtarë të KED-së, bëhet publike në faqen zyrtare

të institucionit.

Gjithashtu, në pikën 3 të projektvendimit është përcaktuar, që kandidatët të cilët nuk janë përfshirë në listën e miratuar të njoftohen me shkrim individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar lidhur me shkaqet e përjashtimit. Në aktin e njoftimit, secilit prej tyre bëhet me dije e drejta për ankim, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në pikën 4 të projektvendimit është parashikuar që lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përcillet nga ana e Kryetares së Këshillit pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në fund është parashikuar hyrja në fuqi menjëherë e këtij vendimi dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Petriti!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve të cilët mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Lista me gjyqtarët kandidatë të miratuar në pikën 1 të këtij vendimi si dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

3. Kandidatët të cilët nuk janë përfshirë në listën e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar lidhur me shkaqet e përjashtimit. Në aktin e njoftimit secilit prej tyre t'i bëhet me dije e drejta për ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Ngarkohet Kryetarja e Këshillit për të përcjellë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, i përgatitur nga relatore znj. Irena Plaku. (shtyrë nga mbledhja e datës 08.11.2023).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI).*
6. *Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
7. *Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
9. *{...}, gjyqtar.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, i përgatitur nga relatore *znj. Irena Plaku*. (*shtyrë nga mbledhja e datës 08.11.2023*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Plaku. Ndërkohë janë paraqitur kundërshtime nga zoti {...}, njëkohësisht është edhe prezent për të marrë pjesë në këtë mbledhje.

Administrata të njoftojë zotën {...} të bëhet pjesë e mbledhjes.

(*Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari z. {...}.*)

Ilir Rusi: Përshëndetje zoti {...}!

Mirë se erdhe!

Sikundër edhe ju keni bërë kundërshtime në lidhje me projektvlerësimin atëherë fillimisht fjala do të jetë për relatoren zonjën Plaku, dhe pastaj ju do shprehni kundërshtimet tuaja.

Fjala për ju zonja Plaku!

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë do parashtoj projektraportin e vlerësimit në mënyrë të përmbledhur duke u ndalur më shumë tek treguesit për të cilët gjyqtari ka paraqitur edhe kundërshtime.

Procedura e vlerësimit për gjyqtarin ka filluar me vendimin nr.521, datë 06.12.2022 për shkak se ka kandiduar për pozicionin e shpallur me vendimin nr.178 datë 11.05.2022. Pasi janë kryer procedurat e hedhjes në short për përzgjedhjen e dosjeve, janë administruar të gjitha burimet e vlerësimit nga institucionet përkatëse.

Me vendimin e datës 07.09.2023 është vendosur plotësimi i procedurës dhe dokumentacioni që është gjetur i plotë dhe hartimi i projektraportit.

Pas njoftimit të projektraportit është njoftuar rregullisht gjyqtarit i cili ka marrë njoftim si dhe brenda afatit ka paraqitur kundërshtime të cilat do relatohen më pas nga vetë gjyqtari.

Po ndalem tek analiza e të dhënave, burimeve të vlerësimit dhe propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi. Konkretisht:

Kriteri i parë, “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, në treguesin 1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se: Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes: Referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes apo llojit të gjykimit të zhvilluar gjyqtari përgjithësisht i kushton rëndësi përshkrimit dhe analizës së fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e

parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale, thuajse në të gjitha vendimet, përshkruhen shkurtimisht në pjesën hyrëse të arsytimi pa u organizuar në një nënndarje më vete, por lehtësisht të kuptueshme. Gjyqtari përshkruan aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, faktin se të pandehurit i janë njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.

Gjyqtari, në vendimet e shortuara për vlerësim por edhe në ato të përzgjedhura e merr të mirëqenë juridiksionin dhe kompetencën, duke mos u shprehur për to.

Gjyqtari, në përshkrimin që bën, gërsheton rrethanat procedurale me ato faktike si në çështjet penale themeli, ashtu edhe në seancat paraprake duke i parashtruar ato në mënyrë të përmbledhur, në një rend kronologjik dhe logjik, duke integruar në përmbajtje të faktit herë pas here edhe provat përkatëse nga të cilat kanë rezultuar rrethanat konkrete. Faktet e çështjes janë përshkruar shkurtimisht dhe analizuar në mënyrë koncize, duke u shoqëruar në disa raste edhe me evidentimin dhe pasqyrimin e provave. Megjithatë konstatohet se jo gjithmonë faktet paraqiten në mënyrë të qarë, të plotë dhe të detajuara, duke mos dhënë një panoramë të qartë të rrethanave konkrete të çështjes, në raport me akuzën që i atribuohet të pandehurit dhe me konkluzionet e arritura nga gjyqtari. Konkretisht tek një vendim i zgjedhur nga vetë gjyqtari konstatohet se nuk është e qartë rrethanat e faktit për të cilat i pandehuri është ngritur akuza dhe është dënuar, duke qenë se është vepër penale “Ndërtim i paligjshëm”, ndërtimi është bërë në tokën e të pandehurit/ akuzuarit apo në tokën e tij dhe ka një mospërputhje midis asaj që është përcaktuar në pjesën hyrëse dhe arsytuese të vendimit edhe lidhur me parashtrimin e rrethanave të faktit.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari identifikon dhe përcakton qartë edhe pse në mënyrë të pashprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, natyra e çështjes përcaktohet që në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, referuar specifikave të saj. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike objekt shqyrtimi i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, duke iu referuar

akuzave që iu atribuohen të pandehurve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, megjithëse këto të fundit nuk merren asnjëherë në shqyrtim nga gjyqtari.

Sa i përket ligjit procedural: Referuar natyrës së çështjes gjyqtari identifikon dispozitat procedurale, duke cituar nenet konkrete, por jo përmbajtjen e tyre, konkretisht: nenin 331, nenin 332 të Kodit të Procedurës Penale, nenin 332/a në lidhje me veprimet përgatitore në kuadër të seancës paraprake; nenin 332/c në lidhje me zhvillimin e saj; nenin 332/dh në lidhje me vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake; etj.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari përgjithësisht identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, i cili gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi, por pa cituar përmbajtjen e neneve përkatëse të cituara. Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Në projektraport janë cituar dhe dispozitat të cilat janë cituar nga gjyqtari, siç e thashë janë cituar vetëm nenet por jo përmbajtja e secilit nen dhe atë çfarë secili nen parashikon. Gjithashtu janë cituar edhe dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht neni 48 në lidhje me rrethanat lehtësuese, neni 55 në lidhje me bashkimin e dënimeve; nenin 59 në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim; nenin 60 në lidhje me detyrimet e të dënuarit të vënë në provë; nenin 61.

Referuar dispozitave me karakter material dhe procedural, të cilat janë drejtpërdrejt të aplikueshme për zgjidhjen e çështjes, krahas K. Penal ka referuar ndër të tjera vetëm ligjin “Kodi Rrugor në RSH”, duke përcaktuar dhe nenet përkatëse por siç relatuam më sipër vetëm nenet, pa cituar përmbajtjen e secilës dispozitë.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e shortuara për vlerësim apo të përzgjedhur nga gjyqtari nuk identifikohen konflikte të normave.

Në tërësi, gjyqtari shfaq aftësi të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes,

të cilët paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke integruar herë pas here me provat e administruara në gjykim. Gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, por vetëm duke i cituar ato si dispozita, dhe në asnjë rast përmbajtjen e tyre, citim i cili bëhet në funksion konkluzionit të arritur nga gjyqtari për zgjidhjen e çështjes si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues vlerësoj se aftësia e tij është “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, referimi apo citimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes bëhet përgjithësisht në mbështetje të konkluzionit të arritur nga gjyqtari mbi ekzistencën e faktit penal, cilësimin juridik të tij dhe përgjegjësinë e të pandehurit, apo në funksion të aplikimit të rrethanave lehtësuese ose rënduese në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit ose aplikimit të dënimeve alternative, por nuk rezulton që këto dispozita t’i nënshtrohen një analize apo zbrëthimi paraprak, para përfshirjes së tyre në konkluzionin e arritur nga gjyqtari. Pothuajse në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi, normat ligjore thjesht referohen (vetëm dispozita dhe jo përmbajtja), pa u shoqëruar me interpretimin e tyre, por bëhet aplikimi i tyre direkt mbi faktet e çështjes, apo për të mbështetur konkluzionin e arritur nga gjyqtari.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet penale themeli burim vlerësimi, gjyqtari përgjithësisht referon dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, duke arritur direkt në konkluzionet përkatëse lidhur me akuzën që i atribuohet të pandehurit, duke konkluduar mbi fajësinë e tij, pa bërë paraprakisht zbrëthimin e saj sipas elementëve të figurës së veprës penale, apo kushteve dhe kriterëve të aplikimit të një instituti të pjesës së përgjithshme të K. Penal, sikurse është ai i kryerjes së veprës penale më shumë se njëherë, apo aplikimit të pezullimit të ekzekutimit dhe vënies së të pandehurit në provë, të cilët janë aplikuar në vendimet burim vlerësimi, pavarësisht se e shqyrton në tërësi çështjen. Pothuajse në të gjitha vendimet penale, për të mbështetur konkluzionin mbi llojin dhe masën e dënimit, gjyqtari referon nenet 48, se i pandehuri ka treguar pendim të thellë, apo nenin 59 në

lidhje me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim si dhe nenet 60 dhe 61, për detyrimin që i pandehurit të mbajë kontakte me shërbimin e provës, dhe për detyrimin që mos shoqërohet me persona të dënuar, por në asnjë rast nuk rezulton që këto dispozita t'i jenë nënshtruar një interpretimi apo zbërthimit të kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktin konkret apo për të mbështetur konkluzionin e arritur nga gjyqtari, pasi në vendime mungon edhe interpretimi i tyre në raport me rrethanat e çështjes.

Në vendimet me objekt “dërgim i çështjes në gjyq”, gjyqtari përshkruan mënyrë të përmbledhur, duke i integruar herë pas herë me provat, rrethanat e faktit të çështjes objekt gjykimi, si dhe veprimet hetimore të kryera në kuadër të saj, për të konkluduar se kërkesa e paraqitur i plotëson të gjithë elementët ligjore të kërkesës për dërgim në gjyq, pa bërë një analizë të dispozitave të referuara nga gjyqtari në vendim.

Ndërsa në vendimin me objekt “pushim i procedimit penal”, gjyqtari analizon rrethanat e faktit të çështjes objekt gjykimi, për të konkluduar se çështja duhet të pushohet për shkak se verifikohet parashkrimi i ndjekjes penale, duke referuar në këtë rast nenin 66/ç të Kodit Penal, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar nga momenti kur ka ndodhur ngjarja, si dhe se i kallëzuari ka ndërruar jetë, duke referuar nenin 328/d/f të K.Pr.P.

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale gjyqtari nuk shfaq një kujdes të posaçëm në interpretimin e normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur vetë dispozita procedurale është ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtari nuk ka identifikuar apo përdorur jurisprudencën relevante (vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton se gjatë në zgjidhjen e çështjes zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit, por ato nuk identifikohen më vete, në shërbim të analizës juridike të çështjes.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë

tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi nën mesatare në interpretimin e ligjit material dhe procedural në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Interpretimi i ligjit procedural dhe atij material në zgjidhjen e çështjes është tepër i kufizuar dhe në disa raste mungon. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi dispozitat referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, për të mbështetur konkluzionin e gjyqtarit, pa u bërë më parë një interpretim paraprak i tyre në drejtim të identifikimit të qëllimit, elementëve përbërës dhe zbërthimit të tyre. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi dhe referimi në praktikën gjyqësore relevante, çka do t'i jepte vlerë të shtuar interpretimit të ligjit, në mbështetje të konkluzioneve të arritura mbi zbatimin e tij. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësi, rezulton se interpretimi dhe analiza e normave mungon në shumicën e vendimeve, pasi konstatohet se gjyqtari kryesisht referon dhe aplikon drejtpërdrejt ligjin mbi faktet e provuara në gjykim, duke integruar referimin e dispozitave në konkluzionet e arritura, pa u ndalur në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyeve konkrete për mënyrën e zbatimit të tyre mbi faktet e çështjes.

Pas analizës së të dhënave, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Nën mesatare” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund të cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (përveç shkronjës “ë”). Përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera, sipas

përkatësisë. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit në pjesën përshkuese, konstatohet se në vendimet e themelit, gjyqtari megjithëse shprehet se në caktimin e dënimit mban parasysh rrethanat lehtësuese apo rënduese, në asnjë rast nuk shprehet për llojin e masën e dënimit që do të caktohet ndaj të pandehurit, të shprehur më pas në dispozitiv, duke lënë të nënkuptuar në llojin dhe masën e kërkuar nga prokurori.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë, veç pjesës hyrëse dhe përshkuese arsytuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtari është shprehur në mënyrë të plotë dhe koncize gjitha kërkimet, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Por siç e theksuam më sipër, nuk konstatohet e njëjta qartësi tek vendimet e themelit, sa i përket caktimit të llojit dhe masës së dënimit, e cila nuk përcaktohet dhe arsyetohet në mënyrë të qartë, duke e lënë të nënkuptuar.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe materiale dhe lidhjen e tyre me konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes. Por nuk rezulton që pjesë e strukturës së vendimeve burim vlerësimi, në shumicën e tyre, të jetë interpretimi dhe analiza e ligjit të zbatueshëm, para apo gjatë aplikimit të tij mbi faktet e çështjes konkrete.

Gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve

përbërëse të vendimit, duke mos e ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese me nënndarje, paragrafë të numërtuar apo fjali hyrëse që do ta bënin më të lehtë leximin.

Vendimet burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse pasqyrohen të dhënat e regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen; trupi gjykues, data e shqyrtimit, palët, baza ligjore dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Por në dy vendime mungon pasqyrimi i plotë i palëve pjesëmarrëse në proces, të cilët janë tepër të domosdoshëm të paraqiten, pasi nga paraqitja e tyre lidhet më pas njoftimi nga sekretaria i vendimit të gjykatës dhe ushtrimi i të drejtës së ankimit për raste e parashikuara në ligj. Konkretisht, në dy vendimet penale të cituara në projektraport, të dhëna pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, mungon pasqyrimi i të dëmtuarve nga vepra penale, të cilët janë thirrur rregullisht në gjykim dhe kanë qenë pjesë e procesit penal.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë (por jo të përcaktuara me tituj), konkretisht: Procedurën e ndjekur; rrethanat e faktit. Rezulton që prezantimi i faktit përgjithësisht është i qartë dhe konciz si dhe herë pas herë referon dhe provat; paraqitjen e konkluzionit lidhur me zgjidhjen e çështjes dhe konkretisht a) ekzistencën dhe provueshmërinë e faktit penal, kualifikimin ligjor; b) faktin se në caktimin e dënimit gjykata mban në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, shkallën e fajit, pranimin e akuzës, kërkesën për gjykim të shkurtuar, si dhe rrethanën lehtësuese duke cituar neni 48/ç të K.Penal. Në ato raste kur është kërkuar aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal nga prokurori, gjyqtari ka arritur në konkluzionin se kërkesa është e bazuar, duke çmuar më pas në aplikimin e nenit 60 dhe 61 të Kodit Penal, por pa bërë një analizë të këtyre dispozitave.

Ndërsa në vendimet seancë paraprake gjejnë pasqyrim faktet materiale dhe provat e marra në shqyrtim, procedura e ndjekur nga organi i akuzës; si dhe vlerësimi i gjykatës në lidhje me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, duke arritur direkt në konkluzionin se çështja duhet të dërgohet për gjykim, referuar neneve 331, 332, 332/dh dhe 332/ë të K.Pr.Penale apo vlerësimi i gjykatës, ku merret në analizë verifikimi i kushteve të parashkrimit të ndjekjes penale.

Referuar strukturës dhe përmbajtjes së arsyetimit të vendimit, rezulton se në arsyetimin e vendimit nuk elaborohet mjaftueshëm dhe nuk zë vendin e duhur në përmbajtjen e vlerësimit dhe analiza juridike e çështjes, pjesë në të cilën do të duhet të merrej në analizë ligji i zbatueshëm, zbërthimi i tij, mënyrë e aplikimit mbi faktet e çështjes, për të derivuar në tej në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, të cilin gjyqtari e paraqet në çdo vendim, menjëherë pas përshkrimit të faktit objekt gjykimi, pa bërë një analizë të tyre.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: (i) përgjegjësia penale e të pandehurit mbi akuzën, (ii) mënyra e disponimit në çështjet specifike, (iii) dënimi dhe masa e dënimit, (iv) llogaritja e dënimit, (v) mënyra e ekzekutimit të tij, (vi) shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, pasqyrohet e drejta e ankimit, Megjithatë siç u theksua edhe më lartë, tek vendimet e themelit, mungon arsyetimi në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit të përcaktuar në dispozitivin e vendimit, duke e shprehur vetëm për rrethanat që gjykata ka marrë parasysh në caktimin e dënimit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin e përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture përgjithësisht të njëjtë, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë kronologjike dhe logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij. Por nuk konstatohet e njëjta qartësi në pjesën e parë të vendimit, konkretisht me paraqitjen e saktë të palëve pjesëmarrëse në gjykim, pasi në dy vendim penale themeli, mungon pasqyrimi i plotë i palëve pjesëmarrëse në gjykim, i cili është tepër e domosdoshëm pasi lidhet drejtpërdrejtë me qartësinë e vendimit si për sekretarinë gjyqësore, e cila do të bëjë njoftimet e vendimit palëve pjesëmarrëse, si dhe orientimin e gjykatave më të larta lidhur përmbajtjen e vendimit në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij. Gjithashtu, nga ana tjetër në strukturën e pjesës arsyetuese, kalimi nga përshkrimi i fakteve të çështjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, pa referuar dhe analizuar ligjin e aplikueshëm, ndikon në qartësinë dhe plotësinë e vendimit, pavarësisht se në

dukje aspekti strukturor i ndërtimit të tij duket i qartë, por nuk mund të vlerësohet në të njëjtën mënyrë edhe për plotësinë e tij.

Pas analizës së të dhënave, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritor, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se përgjithësisht rezulton një nivel mesatar arsyetimi, ku mbizotëron elementi përshkrues i rrethanave procedurale dhe atyre materiale, duke i gërshetuar herë pas herë me provat e marra në shqyrtim, pas secilës menjëherë gjyqtari kalon në konkluzionet përkatëse lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Referuar kategorisë së çështjeve rezulton si më poshtë:

Në vendimet penale të themelit, në përgjithësi gjyqtari i ka kushtuar rëndësi pjesës përshkruese të rrethanave procedurale, të çështjes, të cilat paraqiten në fillim të pjesës arsyetuese të vendimit, duke vijuar më pas me pasqyrimin e rrethanave të faktit, të cilat përgjithësisht vetëm përshkruhen, duke konkluduar më pas lidhur me faktin se personi ka konsumuar elementët e veprës penale për të cilën akuzohet dhe fajësinë e tij, duke vijuar më pas në një paragraf tjetër lidhur me rrethanat që duhet të merren parasysh në caktimin e dënimit. Gjyqtari në asnjë rast nuk i ka kushtuar rëndësi analizës së faktit dhe provave të administruara në gjykim, si dhe mungon përjasja e kësaj analize me ligjin e zbatueshëm, në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, përcaktimit të vlerës provuese të provave apo elementë të tjerë të rëndësishëm të cilat duhet të çojnë në mënyrë logjike dhe të natyrshme tek konkluzioni që arrin dhe paraqet gjyqtari mbi zgjidhjen e çështjes. Nuk rezulton e njëjta shkallë e vëmendjes sikurse për faktin penal, në drejtim të analizës dhe interpretimit të ligjit dhe dhënies së arsyeve mbi mënyrën e

aplikimit të tij mbi faktin konkret, duke u mjaftuar vetëm me paraqitjen e konkluzionit se bazuar mbi këto prova dhe fakte, i pandehuri ka konsumuar veprën penale për të cilën ai akuzohet, por pa dhënë argumente se si është arritur në këtë konkluzion.

Në të njëjtën nivel paraqitet edhe analiza logjike në pjesën e fundit të vendimeve penale të themelit, në lidhje me dënimin, vlerësimin e llojit dhe masës së dënimit (për të cilën gjyqtari në asnjë rast nuk shprehet në këtë pjesë të vendimit) apo aplikimin e dënimeve alternative, ku konstatohet se gjyqtari ia ka kushtuar një rëndësi të pakët analizës së faktorëve të posaçëm që ka konsistuar në aplikimin e instituteve respektive, por nuk rezulton të ketë marrë në analizë kushtet ligjore për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit apo për aplikimin e dënimeve alternative, duke i integruar ato me rrethanat konkrete të çështjes, në mënyrë që të evidentohen arsyet mbi konkluzionin e arritur lidhur me përshtatshmërinë e masës së dënimit apo aplikimin ose jo të alternativave të dënimit me burgim. Pra edhe në këtë pjesë, gjyqtari vetëm referon dispozitat përkatëse, duke arritur në konkluzionet lidhur me çështjet referuar provave të marra në shqyrtim, pa bërë një analizë ligjore dhe individualizim të rrethanave konkrete ku gjyqtari mbështet konkluzionet.

Në vendimet penale/kërkesa penale, konstatohet se në pjesën e parë të pjesës arsyetuese- përshkruese, përshkruan rrethanat procedurale të çështjes, duke vijuar më pas me përshkrimin e rrethanave të faktit si dhe me përshkrimin e veprimeve procedurale të kryer gjatë hetimeve paraprake, duke i gërshetuar me provat e marra, deri në paraqitjen nga ana e prokurorisë së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim apo me paraqitjen e kërkesës për pushim çështje, si dhe pretendimin e prokurorisë së akuza provohet apo se jemi në kushtet e pushimit të procedimit penal. Menjëherë pas paraqitjes së pretendimit të të pandehurit apo avokatit të zgjedhur prej tij se çështja duhet të dërgohet për gjykim, gjyqtari ka dhënë konkluzionin përkatës se kërkesa e prokurorisë i plotëson të gjitha elementët për vlefshmërinë e saj dhe ka prova të mjaftueshme për mbështetjen e akuzës dhe se hetimet janë të plota dhe nuk janë konstatuar aktet të pavlefshme apo prova të papërdorshme dhe për këtë arsye vlerëson se çështja duhet të dërgohet për gjykim, duke u shprehur në një paragraf më vete se aktet që përmban fashikulli i gjyqimit t'i dërgohen gjykatës, dhe në bazë të nenit 332/ë, por pa i specifikuar ato. Këto janë fjalët që përdoren

nga gjyqtari në të gjitha vendimet burim vlerësimi.

Edhe në këto vendime mungon identifikimi dhe analiza e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale apo të dispozitave përkatëse që gjejnë zbatim dhe argumenti logjik, pasi komponenti analitik bazohet vetëm në arritjen e konkluzionit përkatës pa e analizuar atë në raport me rrethanat dhe faktet konkrete të përshkruara përgjithësisht në mënyrë të qartë në pjesën e parë të vendimit. Ndërsa në vendimin penal me objekt- pushim procedimi gjyqtari identifikon dhe bën një analizë të shkurtër të dispozitave përkatëse që gjejnë zbatim në rastin konkret, duke i gërshetuar edhe me rrethanat konkrete, duke konkluduar se çështja duhet të pushohet.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, konstatohet se gjyqtari pasqyron në mënyrë të përmbledhur pretendimet e palëve dhe kërkimet e tyre, por jo gjithmonë ai i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të tij, duke u mjaftuar vetëm me konkluzionin se kërkesa e prokurorit është e bazuar, apo se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale për të cilën është akuzuar, duke mos dhënë asnjë argument për fuqinë provuese të akteve provuese të marra në shqyrtim, për kërkesën e tij lidhur me llojin dhe masën e dënimit, apo me kërkesën e paraqitur për aplikimin e dënimit alternativ.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka vlerësuar aftësinë e tij shumë të lartë.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, rezulton se gjyqtari ka aftësi mesatare në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Analiza dhe argumentimi logjik mbështetet kryesisht në vlerësimin e gjyqtarit mbi faktet e çështjes të përshkruar në pjesën e parë të vendimit kur përshkruhen rrethanat dhe faktet, duke bazuar konkluzionin për zgjidhjen e çështjes si deduksion të kësaj analize, por pa integruar dhe mbështetur këtë të fundit në interpretimin dhe dhënien e argumenteve mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktin konkret. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, në raportin mes analizës së fakteve përballë ligjit të zbatueshëm dhe mënyrës së aplikimit të tij, rezulton se gjyqtari nuk ka treguar të njëjtën shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi dominohen nga elementi përshkruar në raport me atë analitik, i

cili kryesisht përbëhet vetëm nga konkluzioni përkatës i gjyqtarit lidhur me zgjidhjen e çështjes. Edhe elementi gjithëpërfshirës i analizës së pretendimeve të ngritura nga të pandehurit pothuajse mungon në të gjitha vendimet.

Pas analizës së të dhënave lidhur me këtë tregues, vlerësoj se aftësia e tij është “Mesatare”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozim për nivelin e vlerësimit “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, pikët 65, niveli i vlerësimit “Mirë”.

Sa i përket kriterit të dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarit”

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 52 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 4 prej tyre janë shqyrtuar në tejkallim të këtij afati, pra gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 8 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Gjithashtu është bërë edhe një analizë tjetër e të dhënave, duke u zbritur leja vjetore e muajit gusht si dhe festat e fund vitit dhe afati i mbartjes së dosjeve nga ku ka rezultuar se numri i çështjeve duhet të zbritet tashmë në 2 çështje, pra përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit është 3.8 %.

Referuar sa më sipër vlerësoj se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se rezulton numri i çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, janë nga 0-10%.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 64 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, asnjë çështje nuk është shqyrtuar jashtë këtyre afateve. Pra rezulton 0 %.

Referuar sa më sipër, rezulton se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje referuar Raportit Analitik, për të gjitha kategoritë e çështjeve, konkretisht “Penale-krime”, “Penale-kundërvajtje”, “Seancë paraprake” dhe “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për secilën prej çështjeve.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se edhe për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet

me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, gjyqtari subjekt vlerësimi ka përfunduar 116 çështje, ndërkohë që i janë caktuar 120 të tilla. Rrjedhimisht, rendimenti rezulton 96.6%, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 8 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, duke e çuar në një nivel maksimal në rast se gjyqtari e ka tejkaluar me mbi 50 % standardin sasior.

Referuar standardit sasior të përcaktuar në vendimin e KLGJ-së, rezulton se duke qenë se gjyqtari ka punuar në seksion penal, është 100 çështje penale (krime dhe kundërvajtje penale).

Gjithashtu rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka qenë në detyrën e zëvendëskryetarit por duke qenë se ka pasur mungesë të kryetarit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, ka ushtruar kompetencat e plota të kryetarit të gjykatës.

Sipas pikës 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve: Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate.

Referuar të dhënave statistikore rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka gjykuar 113 çështje penale, nga të cilat 48 çështje krime dhe 65 seanca paraprake dhe pushim procedimi. Por nga përmbajtja e këtyre të dhënave konstatohet se 35 çështje të regjistruara si seanca paraprake, ka vijuar gjykimi nga i njëjti gjyqtar për gjykimin e çështjes në themel pas paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke bërë që këto çështje të kenë marrë numër të ri, si çështje themeli dhe për këto ai ka dhënë 35 vendime

themeli, të llogaritur tek numri 48 çështje krime e kundravajtje. Pra në total, gjatë kësaj periudhe gjyqtari nuk ka dhënë 113 vendime për çështje penale, por 78 vendime. Por nga të dhënat statistikore konstatohet gjithashtu se ai ka gjykuar një numër tepër të vogël të kërkesave penale, konkretisht rreth 8 çështje.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 96.6%, por ndërkohë rezulton se përgjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka kryer funksionin e zv/kryetarit, duke ushtruar kompetencat e kryetarit të gjykatës me kompetenca të plota. Në këto kushte, gjyqtari duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit.

Rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit vetëm për një nënkategori është më e gjatë, ndërsa për të gjitha të tjerat është më e shkurtër se afati procedural.

Referuar burimeve të vlerësimit, sipas Metodologjisë, duke qenë se në shumicën e kategorive të çështjeve (4 nga 5 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se afati procedural, si dhe faktin se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka ushtruar faktikisht edhe detyrën e kryetarit të gjykatës, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë për këtë tregues.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se numri i seancave është si më poshtë:

Në kategorinë “Penale themeli” në 3 çështje janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore; në kategorinë “Seanca paraprake”, në 3 çështje me objekt “dërgim çështje në gjyq” dhe “pushim procedimi penal” janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore. Pra, në total për 6 gjykime janë zhvilluar 9 seanca gjyqësore.

Pra numri mesatar i seancave gjyqësore, rezulton 1.5.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta

për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore.

Referuar sa më sipër, pasur parasysh numrin e seancave dhe veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale.

Edhe për këtë tregues gjyqtari është vlerësuar me pikët maksimale pasi ka rezultuar se gjyqtari kryen në rregull të gjitha veprimet procedurale. Rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj.

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik dhe kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit

përfundimtar (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët.

Në dosjet penale nuk rezultojnë të jetë administruara kopje e “Letrës së të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a , 58, 140 paragrafi 1 dhe 137 i K.Pr.Penale.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, për shkak se është konstatuar mungesë e “Letrës së të drejtave” vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Propozim për nivelin e vlerësimit për sa i përket kriterit “Aftësia organizative” është 98, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”.

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Lidhur me këtë tregues, janë marrë si burim vlerësimi edhe informacioni i përcjellë nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë ku rezultojnë edhe ankesat, por nuk ka të dhëna për këtë burim.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën e tij në punë. Për këto arsye, për këtë tregues, vlerësoj se aftësia e tij është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale me 40 pikë.

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga burimet e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë përdorur tek vendimet apo tek aktet shkresore përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë kërkesë e paraqitur për përjashtimin e subjektit të vlerësimit. Për këtë arsye vlerësoj se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozim për nivelin e vlerësimit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”

Konkretisht për treguesin 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të drejtpërdrejtë dhe të kuptueshëm.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e tij është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit.

Edhe për këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna që mund të ndikojnë në këtë vlerësim. Për këtë arsye vlerësoj se aftësia e tij është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët si dhe me administratën. Për të dyja këto tregues gjyqtari është vlerësuar maksimalisht, pasi nga burimet e vlerësimit rezulton shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues.

Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues ka marrë pjesë në 4 (katër) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 5 ditë trajnimi.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se është

brenda kufijve 5 deri në 40 ditë referuar faktit se është vlerësuar për një afat njëvjeçar. Për sa më sipër, për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit duke qenë se për këtë tregues niveli i pikëzimit fillon me 3 pikë dhe në rast se verifikohen të dhëna, shtohen 2 pikë, në kushtet kur për gjyqtarin nuk rezultoi që të jetë angazhimi i tij në cilësinë e ekspertit lehtësues, vlerësoj se aftësia për këtë tregues duhet të vlerësohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton se ka të dhëna për këtë tregues.

Megjithatë, pas një verifikimi ka rezultuar se gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë si anëtar në Grupin Ndërinstitucional të Punës për vlerësimin dhe riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të krijuar me urdhrin nr. 78 të datës 18.02.2019 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për këtë arsye, për këtë tregues gjyqtari është pikëzuar, duke qenë se rezultojnë të dhëna për veprimtari ndërinstitucionale, konkretisht pjesëmarrje në grup pune, është vlerësuar me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore.

Nuk rezulton se gjyqtari të ketë gjatë periudhës së vlerësimit publikime. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 0 pikë.

Propozim për nivelin e vlerësimit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është 93 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, pikët 65, niveli i vlerësimit “Mirë”; Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 98, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 93, niveli i vlerësimit

“Shkëlqyeshëm”; Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është pikëzimi 356, niveli i vlerësimit “Mirë”.

Në përfundim janë bërë edhe rekomandimet përkatëse.

Faleminderit!

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë ftoj magjistratin z. {...} për të paraqitur kundërshtimet në mënyrë sintetike duke u përqendruar tek ato rubrika për të cilat ju keni shprehur kundërshtime. Faleminderit!

{...}: Faleminderit!

Së pari ju kërktoj falje për kohën që po ju zë, se keni plot gjëra për të zgjidhur por jam drejtuar se për mendimin tim diferenca e pikëve që unë mendoj është e lartë, se ka pasur herë tjetër në vlerësimin e kaluar që mund të ishte dy – tre pikë, nuk do isha drejtuar për këtë gjë.

Unë i qëndroj atyre që kam shkruar, se nuk do përsëris tani që t’ju lodh me këtë, por tre-katër gjëra të vogla po citoj.

Unë mendoj se ka subjektivitet në kuptimin, jo subjektivitet për keq, por persona të ndryshëm mund të kenë opinione të ndryshme për një çështje. Ka vendime njësuere që tre veta vendosin ndryshe, dy ndryshe. S’është ndonjë gjë kjo. Unë vet mund të jem subjektiv në këto që po them. Jam përpjekur të jem objektiv. Edhe unë kam bërë vlerësime vetë. Kam qenë anëtar KLD-je dhe kam bërë vlerësime të gjyqtarëve. Nuk e mbaj mend, ndoshta edhe të zonjës relatorë ia kam bërë, dhe mund të kem qenë subjektiv.

Prandaj iu drejtova, se një organ kolegjal është më objektiv kuptohet.

Dy-tre gjëra të vogla po them.

Nuk është se nuk qëndrojnë vërejtjet, që duhet cituar juridiksioni, kompetencat, vendimet e KLGJ-së, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-së, etj. Unë vendime të tilla që i kam cituar këto, por s’mund t’i paraqisja si provë se kështu është rregull. Por në një vendim, që një person, po ju marr një shembull banal, kapet në rrugë me motor pa patentë

në Tiranë, këtu s'ka juridiksion, as kompetencë. S'mund të citosh praktikën për praktikë. Nuk ka pasur debat. Ose ka debat, po ju marr dhe një shembull tjetër, kur dënojmë njerëz për mashtrim, shumë pretendojnë që është çështje civile dhe ka debat për juridiksionin dhe gjykata merret me këtë.

Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, qartësia etj. Unë gjatë vitit, siç u relatua, kam gjykuar 119 çështje. 111 çështje nuk janë ankimuar fare. Palët kanë qenë dakord. E kanë kuptuar se po mos ta kishin kuptuar nuk do ankoheshin. 8 janë ankimuar, 2 janë lënë në fuqi. 6 janë në gjykim akoma. Domethënë përqindja është e lartë.

Citimi i dispozitës. Unë jam dakord që në gjyqe të rëndësishme mund të citosh dispozitën, por në gjyq me gjykim të shkurtuar ai e pranon. E kam konsideruar zgjatje të kotë të vendimit. Gjithsesi vendimi ka gjithë elementët që ka neni 883 i K.Pr.Penale, domethënë ka paraqitjen e palëve, pjesën hyrëse, përshkruese, arsyetuese, pretendimet e palëve dhe arsyetimin e gjykatës dhe vendosja e titujve. Unë i vendos titujt në një vendim të rëndësishëm. Këto për shans kanë qëlluar vendime të thjeshta.

Gjithashtu, gjithmonë, kur aplikohen dënime alternative arsyetohet fakti që pse vendoset dënim alternativ. Ndërsa kur nuk vendoset, nuk mund të... se të gjithë ata që vijnë në gjykatë, dhe ai që ka bërë vrasje, thotë më dënoni në minimum, më dënoni me nenin 59. Gjykata arsyeton masën, llojin e dënimit që do jepet dhe kjo nënkupton që i është dhënë përgjigje edhe atij.

Në një vend mu duk sikur ka pak mospërputhje për sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë”, ku gjatë analizës thuhet që gjyqtari i kushton rëndësi arsyetimit, etj. etj. dhe vlerësimi nuk është maksimal.

Edhe tek saktësia e dosjes. Edhe dy gjëra të vogla t'ju sqaroj si praktikë e gjykatës që ka qenë. Fillimisht kur kanë qenë të dëmtuarit, ngaqë ishte risi, ne i përmendnim në vendim, nuk i vinim si palë. Por ata nuk kanë të drejtë ankimi në vendimet e themelit, gjithsesi tani u bë si praktikë që i vendosim si palë. Vërejtja qëndron por ashtu e ka bërë e gjithë gjykata.

Për sa i përket “Letrës së të drejtave”, gjithmonë atij i është dërguar, por nuk është mbajtur kopje në dosje sepse një kopje bëhet dhe i dërgohet atij.

Edhe dy gjëra të vogla, se ju thashë që s'do ju bezdis shumë.

Sa i përket udhëheqjes së magjistratëve. Gjatë vitit që unë kam ushtruar detyrën e kryetarit, ngaqë ish-kryetarja u largua, nuk më ka caktuar KLGJ-ja dhe unë nuk kam kërkuar magjistratë për shkak se një pjesë të madhe të kohës unë nuk rrija në punë, dhe nuk do e kryeja tamam atë funksion, që gjyqtari duhet ta mbajë në zyrë. Pra duhet t'i kushtojë më shumë kohë dhe s'e kisha atë kohë.

E fundi, për analogji, siç e dëgjuat edhe ju, tek shpejtësia e dorëzimit të dosjeve, përfundimi brenda afatit, asnjë seancë jashtë afatit, unë kam marrë pikët maksimale. Ju me të drejtë në këtë rubrikë iu keni dhënë pikë maksimale edhe gjyqtarëve të tjerë që nuk e kanë pasur këtë gjë, për shkak të kushteve dhe numrit të vogël të gjyqtarëve. Atëherë edhe mua për analogji, në një vend tjetër mund të mi jepnit pikët maksimale. Mund të mi jepnit domethënë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë pyetje apo diskutime.

Ndërkohë, bëj me dije që zoti Kurushi është pjesë e mbledhjes për shkak se përfundoi impenjimin e tij në lidhje me trajnimin institucional pranë Shkollës së Magjistraturës dhe tani është prezent.

Zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Përshëndetje zoti {...}!

Unë jam dy pyetje.

E para, nga pjesa e arsyetimit të vendimeve, në pjesën arsyetuese nuk arsyetohet asnjëherë masa e dënimit që cakton gjykata. Domethënë masën e dënimit e gjen vetëm në pjesën e dispozitivit. Është praktikë e punës kjo? I kam lexuar të gjitha vendimet dhe më ka bërë përshtypje. Nuk thuhet në asnjë vend për shembull “referuar marzhit të dënimit gjykata vendos të caktojë këtë marzh sepse...”, por e gjejmë vetëm në dispozitiv të vendimit.

{...}: Jua thashë edhe një herë që këto janë vendime të thjeshta. Shumica janë të dënuar me nenin 59. Palët kanë qenë dakord me akuzën dhe paragrafi ku thotë “në llojin dhe masën e dënimit, gjykata merr parasysh këto gjëra”, nuk kushton asgjë që të shënosh, prandaj gjykata çmon se vepra dënohet nga 6 muaj në 3 vjet dhe ky dënohet 1 vit. Unë e kam bërë këtë për thjeshtësi. Në vendime të tjera që nuk kanë qëlluar është e analizuar, bile shumë gjatë kjo gjë. Vetëm për thjeshtësi vendimesh. Jua thashë edhe një herë, janë vendime të thjeshta. Më mirë do ishte kështu si thoni ju. Jam dakord me këtë.

Brikena Ukperaj: Jo, se e vura re këtë gjë edhe në vendimet që keni zgjedhur vetë. Nuk është vetëm në vendimet e shortit, por edhe në vendimet që ju keni sjellë, është e njëjta praktikë punë, prandaj e ngrita si problem.

Një pyetje tjetër kam unë.

Nga raporti analitik dhe nga projektraporti i vlerësimit rezulton që për vitin 2021 ju keni gjykuar vetëm 116 çështje dhe të janë caktuar 120 çështje. Ndërkohë që ngarkesa e punës në gjykatë ka qenë shumë e madhe. Pse është kjo pjesëmarrje kaq e vogël në short?

{...}: Juve duhet ta dini më mirë, se keni qenë, se disa anëtarë KLGJ-je nuk kanë qenë. Viti 2021, Covid, vetting, gjykata me kaq veta, unë zakonisht dy-tre orë mund të rrija. S’kisha kohë fizike për ta bërë. Mirë që më ka ndihmuar KLGJ-ja, se s’do e kisha bërë dot punën e drejtimit të gjykatës në atë kohë. Shkoja tek të dy godinat, se kishte probleme tek të dyja. Dhe kaq nuk e di, unë mendoja se kisha bërë më pak.

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka ndonjë pyetje apo ndonjë diskutim nga anëtarët e tjerë, për sa është prezent zoti {...}?

Meqenëse nuk ka pyetje, ftoj zotin {...} të largohet, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet përkatëse. Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të procesit për vlerësimin e magjistratit z. {...}, fjala për zonjën Plaku meqë e ka kërkuar fjalën.

Irena Plaku: Atëherë, faleminderit!

Pasur parasysh edhe kundërshtimet që janë paraqitur nga ana e gjyqtarit, vlerësoj se duhet të sqaroj disa rrethana pasi nga ana e gjyqtarit u pretendua se janë ulur disa pikë për disa çështje, konkretisht tek rrethanat e faktit të çështjes. Nuk janë ulur për shkak se nuk ka pasur konflikt të normave apo nuk janë referuar gjerë e gjatë, apo s'janë referuar fare në fakt praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë. Konkretisht tek paraqitja e rrethanave të faktit konstatohet se një nga vendimet që është zgjedhur nga vetë gjyqtari rezulton siç e theksuam më sipër që faktet e çështjes nuk janë të paraqitura në mënyrë të saktë.

Konkretisht (e mbaj mend në fakt se nuk është se e kam këtu), akuza është ngritur për 199/a/2 që ka të bëjë me ndërtimin e paligjshëm në tokën e tjetrit; gjatë arsyetimit thotë që është në tokën e tij; më pas në një pjesë të dispozitivit thotë që është në tokën sipas nenit 199/b, por nuk rezulton asnjë rrethanë lidhur me këtë fakt se kush është kjo provë që e vërteton në rast se është në tokën e tij apo është në tokën e tjetrit; dhe në fund është dënuar, në fakt është cituar 199/a/2, por në fakt është dënuar, po të shikosh masën e dënimit, sipas 199/a/1. Domethënë nuk i ka përshkruar qartë mënyrën dhe rrethanat.

Po të shikosh edhe një vendim tjetër që gjyqtari ka vendosur pushimin e vendimit për shkak se është parashkruar, rrethanat e faktit nuk janë parashikuar në mënyrë të qartë, sepse nuk rezulton kur është vepra penale, kur ka ndodhur ngjarja, që të themi është e parashkruar apo jo.

Gjithashtu sa i përket ligjit të zbatueshëm, në asnjë nga dispozitat, për të cilën i pandehuri dënohet, nuk është përcaktuar asnjë përmbajtje dispozite dhe pse ka shkuar gjyqtari në këtë analizë, në kuptimin, e ka dënuar me kaq. Thuhet që caktohet masa e dënimit, që nuk përcaktohet në asnjë vendim, çka masën e dënimit e lë të kuptohet në atë

që ka kërkuar prokurori dhe asnjë ndryshim tjetër nga ajo që ka kërkuar prokurori.

Siç e thashë, nuk nisem nga konflikti i normave sepse kanë qenë çështje të thjeshta, por gjithsesi këto janë çështje të cilat dy i ka zgjedhur gjyqtari vetë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin”, siç e thashë, gjyqtari nuk interpreton në asnjë rast dispozitat ligjore. I citon, referon nenin përkatës, por nuk ka asnjë zberthim të asnjë prej normave. Nuk i është ulur pikë për shkak se nuk ka analizuar juridiksionin e kompetencës. Është evidentuar fakti që nuk e ka analizuar por nuk janë ulur pikët për këtë shkak.

Gjithashtu edhe për sa i përket zbatimit të parimeve, kam thënë që i zbaton ose nënkuptohet kjo por asnjëherë nuk e ka cituar në analizën ligjore. Për këtë arsye është vlerësuar në nivelin nën mesatar, sepse nuk ka asnjë analizë referuar burimeve të vlerësimit.

“Qartësia, konciziteti..”, siç e kam theksuar në raport, janë ulur pikët jo për shkak të mënyrës së të shkruarit por nuk del i qartë se për çfarë mase dhe lloji dënimi është dënuar i pandehuri.

Sa i përket “Strukturës së qëndrueshme”, konkretisht janë ulur pikë për sa i përket pjesës hyrëse të vendimit, që nuk përcaktohen të gjitha palët ndërgjyqëse, si dhe tek pjesa përshkuese mungon përcaktimi i ligjit të zbatueshëm dhe analiza juridike, por kalohet nga pasqyrimi tek rrethanat e faktit, kalohet tek konkluzionet e palëve. Për këtë arsye, referuar edhe standardeve të mbajtura nga vlerësimet e mëparshme kur në rast të mungesës, pasqyrimin të saktë të palëve ndërgjyqëse, është ulur me dy pikë, pra me një nivel vlerësimi, duke e pikëzuar me 8 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, janë analizuar të gjitha burimet e vlerësimit, nga ku ka rezultuar që ka pasur mungesë të analizës si për sa i përket ligjit të zbatueshëm, konfliktit të normave, si zbatohen mbi rrethanat konkrete sepse gjyqtari në çdo vendim del vetëm në konkluzion si në çështje seancë paraprake ashtu edhe tek themeli. Pra nuk ka asnjë argument logjik. Nuk i merr në analizë të gjithë pretendimet e palëve, për shembull që kanë lidhje me provueshmërinë (që unë jam referuar atyre pretendimeve të shkruara nga ana e palëve për fuqinë provuese të akteve provuese, se në një rast gjatë gjykimit pala ka pretenduar se nuk mund të dënohet për këtë vepër vetëm

për një deklaram). Lidhur me llojin dhe masën e dënimit në asnjë rast nuk është arsyetuar. Dhe mbi aplikimin e alternativave të dënimit. Përveçse kur është kërkuar nga prokurori ka thënë që vlerësohet e bazuar. Në rast kur është kërkuar nga i pandehuri, nuk është dhënë asnjë lloj argumenti. Për këtë arsye është vlerësuar mesatare duke e pikëzuar me 15 pikë.

Për të gjitha kriteret e tjera e kam vlerësuar maksimalisht, në kriterin e “Aftësive organizative”, përveç kriterit që lidhen me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit, për shkak të mungesës së “Letrave të së drejtave”.

Gjithashtu për sa i përket, vërtet ka qenë kryetar i gjykatës por disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr gjyqtarë gjatë stazhit profesional nuk përfshin vetëm që të ketë pasur magjistratë të atashuar pranë gjyqtarit por edhe detyrën e tij si lehtësues dhe ekspert. Nuk kanë rezultuar të dhëna të tilla.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Fjala për zotin Hado!

Ridvan Hado: Faleminderit!

Unë kam mendim ndryshe nga relatorja.

Unë mendoj se vendimet që kanë shërbyer si bazë për vlerësimin e gjyqtarit {...} janë vendime rutinë, të thjeshta, të sakta, të qarta. Argumentat i ka dhënë vetë në kundërshtimin mbi projekt-aktin e vlerësimit etik dhe profesional. Unë mendoj që s’ka nevojë për teorizime të shumta në vendimet e natyrës me gjykim të shkurtuar dhe super të thjeshta. Mendoj që drejtësia ka arritur tek publiku me argumentat që ka përdorur dhe aq më tepër që janë vendime që nuk janë ankimuar as nga prokurori dhe as nga i pandehur. Në këto kushte do propozoja që për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, në pikën e parë “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave” është propozuar niveli “mbi mesatar” me 20 pikë, do propozoja nivelin “shumë të lartë”, 25 pikë.

Po ashtu, për nënpikën e dytë “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e

çështjes”, është “nën mesatare”, 10 pikë. Propozimi im është “shumë i lartë”, 25 pikë.

Në të njëjtën mënyrë edhe për nënpikën e tretë “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, është vlerësimi “mbi mesatare”, 12 pikë. Propozimi im është vlerësimi “shumë i lartë” dhe pikët 15.

Gjithashtu për “Strukturën e qëndrueshme dhe mirëorganizimi i vendimit”, është “mbi mesatare”, 8 pikë. Propozoj, 10 pikë, “shumë i lartë”.

“Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, është propozimi 15 pikë. Unë do propozoja “shumë i lartë”, 25 pikë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Për të mos rënë në përsëritje, duke i parë të gjitha këto, unë bie dakord me një pjesë të propozimeve që zoti Hado paraqet, por për sa i përket disa niveleve, siç është për shembull “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” bashkohem që ka nevojë për një rritje pikësh por jo të shkojë tek shumë e lartë, por “mbi mesatare”, pra të shtohet me 10 pikë.

Gjithashtu edhe “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” dhe pjesa e “Cilësisë së analizës dhe argumentit logjik” me një nivel, nga mesatare (jo atë që thotë zoti Hado me 25 pikë), por në mbi mesatare, me 20 pikë. Pra të shtohen 5 pikë.

Faleminderit!

Këtë standard kemi mbajtur në të gjitha votimet.

Ripërsëritet nga zoti Hallunaj, të rritet me 10 pikë, mbi mesatare, “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”.

“Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” nga 15, në mbi mesatare me 20 pikë. Këto kam unë propozime. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Fjala për zonjën Plaku!

Irena Plaku: Në rast se nuk ka propozime të tjera, për t'i dhënë përgjigje propozimeve të dhëna nga zoti Hado.

Atëherë, nga ana e Këshillit, në të gjitha vlerësimet, por edhe në këtë vlerësim, nga ana e relatores në këtë rast, nuk vlerësohet nëse vendimet prishen apo lihen në fuqi nga gjykatat më të larta. Nuk është vlerësuar apo është ankimuar apo jo. Vlerësohet mënyra se si parashtrihen rrethanat e faktit, se si analizohen rrethanat. Nuk vlerësohet dakordësia e të pandehurve me masën e dënimit apo jo. Fakti që i pandehuri mund të dakordësohet me një masë dënimi apo me deklarin apo jo fajtor, nuk do të thotë që vendimi është i mirë arsyetuar në të gjitha elementët e tij përbërëse. Ne mund të kemi edhe raste kur i pandehuri deklaron se është i fajshëm, por është gjykata ajo që do provojë dhe do analizojë në rast se jemi përpara fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit dhe nuk nisemi vetëm tek ajo çfarë deklaron i pandehuri, por analizohet. Sepse në fund të fundit i pandehuri deklarohet fajtor për një vepër, pavarësisht se është vepër e thjeshtë apo vepër, siç mund ta thoni juve, vepër e thjeshtë apo vepër e rëndë. Në fakt, neni 134 paragrafi a/4 nuk është kaq e thjeshtë sepse parashikon dënimin deri në 5 vjet. Nuk është kaq e lehtë. Gjithsesi këto janë vendime që janë përzgjedhur nga vetë gjyqtari. Dy vendime janë të zgjedhura nga vetë gjyqtari. Në njërin vendim, siç e thashë, nuk pasqyrohen rrethanat e faktit, që i pandehuri të kuptojë për çfarë është dënuar, 199/a/2 apo 1, janë dy paragrafë që njëra është kundravajtje dhe tjetra është krim. Të dënohesh për një person për një krim nuk është kaq e lehtë, pavarësisht masës së dënimit apo llojit, masës së dënimit që ne i caktojmë të pandehurit. Në asnjë rast i pandehuri nuk ka marrë përgjigje për atje ku ka kërkuar caktimin e një rrethane lehtësuese. Pse nuk është pranuar kërkesa e tij? Gjyqtari del vetëm në konkluzion. Gjithashtu ky vlerësim, faktin që citohet një dispozitë pa përcaktuar përmbajtjen, i pandehuri, pasur parasysh dhe veprat penale për të cilat dënohen, çka nënkupton një nivel jo shumë i lartë arsimor, nuk e di çfarë parashikon neni, nuk e di çfarë parashikon dispozita. Është gjyqtari ai që duhet të jetë i qartë në vendimmarrje. Të jetë i qartë të përcaktojë kush është dënimi, sa e cakton gjyqtari këtë marzh dënimi dhe pse ia ul apo ia ngre nga ajo që ka kërkuar prokurori.

Gjithsesi në asnjë vendim nuk është përcaktuar çfarë mase po i cakton. Në asnjë vendim gjyqësor nuk përcaktohet “more sa po e dënon”. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar i tillë që të dalin konkluzionet që ka arritur në përfundim. Një gjë e tillë mungon në të gjitha vendimet e gjyqtarit, si ato të zgjedhura dhe ato të përcaktuara me short gjatë procedurës së zgjedhjes së vendimeve. Nuk janë ulur asnjëherë pikë për sa i përket strukturës, përmbajtjes, është vendosur titull apo nuk është vendosur titull. Jo, nuk ka ndodhur.

Vlerësimi i këtij gjyqtari është bërë referuar standardeve të cilat ka vlerësuar Këshilli dhe për të cilën ne jemi shprehur me vendimmarrje në vlerësimet e disa gjyqtarëve të tjerë. Mund t’i përmend edhe me emra. Janë disa gjyqtarë të tjerë të cilët duke pasur parasysh këtë nivel arsyetimi të vendimit janë vlerësuar me nivelin “Mirë”. Apo duke pasur gjyqtarë me një nivel shumë herë, po shumë herë më të mirë, janë vlerësuar në nivelin “Shumë mirë”. Janë evidentuar mungesa e këtyre akteve. Për shembull tek struktura, janë gjyqtarë që i janë ulur pikët duke i çuar “mbi mesatare”. Po, sepse kanë pasur të njëjtat mungesa. Janë evidentuar tek të gjitha vlerësimet të cilat ne i kemi pikëzuar, jo vetëm nga pikëzimi që kam çuar unë si relatore, por ato që janë miratuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Po, fjala për ju zoti Toro!

Alban Toro: Nuk është çështje oponente, por duke qenë që lënda këtu ka shërbyer për vlerësimin a kanë qenë vendime të gjykimit të shkurtuar, i cili është një gjykim i posaçëm, ku i pandehur heq në mënyrë të vullnetshme dorë nga disa të drejta që i jep procesi i rregullt ligjor, dhe normalisht nuk ka filozofi apo nuk kërkon ndonjë arsyetim të hollësishëm, mjafton të ruajë ato parametra që Gjykata Kushtetuese ka sanksionuar si duhet të jetë arsyetimi i vendimit gjyqësor. Kemi disa vendime të GJEDNJ, që ndër të tjera thotë që: “ ...kjo procedurë paraqet avantazhe të padiskutueshme për të pandehurin, në rast dënimi ky i fundit gëzon ulje të dënimit. Kjo procedurë është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit, si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve”. Pra në një farë mënyre

këtu kemi të sintetizuar atë që duhet të kishte një vendim gjyqësor i tillë i cili përfaqëson gjykimi i shkurtuar, që është gjykim i posaçëm, ka një lehtësim dhe të debatit, pra nuk pasqyrohet çdo gjë pasi edhe vetë i pandehuri ka aprovuar, e ka pranuar gjendjen e faktit ashtu siç janë dhe në bazë të saj ai do të përfitojë uljen e dënimit. Kështu që në këtë kontekst nuk besoj se ky vendim do të jetë i ngarkuar me ndonjë arsytim filozofik, mjafton që të ruajë ato parametrat, që duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, dhe ta luajë funksionin që ka, t'i drejtohet palëve, të kuptojnë atë që gjykata ka gjykuar dhe atë që ka dhënë, që në rastin konkret duke pasur parasysh edhe eksperiencën 25 apo 29-vjecare të gjyqtarit në këtë drejtim, besoj se e ka realizuar. Kështu që bashkohem me dy kolegët.

Ilir Rusi: Po! Fjala zonjës Plaku!

Irena Plaku: Sa i përket oponencës siç e theksoi zoti Toro.

Procedura e gjykimit të shkurtuar është një procedurë që parashikon ekonomi gjyqësore. Edhe publiciteti lidhet me provat dhe nuk ka lidhje me arsyetimin e vendimit.

Të lutem, se po jap shpjegime. Më dëgjo deri në fund.

Atëherë, pala, i pandehuri pranon gjykimin që të gjykohet mbi aktet. Kaq është. As pranon fajësinë, asnjë gjë. Të gjithë kemi gjykuar me gjykim të shkurtuar dhe e dimë procedurën. Eliminon procesin hetimor në gjykatë, shqyrtimin gjyqësor, por e bazon shqyrtimin gjyqësor vetëm mbi faktet.

Debat ka mbi ato akte. Debat në procedurën e gjykimit të shkurtuar ka mbi aktet. Referohet vetëm në aktet. Gjykimin e shkurtuar mos e ngatërrojmë me procedurën e gjykimit të shkurtuar në civile, që ta thotë vetë dispozita që përcaktohet hyrja...

(Ndërhyn zoti Toro pa ndezur mikrofonin.)

Ka gjykim të shkurtuar tamam. Ta parashikon neni 162 i K.Pr.C. që thotë është pjesa hyrëse e dispozitivit. Në këtë rast ky vendim kështu është. Por nuk është gjykim i shkurtuar në civile, në fakt, është gjykim i shkurtuar në procesin penal, që do të thotë që shqyrtohet çështja mbi aktet. Edhe publiciteti lidhet mbi aktet. Kështu që ky interpretim apo oponencë nuk ka lidhje me arsyetimin e vendimeve.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Po zoti Hado!

Ridvan Hado: Unë kur fola për pranueshmërinë e vendimit nga palët në gjykim, nuk kisha parasysh pranimin e të pandehurit që po pranon apo s'po pranon fajësinë. Desha të them që drejtësia ia ka arritur qëllimit që vendimmarrja ka qenë e saktë dhe nga ana tjetër thashë që këto janë vendime rutinë, vendime me gjykim të shkurtuar për vepra të thjeshta penale shumë të thjeshta, të kuptueshme qartësisht. Nuk e di çfarë duhet të bënte. Aty është thënë që nuk ka dispozitën konkrete. Neni 383 i K.Pr.Penale në përmbajtjen e vendimit nuk thotë që ta citosh dispozitën. Është cituar dispozita si numër. Shkurtimisht është bërë një arsyetim pse është dënuar i pandehuri, apo tek vendimet e seancës paraprake. S'është përdorur jurisprudenca relevante. S'ka nevojë për jurisprudencë aty. S'ka vendim të koklavitur. S'ka ndonjë vendim që duhet të bënte shkencë gjyqtari. Në këtë kontekst e kisha të gjithë atë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Në fakt, siç e relatova më parë, Këshilli nuk i hyn atë çfarë është vendosur, por si është arsyetuar ajo që është vendosur. Në ligj parashikohet që vlerësohet në nivel "Shkëlqyeshëm" kur gjyqtari shfaq një nivel...spikat në atë që është shkruar. Në këtë rast në vendimet gjyqësore mungon tërësisht interpretimi i ligjit, argumenti logjik, por gjyqtari pas parashtrimit të rrethanave del direkt në konkluzione, duke nënkuptuar që nga këto rrethana të faktit del konkluzioni përkatës për deklarinimin fajtor apo duke thënë që në caktimin e masës së dënimit mbajti parasysh moshën e të pandehurit (pa përcaktuar moshën) dhe këtë e gjejmë tek pjesa hyrëse (po nejse), arsyet shëndetësore (pa përcaktuar kush janë këto arsye shëndetësore). Domethënë ka vetëm një analizë të përgjithshme. Nuk është analizë, por është konkluzion në fakt. Është vetëm konkluzion.

Procedura e vlerësimit është përcaktuar mbi këto burime vlerësimi. Nuk i shpik unë burimet e vlerësimit. Është zgjedhur në një procedurë të përzgjedhur me short.

Gjithsesi është lënë e drejta që gjyqtari të përzgjedhë dy vendime ku të spikasë arsyetimi i tij. Në dy vendimet e përzgjedhura (është evidentuar në burim vlerësimi) nuk dalin në mënyrë të qartë kush janë rrethanat e faktit, as arsyetimi, asnjë gjë. Janë dy vlerësime të përzgjedhura. Kemi vlerësuar edhe gjyqtarë të tjerë ku nuk kanë pasur një elaborim të madh të jurisprudencës por që mund të ketë vend për jurisprudencë po. Se unë nuk e kuptoj për shembull 199/a, “b” që është dënuar për 1-shin apo për 2-shin, pse është pranuar gjykimi i shkurtuar njëherë në qoftë se i ka ndryshuar cilësimi? Se në radhë të parë ka praktikë të Gjykatës Kushtetuese që thotë në rastet e ndryshimit të cilësimit, nuk pranohet gjykimi i shkurtuar.

Jo, jo, nuk i hyj meritës së çështjes. Unë them çfarë ka vendosur gjyqtari, në kuptim si i ka analizuar ato gjëra.

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Unë kam një diskutim lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve, duke qenë se pjesa e parë është subjektive në mënyrën se si secili nga ne anëtarët e vlerëson mënyrën se si shkruhet një vendim gjyqësor. Por sigurisht që duhet të kemi kujdes të mos japim mesazhe të gabuara në pjesën që çështjet që janë të lehta duhen shkruar me një kujdes ose më koncize sesa çështjet që janë më të vështira sepse gjyqtarët na dëgjojnë edhe e pasqyrojnë pastaj atë çka themi ne në punën e përditshme.

Për sa i përket rendimentit të përfundimit të çështjeve, ia ngrita si pyetje edhe zotit Como në seancë sepse sigurisht që ai gjatë vitit 2021 ka ushtruar detyrën e Zëvendëskryetarit ose kryetarit në detyrë në një nga gjykatat më të rëndësishme dhe që ka volum pune më të madh në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Numri i çështjeve të gjykuara është shumë i vogël, dhe numri i çështjeve të caktuara. Domethënë nëse gjyqtarët gjatë kësaj kohe kanë pasur ngarkesë pune mbi 500 çështje, duket që ai ka marrë pjesë në short në më pak se 50%, mos them 10% të të gjithë ngarkesës totale. Pra ka përfunduar 116 çështje dhe i janë caktuar vetëm 120 çështje. Ndërkohë që çështje me palë kundërshtare kanë qenë vetëm 78. Në këto kushte unë nuk mendoj si relatorja e cila

e ka rritur me një nivel rendimentin. Unë mendoj që rendimenti duhet të pikëzohet aq sa është përqindja matematikore, 8 pikë. Pse? Sepse këtë “bonus” që e marrin kryetarët, e marrin për shkak të ushtrimit të funksionit dhe nuk futen në short. Pra ata ngarkesën e kanë të reduktuar në krahasim me gjyqtarët e tjerë. Vetë ushtrimi i funksionit të zëvendëskryetarit nuk mund të përbëjë shkak për rritjen e pikëzimit sepse e ke marrë një herë bonusin. Në qoftë se gjyqtarët e tjerë kanë marrë 500, 600, 700 çështje, ka marrë vetëm 100 çështje. Dhe ka pasur edhe kryetarë që ne kemi vlerësuar, të cilët kanë gjykuar gjatë kësaj periudhe me ngarkesë të plotë sikundër edhe gjyqtarët e tjerë. Nuk po flas për Gjykatën e Tiranës sepse sigurisht është e pamundur që të gjykosh me një ngarkesë të plotë dhe kryesh funksionin e menaxhimit. Por për numrin e çështjeve të gjykuara dhe për numrin e çështjeve të caktuara nuk e shikoj të arsyeshme që të rritet me një nivel rendimenti. Unë personalisht këtë qëndrim kam mbajtur edhe në raste të tjera kur kryetarët e gjykatave kanë gjykuar një numër shumë të vogël çështjesh në raport me gjyqtarët e tjerë. Nuk është rritur në asnjë rast rendimenti nga 8 pikë, në 10 pikë. Prandaj propozoj që për këtë tregues rendimenti të jetë 8 pikë dhe jo 10 pikë.

Ilir Rusi: Po zoti Toro, fjala për ju!

Alban Toro: Nisur nga diskutimi i fundit i cili konsistonte në faktin e përcjelljes së mesazheve të gabuara gjyqtarëve që teorikisht nuk duhet ta arsyetojnë siç duhet vendimin, të paktën kështu e kuptova, më rezultoi të paktën nga ato që unë thashë deri tani dhe që kam theksuar në të gjithë rastet e tilla të debateve, që vendimi duhet të jetë i formatuar sipas urdhërimeve të posaçme të Gjykatës Kushtetuese për një arsyetim vendimi gjyqësor. Atë thashë dhe kur citova vendimet që kanë shërbyer si burim vlerësimi. E vetmja veçanti në rastin konkret ishte specifika që ishte “garancitë procedurale dhe publiciteti ishin pak të lehtësuara” siç ka thënë GJEDNJ-ja. Mund të përcjellë edhe vendimin “Kwiatkoxska kundër Italisë” me nr. 52868/99, pra është vetë lloji i procedurës e cila nuk implikon një arsyetim të ndërlikuar, të gërshetuar, por kjo s’do të thotë të jetë pa arsyetim, dhe sinteza e vetme do të jetë ajo që ka përcaktuar për arsyetimin gjyqësor Gjykata Kushtetuese. Kështu që në këtë kontekst nuk besoj se kam

përcjell ndonjë mesazh apo kam pasqyruar ndonjë ide të gabuar për gjyqtarët të cilët do duhet t'i arsyetojnë dhe do duhet t'i bëjnë vendimet në mënyrë të kuptueshme atyre që u drejtohen. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Fjala për ju zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Të gjithë folën, duhet të flas edhe unë për këtë pjesën.

Nuk kisha ndërmend të flisja, por për sa kohë rrjedha e debatit shkoi në një drejtim të paparashikuar për mua, thashë të them edhe unë mendimin tim në lidhje me këtë situatë dhe konkretisht me gjyqtarin {...}.

Në lidhje me projektraportin e paraqitur, mënyrën se si janë ofruar të dhënat, se si është bërë analiza e këtyre të dhënave, se ku janë identifikuar momente ku duhet të ketë mundësi dhe ekziston mundësia për përmirësimin e punës së gjyqtarit apo aty ku gjyqtari e ka dhënë maksimumin e mundshëm, dakordësohem, domethënë nuk kam asnjë lloj diskutimi në lidhje me ato se çfarë ka gjetur gjatë punës relatorja dhe që na i ka prezantuar në aktualisht. Megjithatë do të shtoja dy situata të cilat mua dukshëm më bëjnë të mendoj pak ndryshe. Dhe cilat janë këto?

Është përvoja e gjyqtarit, e para, që nuk e hasa në raport.

E vërtetë është fakti, thashë, me ato të dhënat dakordësohem. Përvoja në punë e gjyqtarit. Është një gjyqtar që së pari është i vlerësuar për shkak të punës që ai ka bërë, nga organet që kanë pasur në atë kohë detyrimin për të vlerësuar gjyqtarët. Kjo është e para. E dyta, përvoja në detyrë e këtij gjyqtari është jashtëzakonisht e madhe. Ai është në prag të përfundimit të karrierës. Ndoshta e ka përfunduar edhe karrierën. Në këtë pikë vazhdoj të mbaj atë qëndrim që kam mbajtur edhe për një gjyqtar, koleg tjetër, ku përvoja e tij ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Nuk kundërshtoj të dhënat. Domethënë, të sqarohemi bashkërisht. Por nuk shoh një proporcionalitet të drejtë në vlerësimin që është dhënë, duke iu referuar disa cilësive dhe rrethanave që i takojnë gjyqtarit, e thashë, që është në përfundim të karrierës së tij. Cilat janë, që të kaloj edhe konkretisht.

Tek rubrika e aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Jam dakord

me gjetjet e bëra, me konstatimet e bëra, por referuar parimit të proporcionalitetit, duke iu referuar përvojës së madhe të këtij gjyqtari, unë nuk mund të mendoj sot që ky gjyqtar nuk ka aftësi të mira për të interpretuar ligjin, nuk e mendoj dot. Me të vërtetë mund të ketë shkaqe për të bërë atë vlerësim që është bërë por në këtë lloj vlerësimi, duhet të merret në konsideratë, po them unë tani, edhe përvoja e tij. Gjyqtarët me përvojë të gjatë, ndonjëherë janë kaq të bindur në ligjin që zbatojnë, saqë e anashkalojnë pjesën e kësaj rubrike që me të vërtetë është e rëndësishme. Por kjo nuk do të thotë që ai nuk e di, por e kalon këtë pjesë. Pse? Arsyeja (vazhdoj të mbetem tek ajo që thashë) është për shkak se e ka praktikë pune, është përvojë e jashtëzakonshme jetësore, që ai e di përmendsh ligjin. Në këtë pikë nuk më shkon proporcionaliteti i vlerësimit, pra “nën mesatare” një gjyqtar që është në prag të mbylljes së karrierës. Nuk më shkon.

Unë do propozoja në këtë rast, duke iu referuar rrethanave të veçanta që lidhen me cilësitë dhe përvojën e tij, do propozoja që të paktën ky tregues të shkojë “mbi nivelin mesatar”. Nuk po shkojmë tek maksimumi sepse thashë, dakordësohem me të dhënat e grumbulluara. Ato janë. Nuk i diskutojmë. Por ka edhe ca elementë të tjerë që unë i marrë në konsideratë për të propozuar ose për të bashkëpropozuar me zotin Hallunaj, nivelin, nga niveli “nën mesatar” i një gjyqtari që është në prag të mbylljes së karrierës, në nivelin “mbi mesatar”. Kjo është pjesa e parë. I referohem vetëm një treguesi, “Aftësia për të interpretuar ligjin”. Jemi në fund të karrierës.

E dyta, “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”. Edhe ky është një tregues tjetër të cilin e nxjerr gjyqtarin me ato të dhëna të ofruara, në atë analizë të bërë, e ka nxjerrë gjyqtarin duke propozuar 15 pikë, nën nivelin mesatar. Është i njëjti qëndrim që kam mbajtur edhe me një koleg tjetër më përpara. Referuar të njëjtave rrethana dhe të dhëna, përvojë e gjatë, përfundim karriere. Nuk e mendoj që gjyqtari nuk ka cilësi analize dhe nuk mund të argumentojë logjikisht në një proces vendimmarrjeje që ai nuk e ka për herë të parë por e ka ndoshta në fund të karrierës së tij dhe them edhe një herë, për proporcionalitet, referuar përvojës së madhe të gjyqtarit dhe fundit të tij të karrierës, referuar edhe arsyeve të vlerësimeve të mëparshme që i janë bërë këtij gjyqtari në punën e tij dhe për fat ndoshta ky mund të jetë vlerësimi i fundit që ne bëjmë për këtë gjyqtar, se mbase s’kemi dhe arsye për të bërë vlerësime të tjera, për proporcionalitet propozoj që

edhe në këtë rast (ose bashkëpropozoj) që në “Cilësinë e analizës” gjyqtarit t’i ngrihet niveli i vlerësimit nga “mesatar” në “mbi mesatar”, domethënë nga 15 t’i shtohet edhe 5 pikë dhe të shkojë në 20 pikë në total.

Faleminderit për vëmendjen. Kaq kisha në lidhje me atë çfarë i referohet gjyqtarit {...}. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Fjala për zonjën Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, për sa i përket vjetërsisë së gjyqtarit.

Në fakt, po ta shikosh në të gjithë projektraportin e vlerësimit, unë vlerësoj se e kam marrë parasysh, në radhë të parë. Sepse nuk është vlerësuar komplet mungesë arsyetimi, por është çuar “nën mesatare” megjithëse në atë rast ka pasur... Unë nuk diskutoj në asnjë rast aftësinë e gjyqtarit për të dhënë një vendim. S’është diskutuar fare. Është diskutuar atë mbi bazë të burimeve të vlerësimit. Ne kur vlerësojmë një gjyqtar, i referohemi vetëm burimeve të vlerësimit, jo emrit se kush është gjyqtarit dhe jo vjetërsisë së tij në punë.

Gjithashtu sjell në vëmendje që po nga ky Këshill, me të njëjtën vjetërsi, mbase pak më shumë, është vlerësuar një gjyqtar në nivelin “Mirë” dhe asnjë nga anëtarët këtu nuk ka pasur kundërshtime për atë vlerësim të bërë. Kishte një vjetërsi shumë më të madhe.

Për sa i përket fundit të karrierës, gjyqtari në radhë të parë është në një procedurë ngritjeje në detyrë për të cilën është bërë edhe vlerësimi i përshpejtuar. Unë nuk paragjykoj se kur mund të përfundojë gjyqtari por është në një procedurë, ashtu si edhe gjyqtari tjetër me vjetërsi pak më të madhe, neve vjetërsinë tek vlerësimi... nuk është rrethana që mbahet parasysh, por përcaktohet në bazë të burimeve të vlerësimit. Pse? Nuk bëjmë ngritje në detyrë në bazë të vjetërsisë. Një nga aspektet që ne çojmë në ngritje në detyrë është vlerësimi, i cili duhet të jetë objektiv në bazë të meritokracisë, më pas ngrihet në detyrë. Kështu që unë mbi bazën e këtyre standardeve kam bërë këtë vlerësim. Faleminderit!

Klodian Kurushi: Vetëm një sqarim të vogël dhe e mbylla këtë pjesën.

Mirë bërë që bën edhe krahasime me të tjerët. Tani e nxore edhe pjesën e krahasimit. Mos më ndërprit tani. E bërë krahasimin me tjetrin dhe mu referove mua. Mirë bërë që e bërë këtë pjesën. Por më duhet të sqaroj diçka. Kur iu referova këtij gjyqtari, iu referova edhe ca elementëve të tjerë. Ky është vlerësuar një herë nga disa organe të tjera. Pra jo vetëm vjetërsia, por ka edhe ca elementë të tjera shtesë që mos t'i harrojmë, t'i vëmë edhe në dukje. Është dekoruar ky gjyqtar për punën që ka bërë deri tani, e para. Është e vërtetë që mund të themi shiko, nuk hyjnë as dekoratat, as vlerësimet, -po atëherë pse jemi këtu ne pastaj në Këshill? Atëherë, s'ka problem. E çojmë në kompjuter, hedhim të dhënat dhe e mbyllim pastaj. Po për çfarë jemi këtu ne? Për çfarë duhet të diskutojmë? As për vjetërsinë nuk duhet të diskutojmë? Keni mendim ndryshe, unë kam një mendim ndryshe. Patjetër që do ta diskutojmë edhe vjetërsinë, edhe kontributet që ka dhënë me kohë dhe s'ka pasur mundësi të vlerësohet edhe në atë kohë. Ka rrethana të cilat duhet të merren në konsideratë edhe në procesin e vlerësimit, se jemi njerëz. Kjo, e kam thënë dhe do vazhdoj ta them, është marrëdhënie shoqërore, nuk jemi shkenca ekzakte. Kështu që në këtë pikë shkurtimisht unë shkoj tek parimi i proporcionalitetit, siç e kemi bërë edhe në raste të tjera, i kemi ndryshuar nivelet. Po, i kemi ndryshuar nivelet.

(Zonja Plaku ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Klodian Kurushi: Do t'i them, por jo me emra, do t'i them edhe rastet e ndryshimeve në nivele.

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse nuk ka propozime të tjera nga anëtarët prezent në mbledhje, po vazhdojmë me votimin e propozimeve përkatëse të bëra nga anëtarët.

Fillimisht po hedhim propozimin e parë i cili në vijueshmëri është i njëjtë me propozimin e dytë të bërë, pra zoti Hado dhe zoti Hallunaj propozojnë që tek rubrika "Aftësitë profesionale të gjyqtarit", konkretisht "Njohuritë ligjore", "Aftësia për të

identifikuar natyrën e çështjes ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” të bëhet një vlerësim nga 20 në 25 pikë, duke shtuar 5 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Nuk u dëgjua vota.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet propozimi me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Hedhim në votim propozimin e dytë të bërë nga zoti Hado, që ka të bëjë me rubrikën “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, konkretisht “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të interpretuar...” (ndërpritet audio).

Në vijim të asaj çfarë po thoja, po vazhdojmë me votimin e propozimit të dytë të bërë në rastin konkret nga zoti Hado, në lidhje me rubrikën “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, nga zoti Hado propozohet një vlerësim nga 10 në 25 pikë, duke shtuar 15 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër, meqenëse për këtë pikë kam pasur propozimin tim.

Ilir Rusi: Kundër.

(7 vota kundër dhe 3 vota pro. Nuk miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e dytë por që është i njëjtë me propozimin e tretë, fillimisht u bë nga zoti Hallunaj dhe pastaj nga zoti Kurushi, në lidhje me po këtë rubrikë Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, konkretisht “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, dhe në vijueshmëri të diskutimeve u propozuar që të bëhet një vlerësim nga 10 në 20 pikë, pra duke shtuar 10 pikë dhe duke e rritur nivelin përkatës. Kështu që po hedhim në votim propozimin e dytë dhe të tretë të bërë për këtë rubrikë nga zoti Hallunaj dhe zoti Kurushi, me një shtesë prej 10 pikësh.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord në kushtet kur propozimi im për nivelin shumë të lartë me 25 pikë nuk u pranua, jam dakord me propozimin e zotit Hallunaj për 20 pikë. Faleminderit!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(7 vota pro dhe 3 vota kundër. Miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e parë të bërë nga zoti Hado por që në vijueshmëri u bë edhe nga zoti Hallunaj dhe është i njëjtë në këtë rast për rubrikën “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, “Arsyetimi ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, propozohet nga të dy, zoti Hado dhe zoti Hallunaj që të kemi një vlerësim nga 12 në 15 pikë, pra duke shtuar 3 pikë. Vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(7 vota pro dhe 3 vota kundër. Miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e katërt të bërë nga zoti Hado që ka të bëjë me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, konkretisht rubrika “Arsyetimi ligjor”, “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, nga zoti Hado propozohet një vlerësim nga 8 në 10 pikë, pra duke shtuar 2 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Kundër.

(5 vota pro dhe 5 vota kundër. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese (ref. neni 68/6 i ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar). Nuk miratohet propozimi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin e propozimit të parë fillimisht bërë nga zoti

Hado në lidhje me rubrikën “Aftësitë profesionale”, në lidhje me “Arsyetimin ligjor”, “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, nga zoti Hado propozohet një vlerësim nga 15 në 25 pikë, duke e rritur 10 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(7 vota kundër dhe 3 vota pro. Nuk miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin ku nga diskutimet rezultoi që të jetë i njëjti propozim për këtë rubrikë si nga zoti Hallunaj dhe nga zoti Kurushi, në lidhje me “Aftësitë profesionale”, rubrika “Arsyetimi ligjor”, pikë c. “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, nga zoti Hallunaj dhe zoti Kurushi propozohet një vlerësim nga 15 në 20 pikë, duke e shtuar 5 pikë. Vazhdojmë me votimin e dy propozimeve.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Në kushtet kur propozimi im për vlerësimin “shumë i lartë” me 25 pikë u rrëzua, atëherë jam dakord me propozimin për vlerësimin me 20 pikë. Faleminderit!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(7 vota pro dhe 3 vota kundër. Miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e zonjës Ukperaj, në lidhje me rubrikën “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, pika ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, nga zonja Ukperaj propozohet nga një vlerësim 10 pikë të propozuar nga relatorja, në një vlerësim 8 pikë, duke u ulur me 2 pikë.

Irena Plaku: Unë votoj pro propozimit, pavarësisht se e kam propozuar në të njëjtën pikë me 10 pikë, duke qenë se në fakt nuk kam pasur dijeni për praktikën që është mbajtur më parë në Këshill para se unë të vija në Këshill, edhe unë i qëndroj propozimit të zonjës Ukperaj duke i ulur 2 pikë.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin e Brikenës. Jam dakord.

Ilir Rusi: Kundër.

(7 vota kundër dhe 3 vota pro. Nuk miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim projektvendimin, duke u bërë pjesë e saj të gjitha ndryshimet që ndodhën për shkak të propozimeve, diskutimeve dhe miratimeve me votë nga ana e anëtarëve prezent në mbledhje, sipas rubrikave përkatëse.

Irena Plaku: Unë i qëndroj propozimit të parë që është bërë në projektraport, për këtë arsye jam kundër vlerësimit duke qenë se u ndryshuan të gjitha nivelet e vlerësimit. Dhe i qëndroj vlerësimit siç kam propozuar vetë. Për këtë arsye do bëhet edhe vendimi i

pakicës.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër, pasi vlerësoj që niveli i vlerësimit duhet të ishte “Mirë” dhe jo “Shumë mirë”.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(Me shumicë votash, miratohet akti në tërësi.)

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit { ... }, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EËMI).*
- 6. Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 9. {...}, gjyqtar.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje plenare që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Ukperaj. Gjithashtu zoti {...} është prezent në këtë mbledhje plenare për të paraqitur parashtrimet e veta pasi të përfundojë fjalën relatorja.

Fjala për ju zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në vijim do të parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Është një vlerësim që ne bëjmë mbas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Në pjesën e parë shpjegohet procedura. Pjesa e dytë e projektraportit përmban në mënyrë të detajuar dhe analitike të dhënat e burimeve të vlerësimit të ndarë sipas grupeve përkatëse, në të cilën përfshihen aktet dhe dokumentet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit nga organet e rivlerësimit të listuara në projektraport. Në pjesën pikërisht të këtyre akteve doja të ndalesha kryesisht në vendimet e administruara për shkak të ankesave ose ato të administruara kryesisht nga organet e rivlerësimit që i përkasin periudhës 2013-2016.

Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit e cila përmban aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarit nuk rezulton që të jenë administruar vendime në kuadër të trajtimit të ankesave dhe denoncimeve nga publiku.

Lidhur me denoncimet nga publiku referuar vendimit 393, datës 03.06.2021 të KPK-së rezulton se për subjektin e vlerësimit {...} ishin paraqitur 21 denoncime nga të cilat vetëm për një prej tyre janë kërkuar shpjegime gjyqtarit. Pas verifikimit dhe analizimit të provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga gjyqtari, KPK ka konkluduar se shpjegimet e tij janë bindëse.

Ndërkohë që gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar janë paraqitur dy gjetje të vëzhguesit ndërkombëtar në lidhje me vendimmarrjet e ish-KLD-së në vendimin e KPK-së ku konkludohet se: Këto gjetje nuk përbëjnë shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit pasi nuk ndikojnë në aftësinë profesionale të tij si dhe nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar të papërshtatshëm subjektin për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat, prandaj këto dy gjetje i janë përcjellë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Pra ka pasur dy gjetje të vëzhguesit ndërkombëtar, të cilat i janë përcjellë ILD-së për analizimin e tyre në kuadër të shkeljeve disiplinore.

Ndërkohë që ILD pasi ka administruar aktet dhe në zbatim të vendimit të KPK-së,

me vendimin nr. 3181/2, datë 29.03.2022 ka arsyetuar: Në rastin konkret, nga të dhënat e parashtruara në gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar si dhe të dokumentacionit të paraqitur nuk jepet asnjë e dhënë qoftë edhe indicie që të krijonte dyshime të arsyeshme se vlerësimi nga anëtarët e ish-KLD-së, ku përfshihet edhe magjistrati {...}, të jetë përtej bindjes së tyre të brendshme, e garantuar si një vlerë themelore në nenin 3 të ligjit “Për statusin”. Më pas, në kuadër të këtij shqyrtimi fillestar ILD ka konkluduar se në rastin konkret janë pretenduar dhe paraqitur fakte të qarta dhe të mjaftueshme si dhe janë shoqëruar me prova, për të cilat nuk krijohet një dyshim i arsyeshëm i cili mund të justifikojë fillimin e një hetimi disiplinor.

Veç analizës nga ILD të këtyre dy gjetjeve, edhe KPA-ja me vendimin nr. 27, datë 06.07.2022 i cili ka lënë në fuqi vendimin e KPK-së ka marrë në shqyrtim pretendimet e vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me dy gjetjet prej tij dhe i ka analizuar dhe pasi i ka analizuar në kuadrin ligjor të rivlerësimit, ka konkluduar se pretendimet lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, në thelb, kanë të bëjnë me çështje, zgjidhja e të cilave nuk i përket juridiksionit dhe kompetencës së kolegjit. Në projektvendim është pasqyruar edhe pjesa arsyetuese e KPA-së.

Gjatë procesit të gradimit, në cilësinë e vlerësueses, kam konkluduar se: Në zbatim të nenit 171, pika 5 e ligjit “Për statusin”, procesin e gradimit që Këshilli duhet të fillojë me përparësi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, përfshin çdo dokument të përdorur nga organet e rivlerësimit, për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit. Referuar të dhënave si më sipër, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, në gjetjet e administruara të cilat konsistojnë pikërisht në qëndrimin që gjyqtari kishte mbajtur si anëtar i KLD-së, në rastin e parë kur është propozuar një masë disiplinore për një gjyqtar dhe në rastin e dytë për trajtimin e një kërkesë për leje të papaguar për një gjyqtar tjetër, pikërisht në qëndrimin e gjyqtarit, nuk konstatoheshin elementë që duhet të analizoheshin në vlerësimin e kriterëve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, pasi objekti i vlerësimit etik dhe profesional është veprimtari e tij gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar. Nga ana tjetër, në sjelljen dhe qëndrimin e gjyqtarit si ish-anëtar i KLD-së, nuk evidentohen as elementë që mund të nikojnë në vlerësimin e kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

dhe as janë konstatuar elementë të tillë nga organet e rivlerësimit kalimtar apo ILD.

KLD ka qenë një organ kolegjal dhe zoti {...} në cilësinë e anëtarit të këtij organi, duke marrë pjesë në procesin e diskutimit dhe atë vendimmarrës lidhur me një çështje të rendit të ditës, nuk ka pasur një pozitë të veçantë apo raport të ndryshëm me anëtarët e tjerë pjesëmarrës në mbledhje. Ai e ka ushtruar funksionin duke mbajtur qëndrimin e tij bazuar në interpretimin e normave juridike në fuqi, në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes konkrete të shtruar për diskutim.

Në të njëjtën linjë arsyetimi me KPA, të dhënat mbi gjetjet e mësipërme nuk afektojnë kriterin e “Aftësive profesionale dhe organizative” dhe as të të “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, në kushtet kur nuk janë konstatuar dhe as konstatohen sjellje apo qëndrime jo etike të gjyqtarit gjatë ushtrimit të veprimtarisë si ish-anëtar i KLD-së.

Qëndrimi i gjyqtarit si anëtar i organit kolegjal nuk mund të vlerësohet si matës i aftësive të tij profesionale për sa kohë implikohet drejtpërdrejt bindja e brendshme dhe logjika e gjyqtarit anëtar i ish-KLD-së mbi vlerësimin e rrethanave, fakteve në çështjen konkrete dhe në interpretimin e normave penale dhe atyre administrative.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, objekti i shqyrtimit kanë qenë edhe pretendimet lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit si dhe dokumentimin e seancave gjyqësore me regjistrim audio në çështjen penale të përfunduar me vendimin nr. 1822, datë 26.12.2013. Kolegji pasi ka analizuar situatën faktike ka vlerësuar se: Në përfundim të shqyrtimit të analizës së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, për pasojë nuk evidentohen veprime në shkelje të dispozitave të ligjit “Për statusin”, të tilla që do të afektonin aftësitë e tij profesionale apo do të çojnë në konkluzionin se nga vlerësimi tërësor i çështjes subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut.

Çështja objekt shqyrtimi rezulton që të jetë një nga dosjet e përzgjedhura me short dhe si e tillë përbën burim vlerësimi për efekt të procesit të gradimit dhe jo më kotë e citova qëndrimin e mësipërm i cili afekton sigurisht edhe analizën time si relatore lidhur me kriteret përkatëse të vlerësimit.

Lidhur me burimet arkivore të KLD-së për informacionet e paraqitura rezulton se për gjyqtarin {...} gjatë periudhës së rivlerësimit janë paraqitur 7 ankesa të cilat janë arkivuar sepse disa prej tyre janë gjetur të pabazuara në kushtet kur pretendimet zgjidhen nëpërmjet rrugës së ankimimit gjyqësor, ndërsa disa të tjera për shkak se nuk përmbajnë elementë që lidhen me shkelje disiplinore. Në asnjë prej këtyre ankesave (janë administruar të gjitha informacionet përkatëse nga arkiva që zotëron KLGJ-ja) nuk evidentohen elementë që mund të analizohen në drejtim të etikës apo integritetit të gjyqtarit.

Këto për sa i përket burimeve të vlerësimit, që doja që t'i citoja.

Burimet e vlerësimit përmbajnë edhe të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtarit në aktivitete trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit. Burim vlerësimi shërben edhe raporti për analizimin e aftësive profesionale që ka përgatitur Këshilli për gjyqtarin {...} si dhe dy vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Grupi i dytë i çështjeve që përbëjnë burim vlerësimi janë çështjet e përzgjedhura me short. Janë 6 çështje të cilat janë këqyrur dhe nga analiza e tyre ka rezultuar... gjithçka pasqyrohet në projektraport lidhur me të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit. Ka një pjesë “konkluzione” ku është evidentuar e gjithë ecuria procedurale e çështjeve të analizuara.

Po vijoj me propozimet e mia si relatore me 4 kriteret e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit duke filluar me "Aftësitë profesionale". Po i citoj në mënyrë të përmbledhur, duke qenë se raporti është shumë i detajuar.

Sa i përket treguesit 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, propozimi im si relatore është për vlerësimin e gjyqtarit në shkallën e aftësisë shumë të lartë duke e pikëzuar me 25 pikë, pasi ka rezultuar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, analizën dhe vlerësimin individual të tyre, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Për sa i përket 1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, pasi janë analizuar burimet e vlerësimit në drejtim të interpretimit të ligjit material dhe atij

procedural të zbatueshëm, në drejtim të aftësisë për të përdorur jurisprudencën relevante dhe vënien në zbatim të parimeve të përgjithshme të së drejtës, kam konkluduar që gjyqtari duhet të vlerësohet në shkallë shumë të lartë aftësie, 25 pikë, pasi nga tërësia e burimeve të vlerësimit ka rezultuar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Parimet e përdorura në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e së drejtës, integrohen në arsyetim në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjes.

Lidhur me treguesin tjetër 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, pas analizës së burimeve të vlerësimit kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie, pikëzimi 15 pikë, pasi rezulton dukshëm aftësi shumë e lartë e gjyqtarit lidhur me zgjidhjen dhe përdorimin e fjalëve, organizimin e tyre në fjali dhe më tej, grupimi i fjalive në paragrafët e vendimit, çka lejon një lexim të organizuar. Kjo mënyrë e shkrimit ligjor, evidenton aftësinë e gjyqtarit për të gjetur balancë mes të shprehurit thjesht dhe qartë dhe renditjes të argumentimit ligjor sipas një rrjedhe logjike të kuptueshme.

Për sa i përket 1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit gjithashtu kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie, pasi është evidentuar se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Pothuajse në të gjitha vendimet sa mund të thuhet që spikat vendimi që kur e lexon që i përket gjyqtarit. Ka një autenticitet të vendimit në mënyrën se si shkruhet vendimi. Zbatohen rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe i kushton vëmendje ndjekjes së një strukture të njëjtë në organizimin e vendimit, e cila paraqitet e qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e rrjedhshmërisë logjike. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Për sa i përket treguesit të fundit të kriterit të parë 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik, gjithashtu kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie, për shkak se

cilësia e analizës dhe argumentit logjik në të gjitha dokumentat ligjorë (pra vendimet gjyqësore të analizuara) ndjek rregullin fakt-normë-interpretim dhe konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarit në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, të cilat e pasurojnë arsyetimin e vetë gjyqtarit. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe është gjithëpërfshirës për sa i përket pretendimeve dhe kërkimeve të palëve, apo edhe çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Përfundimisht për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” kam propozuar nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket kriterit të dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, 2.A.a Respektimit të afateve ligjore, nga të gjitha dosjet e analizuar nuk ka rezultuar se për asnjë prej tyre të jetë parashikuar afat ligjor për përfundimin e çështjes dhe pavarësisht se në dosje nuk kemi të dhëna statistikore për të gjitha çështjet e gjykuara gjatë asaj periudhe, vlerësimi i është bërë vetëm për çështjet e përzgjedhura dhe ato që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit, mbi të cilat është propozuar edhe pikëzimi me 15 pikë, pasi nuk ka pasur çështje të gjykuara tej afatit ligjor.

Për sa i përket 2.A.b Plotësimi të standardeve minimale kohore, pasi janë analizuar të gjitha dosjet e përzgjedhura me short si gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar ashtu edhe gjatë procesit të gradimit ka rezultuar se vetëm një çështje e përfunduar tej standardit, e cila në 11 çështje të analizuar zë vetëm 9% të tyre dhe për këtë arsye, referuar metodologjisë është propozuar pikëzimi me 5 pikë që është pikëzimi maksimal.

Për sa i përket 2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar që koha mesatare për çdo kategori çështjesh për të cilat zbatohet standard minimal, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal i miratuar, prandaj është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket 2.A.ç Rendimentit të përfundimit të çështjeve, në analizë matematikore por edhe logjike të të dhënave statistikore, ka rezultuar një rendiment në masën 97,89%, i cili sipas metodologjisë përkon me pikëzimin prej 8 pikë. Por në rastin

konkret ka rezultuar që gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës. Kështu në vitin 2013 ka gjykuar 22% më shumë se standardi; - për vitin 2014 ka gjykuar 91% më shumë se standardi; - për vitin 2015 ka gjykuar 123% më shumë se standardi; - për vitin 2016 ka gjykuar 63% më shumë se standardi; dhe në total ka gjykuar 699 çështje krime dhe kundravajtje ose rreth 75% më shumë se standardi sasior i punës. Prandaj në këto kushte kam vlerësuar që shkalla e aftësisë së gjyqtarit duhet të vlerësohet me pikët maksimale duke e rritur nivelin e pikëzimit me një shkallë nga ai që përkon me analizën matematikore.

Për sa i përket 2.A.d Kohës mesatare të arsytimit të vendimit, të gjitha vendimet janë të arsyetuara brenda afatit. Ka pasur vetëm për një kategori çështjesh me vetëm 3 ditë, tejkalim i papërfillshëm (duke marrë parasysh edhe fundjavat) dhe për këtë arsye vlerësimi propozohet të jetë me 15 pikë.

Për sa i përket 2.B.a. Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale, në projektraport është analizuar në mënyrë të detajuar një dosje e cila rezulton që të jetë analizuar edhe gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar (e citova edhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me këtë dosje). Ka pasur një mospërputhje në fakt në konkluzionet që Këshilli ose KLGJ-ja ka paraqitur në projektraportin analitik që i ka dërguar organeve të rivlerësimit. Propozimet e tyre lidhur me shkallën e aftësisë së gjyqtarit ishin të bazuara mbi aktet të cilat nuk ishin akte të plota të dosjes gjyqësore. Gjatë procesit të rivlerësimit pasi janë dokumentuar aktet e plota të dosjes është konstatuar që të dhënat e raportit analitik nuk përputheshin për sa i përket mbikëqyrjes së njoftimeve nga ana e gjyqtarit dhe për sa i përket shpjegimeve që gjyqtari kishte dhënë lidhur me zhvillimin e seancave audio.

Ka qenë pikërisht një çështje për të cilën ishin zhvilluar 47 seanca gjyqësore, nga të cilat 31 seanca kishin rezultuar jo produktive, 4 seanca për mosformim të trupit gjykues, 13 seanca për mosparaqitjen e prokurorit, 10 seanca për mosparaqitje të pandehurit dhe mbrojtësit të zgjedhur, 4 seanca për mosparaqitjen e dëshmitarëve. Seancat ishin shtyrë për shkaqe të tilla si njoftim dëshmitarësh, shqyrtim kërkesash për përjashtim gjyqtari, njoftim mbrojtësi, lënie kohë prokurorit për të paraqitur prova, etj., pasi gjykimi ka qenë në procedurën e gjykimit të zakonshëm.

Lidhur me administrimin e procesit gjyqësor për këtë çështje, Kolegji ka vlerësuar se shtyrjet e seancave gjyqësore për shkak të angazhimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit (gjyqtarit) kanë qenë të justifikuar, megjithatë trupi gjykues çmon të theksojë se konkluzioni i mësipërm nuk mund të sjellë ndikim në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, pra thjesht si numër seancash, pasi numri i seancave të shtyra për shkak të angazhimeve të tjera është shumë i vogël krahasuar me numrin total të seancave joproductive në çështjen objekt kontrolli. Por edhe nga 5 dosjet gjyqësore të shortuara, vetëm për këtë çështje është konstatuar nga KLGJ-ja se kohëzgjatja e gjykimit kishte kaluar afatin 9-mujor të përcaktuar në aneksin e parë të sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve.

Ndryshimet në konkluzionet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe konstatimeve të raportit analitik duket që kanë ardhur për shkak të mos administrimit të plotë të dosjes, që e përmenda edhe më herët, në kuadër të përgatitjes së raportit analitik si raport ndihmës për analizimin e aftësive profesionale të gjyqtarit në procesin e rivlerësimit kalimtar. Ndryshe nga sa konstatohet në raportin analitik që ka përgatitur KLGJ-ja më parë, nga këqyrja e plotë e akteve të dosjes nr.1 (e cila është këqyruar përsëri edhe nga ana ime sepse është marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe nga Kolegji) është konstatuar se veprimet procedurale që në fakt gjyqtari kishte kryer, për njoftimin e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, ishin dokumentuar dhe ishin pasqyruar në fashikullin përkatës, gjithsej 59 fletëthirrje dhe njoftime për të pandehurit, avokatët, dëshmitarët, ekspertët dhe prokurorin. Gjithashtu, rezultonte se kishte pasur komunikim të gjyqtarit me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, për zbatimin e rreth 15 urdhrave të gjyqtarit për njoftimin e të pandehurave, dëshmitarëve apo ekspertëve, për njoftimin e të cilëve megjithëse ishte lëshuar fletëthirrje, ata nuk ishin paraqitur në gjykim.

Në rastet e mungesave të paarsyeshme të të pandehurave apo mbrojtësve, rezulton se gjyqtari ka proceduar me vijimin e gjykimit në mungesë apo me caktimin e mbrojtësve kryesisht. Këto veprime evidentohen në seancat gjyqësore të datës (datat përkatëse janë) si dhe për shkak të mungesës së paarsyeshme të së pandehurës, është caktuar mbrojtës kryesisht, të cilët janë paraqitur me iniciale në projektraport.

Nga situata faktike e mësipërme e gjendjes së akteve në dosjen nr.1, duke i

ballafaquar ato dhe me përmbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, evidentohet lehtësisht se konstatimi i raportit analitik të vlerësimit lidhur me aktet e njoftimit, ka ardhur si pasojë e mungesës së këtyre akteve në dosjen e verifikuar, pasi ajo nuk është administruar e plotë fillimisht. Gjendja e plotë e akteve të njoftimit në dosjen e plotë të përcjellë nga gjyqtari në Komision, provon faktin se ai ka ndërmarrë në fakt të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në drejtim të njoftimit të palëve, për organizimin e procesit gjyqësor. Ishte e vetmja çështje që është evidentuar edhe gjatë procesit të rivlerësimit që është rianalizuar nga ana ime si relatore dhe që e vlerësova të nevojshme për ta ricituar.

Pastaj dosjet e tjera janë analizuar dhe numri i seancave është vërtet shumë i ulët dhe gjithashtu ka një numër minimal të seancave joproductive, asnjëherë për shkaqe të gjyqtarit.

Lidhur me këtë tregues nëse do të përjashtonim dosjen nr. 1 ku numri i seancave ka qenë 47 dhe riti i gjykimit ka qenë gjykim i zakonshëm, çështje e cila ka zgjatur në kohë për shkaqe procedurale të analizuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të tilla që nuk varen nga gjyqtari, analizuara më sipër në raport, rezulton se për 10 dosjet e tjera gjyqësore të analizuara (penale themeli me palë kundërshtare), numri i seancave gjyqësore të zhvilluara, varion nga 1 deri në 6 seanca. Numri mesatar i seancave, duke iu referuar këtyre 10 çështjeve, rezulton të jetë 3.5 seanca.

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar dispozitat përkatëse në ligjin procedural, përveçse kur distanca nga njëra seancë tek tjetra, në rastet kur për shkak të pushimeve vjetore në muajin gusht apo të festave të fund vitit dhe mbartjes së dosjeve, mund të jenë lënë edhe përtej afatit 15-ditor.

Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët, nuk konstatohet mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast rezulton që të jenë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Lidhur me konstatimin e bërë në raportin për analizimin e aftësive profesionale të

administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, se gjyqtari nuk ka mbikëqyrur rregullisht aktet e njoftimit, duke sjellë shtyrjen e seancave dhe në dosje nuk ka akte njoftimi, Kolegji pasi ka analizuar aktet në dosjen e plotë të çështjes, duke i ballafaquar ato dhe me përmbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, ka vlerësuar se gjendja e akteve të njoftimit në fakt është e plotë dhe provohet se subjekti ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të njoftimit të palëve dhe riorganizimit të procesit gjyqësor.

Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtari në çdo kohë ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 (në fakt ky numër tejkalohet vetëm me 0.5% nëse përjashtojmë dosjen nr.1), shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë. Dhe ky propozim bazohet nga analiza e secilës nga dosjet të cilat përbëjnë burim vlerësimi dhe janë pjesë e dosjes së vlerësimit.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, nga analiza e të gjitha dosjeve të vlerësimit, duke iu referuar edhe vendimeve të Komisionit të Pavarur dhe Kolegjit të Posaçëm, rezulton që gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor, duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallave të gjykimit. Megjithatë konstatohen disa seanca të filluara me vonesë, por pavarësisht fillimit të tyre me vonesë ato janë në një përqindje shumë të vogël rreth 7.3% e seancave të filluara me vonesë dhe nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja lidhur me produktivitetin e gjykimit të çështjes.

Për sa i përket një pretendimi ose një arsyetimi, një argumentimi tjetër të ngritur në raportin analitik lidhur me sistemin audio, në fakt edhe gjatë procesit të rivlerësimit

kjo çështje është hetuar në hollësi dhe është konkluduar që nuk ka qenë për faj të gjyqtarit por për faj të momentit se kur sistemi audio është implementuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për shkak të mungesës së sallave, për t'i krijuar mundësi të gjithë gjyqtarëve për të zhvilluar gjykimet e tyre audio.

Për sa i përket rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes dhe saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes, nuk ka të dhëna që mund të afektojnë negativisht në pikëzim. Është propozuar pikëzim maksimal.

Përfundimisht për kriterin e dytë të “Aftësive organizative të gjyqtarit” është propozuar niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket të gjithë treguesve të kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, është propozuar vlerësimi maksimal. Gjetjet e ONM-së jo më kot i citova në fillim, të tilla që pasi janë analizuar edhe organi kompetent ILD-ja, KPA, por edhe nga unë si relatores, janë të tilla që nuk afektojnë etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit apo integritetin e tij. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi maksimal. Nuk ka pasur të dhëna lidhur me përdorimin e gjuhës diskriminuese. Ka pasur një kërkesë për përjashtim të gjyqtarit e cila nuk rezulton që të jetë pranuar. Në këto kushte nuk ka pasur të dhëna lidhur me treguesit e kriterit të tretë. Ndërkohë edhe për sa i përket raportit të Inspektorit të Lartë të Deklarimit të Pasurive por edhe vlerësimeve të Kolegjit lidhur me pasurinë e gjyqtarit, ato janë konsideruar të tilla të cilat nuk përbëjnë shkak dhe nuk mund të interferojnë në vlerësimin e treguesve të kriterit të tretë lidhur me integritetin e gjyqtarit.

Për sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, ka vlerësim maksimal për komunikimin e qartë dhe transparent, jo vetëm me kolegët por edhe me pjesën e administratës; për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale; aftësinë për të bashkëpunuar.

Për sa i përket “Gatishmërisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, janë marrë parasysh të dhënat lidhur me trajnimet e gjyqtarit, jo vetëm si pjesëmarrës por edhe si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës. Janë marrë parasysh gjithashtu edhe trajnimet e zhvilluara dhe pjesëmarrjet së tij në tryeza të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës qoftë për shkak të pjesëmarrjes së tij si ish-anëtar i Këshillit të Lartë

Gjyqësor por edhe për shkak se ka qenë kryetar i Unionit të Gjyqtarëve dhe për këtë arsye është propozuar pikëzimi maksimal me 20 pikë.

Për sa i përket angazhimit të gjyqtarit në veprimtari trajnuese, kanë qenë kryesisht për tema të së drejtës penale dhe procedurale penale, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 48 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 – 120 ditë në të gjithë periudhën 3-vjeçare.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnime” kanë rezultuar të dhëna lidhur me angazhimin e tij si ekspert në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, konkretisht ka marrë pjesë në 6 aktivitete trajnuese brenda programit të formimit vazhdues të kësaj Shkolle dhe është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket angazhimit të gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë, është marrë parasysh kontributi i gjyqtarit dhënë në mbledhjet e zhvilluara të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me diskutimin e akteve nënligjore të miratuara me efekte për të gjithë karrierën e gjyqtarëve apo për sistemin gjyqësor brenda kompetencave që ka pasur Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Është marrë parasysh fakti që zoti {...} është zgjedhur kryetar i Bordit Drejtues të Shoqatës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë dhe në kuadër të pjesëmarrjes së saj dhe si kryetar i shoqatës ka marrë pjesë në shumë konferenca gjyqësore ndërkombëtare si pjesëmarrës por edhe si referues dhe për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 5 pikë, duke e vlerësuar të gjithë këtë kontribut si angazhim në veprimtari ndërinstitucionale të gjyqtarit.

Lidhur me kriterin e fundit “Publikimet ligjore akademike” nuk ka pasur të dhëna gjatë procesit të gradimit. Në momentin që gjyqtarit i është njoftuar projektraporti i vlerësimit dhe kemi qenë në pritje të kundërshtimeve, të provave të reja, nga ana e gjyqtarit nuk është paraqitur asnjë provë e re për të analizuar në drejtim të këtij treguesi. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 0 pikë dhe përfundimisht për kriterin e katërt është propozuar niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 95.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është "Shkëlqyeshëm", pikët 395, konkretisht: 100 “Aftësitë profesionale”, 100 “Aftësitë organizative”, 100 “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe 95 “Aftësitë personale dhe angazhimi

profesional”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Fjala për zotën {...} për të bërë parashtrimet e veta.

{...}: Faleminderit!

Dëshiroj edhe një herë të falenderoj jo vetëm relatorën por të gjithë ju për mënyrën e vlerësimit me shumë rigorozitet dhe kujdes, edhe gjej rastin këtu që të shpreh dhe atë diferencën midis këtij Këshilli dhe vlerësimit që më është bërë nga përfaqësuesi i mëparshëm, relatori që ka bërë relacionin për vlerësimin tim në KPA, e cila ka theksuar në vendimin e vet që ka qenë një mangësi në mbledhjen e dokumentacionit, që në optikën time nuk është i tillë. Për mua vlerësimi që është bërë i parë është në kufijtë e veprës penale, ai vlerësim që është dërguar në KPA për mua. Megjithatë unë sot ndihem vërtet i vlerësuar që është parë në mënyrë mjaft korrekte veprimtaria ime gjatë 2013-2016. Normalisht nuk kam pse e fsheh kënaqësinë që ndjej duke dëgjuar për të tillë vlerësim.

I vetmi shkak që unë kam ardhur sot përpara jush, ka të bëjë me publikimet akademike. Do të dëshiroja nga ju të merrnit në konsideratë një publikim që është bërë nga një ish-studenti im (sot është gjyqtar në gjykatën e apelit z. Sokol Pina), ka botuar temën e vet në një revistë, revista “Magjistrati”. Është një botim i vitit 2014, një botim i një reviste mundësuar nga Fondacioni GIZ, në këtë botim unë jam udhëheqës shkencor, si gjithë ata që kanë kaluar nëpërmjet procesit të vlerësimit në Shkollën e Magjistraturës e dimë që kjo është një temë e cila zhvillohet nën udhëheqjen e një mentori, e një gjyqtari apo një profesori apo e një punonjësi të së drejtës, me një eksperiencë të kënaqshme në punë. Tema vërtet shkruhet nga studenti i magjistraturës, por nuk mundet që kjo temë të zhvillohet pa udhëheqjen shkencore të mentorit.

Unë do të dëshiroja që ky kontribut i imi modest të vlerësohej nga ana juaj si një punim akademik shkencor.

Gjithashtu doja të sillja në vëmendjen tuaj edhe disa materiale ligjore të përgatitura nga ana ime në cilësinë e anëtarit të unionit apo edhe kryetarit të Unionit të Gjyqtarëve, të cilat janë paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese (kanë qenë disa padi).

Shumica e tyre kanë dalë fituese në Gjykatë Kushtetuese. Unë mendoj se këto janë disa materiale që kanë të bëjnë edhe me fushën akademike, me përmirësimin e legjislacionit. Madje këto kanë shërbyer edhe si shkak për ndryshimin e legjislacionit, sidomos sa i përket ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”.

Këto kisha për të thënë.

Dëshiroja këtu të thosha faleminderit edhe për punën që keni bërë dhe t’ju uroj suksese në punën tuaj.

Materiali është revista “Magjistrati 4”. Botimi është në faqen 264 më duket, zoti Sokol Pina. E keni tek përmbledhja.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Së bashku edhe me depozitimin që keni bërë materialit në lidhje me botimin referuar nga ana juaj, ftoj anëtarët nëse kanë diskutime apo pyetje.

Meqenëse nuk kanë diskutime dhe pyetje, zoti {...} mund të largohesh për të vazhduar Këshilli me procedurat e vlerësimit tuaj.

{...}: Ju faleminderit!

Duhet të pres apo të largohem?

Ilir Rusi: Mund të largoheni. Bëhet publike vendimi.

{...}: Ju faleminderit!

Uroj pasdite të qetë.

Ilir Rusi: Gjithë të mirat!

(Largohet zoti {...} nga salla e mbledhjes.)

Ilir Rusi: Atëherë vazhdojmë me procedurën e vlerësimit.

Zonja Ukperaj keni diçka për të thënë duke marrë në konsideratë se çfarë

parashtroi zoti {...}?

Brikena Ukperaj: Paraprakisht, duke qenë se sot në seancë paraqitet në seancë revista shkencore “Magjistrati 7”, botimi i “German Corporation”, është Shkolla e Magjistraturës (janë disa botues), duke qenë se është një provë e re, këtë do ta administrojmë në dosjen e vlerësimit të gjyqtarit. Unë mendoj që kjo provë e re nuk afekton propozimin tim lidhur me “Publikimet ligjore akademike” për arse sepse nuk është publikim i gjyqtarit. Ka qenë udhëheqës shkencor në kuadër të diplomave të cilët përgatisnin kandidatët në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, ata që kryenin stazhin profesional.

Nga ana tjetër, kontributi i gjyqtarit lidhur me paditë e ngritura në Gjykatën Kushtetuese, megjithëse nuk solli asnjë provë në fakt është marrë parasysh në veprimtaritë ndërinstitucionale dhe nuk përbën publikim ligjor akademik.

Në veprimtari ndërinstitucionale patjetër, sepse e gjithë veprimtaria që ka ai ka kryer si kryetar i unionit është marrë parasysh dhe është pikëzuar me 5 pikë në veprimtaritë ndërinstitucionale. Por kjo nuk përbën publikim ligjor akademik. Në vlerësimin tim është një shkrim akademik i bërë nga kandidati për gjyqtar zoti Sokol Pina në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe është botuar në revistën që është pjesë e Shkollës së Magjistraturës. E ka ajo të drejtën e autorit në fakt.

Klodian Kurushi: Vetëm për një sqarim.

Ilir Rusi: Po zoti Kurushi, fjala për ju!

Klodian Kurushi: Duke parë shpjegimet që dha zoti {...}, si dhe botimin përkatës, na rezulton që ai është udhëheqës shkencor, apo jo, në udhëheqjen e temës të përfaqësuar nga atëherë kandidati për magjistrat zoti Sokol Pina. Kjo lloj veprimtarie që është e pamohueshme është kontribut besoj i marrë në rastin e udhëheqjes së magjistratëve, apo jo.

Brikena Ukperaj: Edhe nëse do t'i shtohet si evidentim kontributi, nuk ndryshon pikëzim.

Klodian Kurushi: Më fal, jo formalizim, por thjesht është një element që shkon dhe vlerësohet tek pjesa e udhëheqjes, apo jo.

Brikena Ukperaj: Patjetër, është një element që vlerësohet tek “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për magjistratë dhe në trajnimin e gjyqtarëve”.

Klodian Kurushi: Këtë doja të thosha. Kjo mund të merret si vlerë për atë tregues.

Brikena Ukperaj: Mund t'i shtohet kontributit të gjyqtarit për sa i përket atij kriteri, por jo për sa i përket “Publikimit ligjor akademik”.

Përfundimisht nuk kam ndryshim në propozimet e mia për çka është parashikuar në projektraport.

Ilir Rusi: Ka diskutime apo propozime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime dhe propozime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës. Në total, patjetër.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EËMI).*
6. *Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
7. *Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
9. *{...}, gjyqtare.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

Ilir Rusi: Atëherë, vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Rupa. Gjithashtu zonja Pogaçe është prezent për të ndjekur këtë proces vlerësimi dhe për të shprehur kundërshtimet e veta.

(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtarja znj. Pogaçe.)

Atëherë, sikurse e theksova, zonja Pogaçe si magjistrate ka shprehur kundërshtime dhe dëshirën për t'u dëgjuar dhe për të qenë pjesë e kësaj seance dhe është prezent në mbledhje.

Për më tej, për procedurë, fjalën e ka relatorja zonja Rupa, dhe pastaj fjala për ju.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

E nderuar zonja Pogaçe!

Në cilësinë e relatores do të paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional i cili ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, gradimin e gjyqtares, e cila ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Në projektraportin e vlerësimit paraqitet në mënyrë të plotë ecuria procedurale lidhur me këtë proces vlerësues. Gjithashtu edhe në mënyrë të detajuar pasqyrohen të gjitha burimet e vlerësimit.

Sipas parashikimeve ligjore në kuadër të respektimit të parimit për një proces të rregullt ligjor gjatë procedurës së vlerësimit gjyqtarja është njohur me rezultatet e vlerësimit, me të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar (ankuar) mbi aktin e vlerësimit.

Gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime lidhur me vlerësimin për sa i përket disa treguesve, përkatësisht në lidhje me tre tregues që janë rendimenti në punë, disponueshmëria për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë ose trajnimin e gjyqtarëve dhe lidhur me komponentin publikime ligjore dhe akademike.

Kundërshtimet e paraqitura nga gjyqtarja i janë dërguar për dijeni të gjithë anëtarëve të Këshillit në momentin e dërgimit të tyre pranë relatores.

Fillimisht, duke qenë se kundërshtimet e paraqitura nga gjyqtarja referojnë pikë së pari në paqartësitë dhe mosdakordësi lidhur me periudhën e vlerësimit e cila do të merret në konsideratë për efekt të gradimit të gjyqtares, vlerësoj të ndalem në analizën ligjore dhe standardin e mbajtur nga Këshilli lidhur me këtë çështje, në kushtet kur periudha 01.10.2013 – tetor 2016 përmban kohën e stazhit profesional të kryer nga magjistratja, periudhën e pritjes për t'u caktuar në pozicion si dhe periudhën e ushtrimit të aktivitetit

efektiv të funksionit.

Rezulton se për gjyqtaren Pogaçe periudha 2013–2016 përmban të tria këto situata, por ndryshe nga gjyqtarët e tjerë për të cilët procedura e vlerësimit etik dhe profesional ka përfunduar pa një vendim përfundimtar për arsye të mospasjes së një viti të plotë në funksion, për gjyqtaren Pogaçe rezulton pasja e një viti të plotë dhe duke u mbështetur në burime konkrete vlerësimi që i përkasin kësaj periudhe ka vazhduar dhe ka përfunduar sigurisht procesi i vlerësimit.

Bazuar në nenin 171, paragrafi 5 i ligjit “Për statusin”, pas vlerësimit të “Aftësive profesionale” të kryera nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit, KPK-ja ose Kolegji i Apelit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo element të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë nivelin e vlerësimit përkatës, pra gradimin e gjyqtarit”.

Në nenin 84, pika 1 dhe 2 e ligjit “Për statusin” është parashikuar: Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet përgjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet pas pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.

Në vendimin e Këshillit nr.263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5 parashikohet: Për çdo gjyqtar që përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pika 1 dhe 2 të ligjit “Për statusin”. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datë 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit. Gjatë periudhës së vlerësimit 3 ose 5-vjeçar, Këshilli vlerëson gjyqtarin varësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se 1 vit.

Referuar këtyre përcaktimeve ligjore, vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarit, pra gradimi i tij, ka si kusht thelbësor pasjen e përvojës profesionale që do të thotë që

gjqytari vlerësohet vetëm për periudhën që është i caktuar në detyrë dhe ushtron në mënyrë efektive funksionin.

Dispozitat e mësipërme e detyrojnë Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarit sipas ligjit “Për statusin” vetëm nëse në zbatim të ligjit ky vlerësim është i mundur dhe për sa i përket vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Këshilli vlerëson gjyqtarët pavarësisht nga koha e ushtrimit të detyrës e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se 1 vit.

Për gjyqtaren, rezulton të ketë ushtruar veprimtari profesionale 1 vit e cila përkon me vitin e fundit të periudhës që është caktuar ligjërisht si periudhë vlerësimi për efekt të rivlerësimit kalimtar dhe gradimit, pra është periudha tetor 2013 - tetor 2016.

Në raport është pasqyruar në terma ligjorë kjo periudhë, për të kuptuar që vlerësimi etik dhe profesional për gjyqtaren ka si qëllim gradimin e saj, pra për caktimin e nivelit të vlerësimit që ligjërisht është kompetencë e Këshillit.

Gradimi është përcaktuar si periudhë konkrete tetor 2015 – tetor 2016, që përbën 1 vit të plotë në detyrë për gjyqtaren.

Të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit i referohen vetëm kësaj periudhe dhe mbështetur mbi këto të dhëna, burime vlerësimi, është përcaktuar edhe niveli i pikëzimit dhe i vlerësimit.

Në kuadër të këtij procesi nuk mund të konsiderohet si burim vlerësimi asnjë akt që i referohet periudhës gjatë së cilës gjyqtarja ka kryer stazhin profesional, pasi këto akte janë vlerësuar nga shkolla për të përcaktuar renditjen e gjyqtares dhe po ashtu asnjë akt tjetër i cili i referohet periudhës gjatë së cilës gjyqtarja ka qenë në periudhë pritje për t’u caktuar në pozicion.

Për efekt të vlerësimit etik dhe profesional konsiderohen ato akte që përbëjnë burime vlerësimi sipas ligjit në kuadër të procesit vlerësues dhe që i përkasin periudhës kur gjyqtari ushtron detyrën efektivisht.

Lidhur me standardin që ka mbajtur Këshilli për periudhën e stazhit profesional, dihet tashmë qëndrimi, që periudha e stazhit profesional nuk mund të konsiderohet për efekt të vlerësimit etik dhe profesional pasi kjo periudhë ka qenë periudhë vlerësimi nga Shkolla e Magjistraturës.

Kështu që në këto kushte unë do të ndalem në analizën e burimeve të vlerësimit

dhe evidentimin e nivelit të pikëzimit të vlerësimit për secilin nga katër kriteret vlerësuese duke u bazuar vetëm në periudhën e vlerësimit tetor 2015 – tetor 2016.

Në lidhje me "Aftësitë profesionale të gjyqtarës".

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/ve konkrete procedurale dhe materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, kështu që në lidhje me këtë komponent propozoj që niveli i vlerësimit të jetë shumë i lartë dhe pikëzimi 25 pikë.

1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këto kushte propozoj që në lidhje me treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes" gjyqtarja të vlerësohet në nivelin e vlerësimit shumë të lartë, mbi 25 pikë.

Lidhur me "Arsyetimin ligjor", 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, lidhur me këtë tregues, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit gjyqtarja paraqet aftësi shumë të mira lidhur me qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 15 pikë.

Për sa i takon 1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit gjyqësor, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij. Për këto arsye, lidhur me këtë tregues, propozoj nivelin e vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Për të kaluar tek 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik, referuar

vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë i arsyetimit, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Për këto arsye edhe në lidhje me këtë tregues, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Kështu që në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, të cilat vlerësohen në 2 aspekte, në aspektin e aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të kryer procedura gjyqësore.

Lidhur me “Aftësitë për të përballuar ngarkesën në punë”, 2.A.a Respektimi i afateve ligjore, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja, vendimit të administruar me indicie nga KPK.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, 1 (një) vendimi të administruar për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes, dhe çështja ka përfunduar brenda këtij afati ligjor. Duke qenë në të tilla kushte, prezumohet që gjyqtarja ka aftësi shumë të larta lidhur me respektimin e afatëve ligjore kështu që propozohet në lidhje me këtë tregues, të vlerësohet në nivelin 0-10%, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për të kaluar tek 2.A.b Plotësimi të standardeve minimale kohore, duke arsyetuar si në rastin e respektimit të afateve ligjore, referuar metodologjisë së pikëzimit, për të gjitha çështjet që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara, kështu që propozohet niveli i

pikëzimit 15 pikë.

Për sa i takon 2.A.c Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, rezulton se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë prandaj propozoj nivelin maksimal të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve, është një tregues tjetër për të cilin gjyqtarja ka parashtruar kundërshtime. Si burim vlerësimi për këtë tregues kanë shërbye të dhënat statistikore për periudhën tetor 2015 – tetor 2016 (kuptohet që janë të integruar në projektraportin e vlerësimit edhe burimet e tjera të cilat janë vlerësuar në kuadrin e procesit të rivlerësimit). Kështu që, mbështetur në analizën e të dhënave që kanë rezultuar duke marrë në konsideratë periudhën e vlerësimit tetor 2015 – tetor 2016 rezulton që gjyqtarës për këtë periudhë i janë caktuar 409 çështje dhe ka përfunduar 394 çështje.

Rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara pra 394 çështje me çështjet e caktuara që janë 409 çështje dhe në vlera matematikore ky raport rezulton të jetë në masën 96.3 %. Ndërkohë brenda një viti ka gjykuar 111 çështje penale themeli dhe kundravajtje duke tejkuluar standardin sasior me vetëm 11 çështje referuar Aneksit 1 pika 3 germa “a” në të cilin një gjyqtar i shkallës së parë dhomës penale si relator brenda një viti kalendarik duhet të realizojë jo më pak se 100 gjykime çështjes penale (pra është tejkuluar standardi vetëm 11 çështje).

Siç thashë gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime lidhur me rendimentin, me të cilat ju jeni njohur dhe vlerësoj që përderisa gjyqtarja është prezente, të mos lexoj kundërshtimet. Por duke argumentuar vetëm për periudhën e vlerësimit kam vlerësuar se në kushtet kur nuk evidentohet asnjë rrethanë që përcaktohet nga metodologjia dhe që mund të çojë në rritje të nivelit të pikëzimit, gjyqtarja të vlerësohet me 8 pikë sipas përqindjes 96.3. Gjyqtarja ka gjykuar vetëm 111 çështje me palë kundërshtare duke tejkuluar rendimentin vetëm me 11 çështje çka nuk justifikon pikëzimin maksimal për kriterin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve” duke qenë se kemi një përcaktim ligjor dhe kusht pengues për të ngritur një gjyqtar në nivelin maksimal lidhur me rendimentin nëse ai nuk ka tejkuluar 50% të standardit minimal të çështjeve të gjykuara me palë kundërshtare.

Lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore propozoj nivelin e

pikëzimit me 8 pikë.

Për të kaluar tek 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin për të gjitha kategoritë e çështjeve. Kështu që lidhur me këtë tregues gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedura gjyqësore” vlerësohet pikë së pari në 2.B.a. Numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive, ka rezultuar që gjyqtarja në lidhje me këtë tregues të ketë sigurisht një performancë të lartë. Rezulton të ketë realizuar me përpikëri të gjitha veprimet procedurale dhe shmangien e atyre joproduktive. Numri i seancave rezulton të jetë 4.2 seanca, por duke pasur në konsideratë kryerjen me përpikëri të veprimeve procedurale është vlerësuar që gjyqtarja të pikëzohet në nivelin maksimal lidhur me këtë tregues. Kështu që propozimi për pikëzimin e këtij treguesi është 15 pikë.

Në lidhje me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, referuar metodologjisë së pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Në 10 seancat e filluara me vonesë, referuar relatimit të gjyqtarës, duket se kanë ndikuar kushtet e punës e infrastruktura e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me një numër të vogël salla gjykimi ku proceset regjistrohen në sistemin audio, si dhe vonesat e shkaktuara nga institucionet për shoqërimin e të pandehurve nën masë sigurimi “Arrest në burg”. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Kështu që në këto kushte, edhe lidhur me këtë nënkriter propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 20.

Për të kaluar tek “Aftësitë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, ky tregues vlerësohet si në bazën e rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes çka

rezulton në rastin konkret që gjyqtarja ka tregues shumë të lartë lidhur me këtë aspekt, kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë, pasi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Gjithashtu edhe në aspektin e saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie, nuk konstatohen mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Propozohet edhe lidhur me këtë nënkriter niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikëzimi 10.

Kështu në mënyrë të përmbledhur, propozimi për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtares” propozohet të jetë niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, ku për të gjitha komponentët e këtij kriteri, gjyqtarja është vlerësuar në nivelin maksimal.

Në lidhje me etikën në punë rezulton që gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë e dhënë që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë angazhimi dhe përgjegjshmërie në funksion, kështu që propozoj vlerësimin e saj me 35 pikë.

Për sa i takon integritetit të gjyqtares, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, rezulton se ka një shkallë shumë të lartë të integritetit, bazuar kjo në aktet që na janë vënë në dispozicion në këtë proces vlerësimi si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Propozohet niveli i vlerësimit me 40 pikë.

Sa i takon paanësisë së gjyqtares, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, nuk rezulton në asnjë nga aktet burim vlerësimi që gjyqtarja të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, kështu që në lidhje me këtë nënkriter propozohet niveli i pikëzimit 10.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar është një numër i pakonsiderueshëm kështu që lidhur me këtë tregues gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin e 15 pikëve.

Në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit të kriterit “Etika dhe angazhimi

ndaj vlerave profesionale” niveli i vlerësimit propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, “Aftësia e komunikimit”, gjyqtarja paraqet komunikim të qartë dhe transparent, kështu që referuar të gjitha të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit propozohet nivel shumë i lartë, pikët 25.

Respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale në të gjitha ato rastet kur vihet në dijeni lidhur me to për shkak të funksionit, kështu që edhe në lidhje me këtë komponent propozohet niveli i vlerësimit 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” shfaqet në një nivel shumë të mirë si për sa i përket shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë edhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me to, po ashtu edhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Kështu që për të dyja këto komponentë vlerësohet në nivelin e 15 dhe 10 pikëve.

Për të kaluar tek “Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, pjesëmarrja e saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale. Lidhur me këtë tregues janë paraqitur në projektraport të gjitha ato elementë të cilat janë vlerësuar dhe përbëjnë burim vlerësimi dhe që janë vlerësuar edhe nga organet e rivlerësimit, pra që i përkasin periudhës 2013-2016, por në pikëzimin e këtij komponenti gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin maksimal prej 20 pikësh, pasi rezulton të ketë edhe 3-4 trajnime që i përkasin periudhës së vlerësimit të marrë në konsideratë nga ne si vlerësues për periudhën 2015–2016. Kështu që, duke qenë se sipas ligjit të kohës nuk përcaktohej, pra përcaktohej vetëm një nivel numri maksimal i ditëve të trajnimeve që duhet të realizonte gjyqtari, është vlerësuar pra duke u mbështetur në këto trajnime me 20 pikë, lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon “Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, pjesëmarrja e saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, penale, procedurale, ndërkombëtare dhe familjare. Kështu që lidhur me këtë komponent

propozohet niveli i vlerësimit të saj me 20 pikë.

“Disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve”, nuk rezulton të ketë dhënë kontribute të tilla kështu që si për të gjithë gjyqtarët e tjerë, lidhur me këtë tregues do të vlerësohet me 3 pikë.

Lidhur me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari në marrëdhëniet me publikun dhe me gjykatat, rezulton që gjyqtarja të ketë kontribute të tilla. Kështu që propozimi për nivelin e pikëzimit është në kuotën e 5 pikëve.

Për sa i përket nëntreguesit të fundit “Publikimet ligjore akademike”, referuar burimeve të vlerësimit si dhe formularit të vetëvlerësimit të gjyqtarës nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, kështu që është vlerësuar me 0 pikë.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues ka paraqitur kundërshtime dhe duke qenë se të dy botimet që janë paraqitur nga gjyqtarja nuk i përkasin periudhës 2015-2016, nuk janë marrë në konsideratë për efekt të vlerësimit, aq më tepër që gjyqtarja në këto publikime nuk paraqitet si autore ose bashkautore, por thjesht në rolin e redaktueses dhe recensës së punimit shkencor. Kështu që bazuar në përcaktimet e metodologjisë së pikëzimit dhe vlerësimit mendoj dhe propozoj që niveli i pikëzimit lidhur me këtë tregues të mbetet në kuotën e 0 pikëve.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” propozoj të jetë "Shkëlqyeshëm" niveli i vlerësimit, pikët 93.

Në mënyrë të përmbledhur, për të katër kriteret e vlerësimit dhe propozohet ky nivel vlerësimi dhe pikëzimi:

“Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";
“Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 98, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";
“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm",
“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 93, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm”. Pra në lidhje me gjyqtaren Pogaçe propozoj nivelin e vlerësimit të përgjithshëm "Shkëlqyeshëm", pikët 391.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Fjala për ju zonja Pogaçe për të shprehur kundërshtimet tuaja në mënyrë sintetike.

{...}: Atëherë, ju falenderoj për vlerësimin lidhur me kriteret që keni realizuar.

Në thelb i qëndroj pretendimeve që kam paraqitur me shkrim. Dua të evidentoj vetëm disa çështje që të paktën më rezultuan nga relatimi i zonjës Rupa, për të mos u ndalur specifikisht në të gjitha çështjet që unë kam trajtuar me shkrim, duke qenë se jam informuar që kundërshtimet u janë vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve, sipas procedurës që parashikohet në ligj.

Në fakt unë do ta nisja me komponentin kryesor që është përbërja e periudhës së vlerësimit. U referua ligji “Për statusin e gjyqtarëve” dhe fakti që duhet të ketë të paktën një vit të plotë, në mënyrë që të konsiderohet periudhë vlerësimi, pasi për shumë kandidatë të tjerë, pikërisht se nuk ka qenë vit i plotë, nuk është bërë i mundur një vlerësim përfundimtar.

Në vlerësimin tim, këto dispozita ligjore presupozojnë që në qoftë se kandidati ka një vit të plotë pune gjatë periudhës tetor 2013 – tetor 2016 që përcaktohet si periudhë gradimi, do të thotë që do të procedohet me vlerësimin por jo se për efekt vlerësimi duhet marrë vetëm periudha e plotë. Për sa kohë që periudha e vlerësimit është tetor 2013 – tetor 2015 atëherë unë vlerësoj që nuk mund të më hiqen dy vitet e tjera të përfshira në këtë periudhë dhe realisht kontributi që unë kam dhënë gjatë këtyre viteve. Pasi edhe pse formalisht parashtrohet që është një periudhë 3-vjeçare vlerësimi sikurse e kërkon rregullorja dhe ligji, “de facto” më kufizohet vetëm në një vit periudhë vlerësimi, që është në kundërshtim me ligjin, pasi nuk mund të jetë vetëm një vit periudhë vlerësimi, dhe pse periudha formalisht është 3 vite.

Për sa i përket çështjes së parë unë kam parashtruar disa pretendime lidhur me “rendimentin në punë”. U parashtrua që të gjitha këto elementë janë marrë në konsideratë në projektraportin e vlerësimit, por ndërkohë disa të dhëna unë kam mundur t’i siguroj vetëm pasi kam parë projektraportin e vlerësimit dhe nuk kanë qenë në dispozicion të

Këshillit në momentin që është realizuar vlerësimi i rendimentit. Konkretisht ju kam vënë në dispozicion urdhrat e caktimit të shortit ku sipas rregullores, kryetarit të gjykatës i lindte e drejta që të bënte balancimin e shortit dhe unë jam futur me 100 % ngarkesë në short, ndërkohë që gjyqtarët e tjerë janë ulur në ngarkesën e tyre në short dhe praktikisht për periudhën tetor 2015 – dhjetor 2015 unë kam marrë 122 çështje penale, pra vetëm për një periudhë 2-mujore unë kam marrë atë lloj ngarkese që sipas rregullores përcaktohet si një ngarkesë normale përgjatë gjithë vitit, duke u futur në short efektivash në muajin nëntor (në fillim të nëntorit), duke llogaritur festat, duke llogaritur edhe kohën efektive, e kam pasur të pamundur që një periudhë 2-mujore unë të përfundoj 122 çështje. Që do të thotë, në vitin 2016 unë e kam filluar punën me një ngarkesë të shtuar dhe kjo jo për fajin tim por për shkak të organizimit të gjykatës dhe për shkak të periudhës në të cilën unë jam emëruar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë arsye kam referuar edhe vetë vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 lidhur me metodologjinë e pikëzimit, pasi në këtyre dispozitë përcaktohet shprehimisht që të dhënat statistikore analizohen rast pas rasti duke marrë parasysh edhe rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo shkaqe të tjera. Unë kam vazhduar të jem 100% në short si gjyqtare e re që kishte ardhur në detyrë, ndërkohë që gjyqtarët e tjerë, po të shikoni raportet që unë kam vënë në dispozicion, kanë qenë me 75, me 50% ngarkesë për të balancuar këtë lloj ngarkese.

Duke qenë si vit i plotë pune, është marrë deri në tetor 2016, pra jo një vit kalendarik siç e përcakton rregullorja dhe kjo normalisht për shkak të periudhës së gradimit, unë ju kam vënë në dispozicion edhe statistikat e kësaj periudhe, duke bërë që në fakt deri në dhjetor të vitit 2016 (që është viti kalendarik), unë kam arritur të përfundojë të gjitha çështjet që më janë caktuar dhe në përlllogaritje, për të qenë korrekt edhe me Këshillin dhe për të mos dhënë të dhëna që nuk lidheshin me vlerësimin, ju kam vënë vetëm ato çështje të përfunduara që më ishin shortuar gjatë periudhës së vlerësimit, pra nuk kam dhënë edhe çështje të tjera sa kam përfunduar unë në total. Kështu që të gjithë këto elementë që unë i kam parashtruar, vlerësoj që duhet të merren parasysh tek rendimenti, pasi edhe urdhrat për caktimin e shortit dhe ngarkesa aktuale dhe statistikat nuk kanë qenë të dhëna të disponueshme në momentin që është realizuar rendimenti.

Për sa i përket përcaktimit se kanë qenë vetëm 111 çështje me palë kundërshtare, dhe për këtë arsye kjo nuk duhet të shërbejë për pikëzim maksimal, parashtrij që çështjet caktohen me short dhe nuk janë në përzgjedhjen e gjyqtarit. Nga 409 çështje unë kam arritur të përfundoj 394 çështje duke marrë në konsideratë edhe këtë volum të shtuar që unë kam pasur në vitin 2016, pra 120 çështje vetëm për dy muaj sepse jam futur me ngarkesë të plotë. Kështu që, fakti që janë përfunduar vetëm 111 çështje me palë kundërshtare, nuk është një element që mund të më ndikojë negativisht në vlerësimin tim, pasi nuk ka qenë në përzgjedhjen time se sa çështje me palë kundërshtare do të kisha apo do të përfundoja. Këto kanë qenë çështje të caktuara me short nga gjykata. Kjo ka qenë për sa i përket rendimentit.

Po mundohem që të eci pak shpejt dhe t'i bie shkurt.

Lidhur me “Disponueshmërinë për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë apo trajnimin e gjyqtarëve”. Në fakt lidhur me këtë pikë unë do doja që Këshilli i Lartë Gjyqësor të mbante të njëjtin standard sikurse ka mbajtur në vlerësimin e gjyqtarëve të tjerë për sa i përket të paktën periudhës së pritjes në detyrë sepse në praktikën që unë kam parë, të KLGJ-së, mësimdhënia gjatë periudhës kur gjyqtari ka qenë në pritje të emërimit në detyrë është marrë në konsideratë dhe është vlerësuar pikërisht me arsyetimin që, mos emërimi direkt mbas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës nuk ka qenë një zgjedhje e vetë gjyqtarit ka ardhur për shumë arsye objektive të asaj situatë, kështu që nuk duhet të ndikojë negativisht. Në vetë projektraportin e vlerësimit, në faqen 80, unë e kam cituar, është përmendur që sipas vërtetimeve që kam depozituar nga “Albanian University”, unë kam dhënë mësim deri në dhjetor të vitit 2014. Stazhi profesional, nëse i qëndrojmë argumentit që kam qenë në stazh, ka përfunduar në periudhën qershor-korrik 2014 dhe unë kam qenë në pritje të emërimit. Kështu që kjo periudhë nuk është marrë në konsideratë me këtë arsyetim dhe vlerësoj që duhet të merret në konsideratë të paktën për të ruajtur këtë standard të njëjtë që ka mbajtur Këshilli i Lartë Gjyqësor edhe në vlerësimin praktikisht të kolegëve të mi që kemi qenë në të njëjtën klasë të magjistraturës dhe që janë vlerësuar lidhur me këtë kriter.

Për sa i përket periudhës së stazhit që është elementi i tretë që unë kam kundërshtuar, sikurse unë e citova edhe më parë, periudha e vlerësimit për sa kohë që

është një periudhë 3-vjeçare dhe qenia apo jo një vit i plotë në detyrë shërben që e gjitha kjo periudhë 3-vjeçare të merret apo jo në konsideratë dhe jo të bazohet vetëm viti i ushtrimit të plotë në detyrë, vlerësoj që edhe kontributi që unë kam dhënë duhet të merret në konsideratë sepse praktikisht bën që periudha e vlerësimit të ndahet në dy nënperiudha, një periudhë unë konsiderohem stazhiere, pra jo gjyqtare, periudhën tjetër konsiderohem gjyqtare. Ndërkohë që, në vlerësimin tim, kjo nuk është një ndarje e drejtë dhe duhet të më penalizojë.

Për sa i përket vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës, në fakt, në projektraport vlerësimi nuk është thënë në mënyrë specifike që nuk merren në konsideratë sepse jam vlerësuar një herë nga shkolla, por jam njohur me praktikën e Këshillit që mban në disa raste të tjera këtë qëndrim dhe unë vlerësoj që këto kontribute që janë dhënë nga shkolla kanë pasur totalisht një qëllim tjetër. Sikurse u citua është për renditjen e kandidatëve. Për sa kohë që këto dy vlerësime nuk kanë të njëjtin qëllim, nuk mund të themi që për sa kohë janë vlerësuar nga shkolla, atëherë nuk mund të merret më në vlerësim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Unë në fakt doja t'ju vija në dispozicion sot një kthim përgjigje të Shkollës së Magjistraturës (sepse kam mundur ta siguroj vetëm sot, është e datës 14.11.2023, pasi deri në këtë moment unë nuk kam parë ndonjë akt që të provojë faktin se të paktën dy publikimet që unë kam realizuar, por kam marrë pjesë në vitin 2013 dhe 2014, të jem vlerësuar nga shkolla), konkretisht është kthim përgjigjja e Shkollës së Magjistraturës, ku i kam kërkuar informacion se si është realizuar vlerësimi im gjatë stazhit profesional, cilat kanë qenë rubrikat që janë marrë në konsideratë dhe pikëzimet përkatëse. I kam kërkuar informacion lidhur me tre aktivitetet që unë kam kërkuar të merren në konsideratë nga ana juaj, dhe konkretisht publikimi i Profesoreshë Doktoreshë {...} “Diskriminimi gjinor”, ku është cituar kontributi im në këtë botim; pjesëmarrja në cilësinë e redaktueses të publikimit “Manual mbi ligjin shqiptar për falimentin”, që është botuar në vitin 2013; dhe pjesëmarrja në cilësinë e lehtësueses në 2 trajnime, që kanë lidhje po me falimentin. Nga Shkolla e Magjistraturës më është kthyer përgjigje se këto aktivitete ne nuk kemi të dhëna në qoftë se janë marrë apo jo në konsideratë në vlerësimin e bërë nga ana juaj. Fakti që shkolla nuk ma konfirmon që këto aktivitete janë

marrë në konsideratë, vlerësoj që ne nuk mund të mbajmë qëndrimin që këto aktivitete janë vlerësuar një herë dhe nuk mund të vlerësohen më, pasi vetë shkolla nuk e konfirmon një fakt të tillë, që këto aktivitete janë marrë në konsideratë për efekt vlerësimi.

Për sa i përket diskutimit që kam qenë redaktuese në publikimin e librit mbi falimentin, vetëm doja t’ju sillja në vëmendje që qenia redaktuese në këtë libër, si libri i parë që është bërë për falimentin dhe që është vënë pastaj në dispozicion të gjithë gjyqtarëve dhe vazhdon të përdoret edhe sot, redaktuese nuk është thjesht në aspektin që unë kam rregulluar shkrimin gjuhësor, se s’më takonte fare ta bëja një punë të tillë, por redaktimi ka qenë një punë e mirëfilltë shkencore sepse libri ka qenë i gjithi në gjuhën angleze dhe për shkak të situatës aktuale që ndodhet edhe Izraeli, unë nuk kam mundur të kontaktoj me profesorin {...}, pasi kemi një sërë komunikimesh ku është dokumentuar puna ime dhe në përshtatjen e të gjithë librit që ka qenë në gjuhë të huaj, përshtatje në terminologjinë dhe rregullimin e tij sipas ligjit “Për falimentin”. Pra është bërë një punë e mirëfilltë shkencore dhe jo thjesht redaktim libri nga ana gjuhësore apo gramatikore, por është punuar i gjithë libri për falimentin në shqip duke bërë të gjitha korrigjimet e nevojshme nga gjuha angleze që ishte përkthyer dhe duke e përshtatur në terminologjinë ligjore sipas ligjit të kohës. Kështu që do doja t’ju vija në dispozicion shkresën {...} prot., datë 14.11.2023 të Shkollës së Magjistraturës, Sektori i Formimit Fillestar lidhur së pari me pikëzimin tim në vitin e tretë (stazhi profesional), dhe së dyti, citon pikërisht këtë fakt që asnjë prej këtyre aktiviteteve nuk konfirmohet që ka qenë pjesë e vlerësimit tim në shkollë për efekt renditjeje.

Së fundmi, edhe në qoftë se mbahet qëndrimi që këto aktivitete që janë vlerësuar një herë nga shkolla, e vetmja rubrikë që ka shkolla është “Aktivitete profesionale dhe trajnuese”, nuk ka asnjë të dhënë specifike se çfarë është marrë në konsideratë dhe çfarë nuk është marrë në konsideratë nga shkolla. Dhe nga 5 pikë të mundshme është vënë 4 pikë.

E theksoj në këtë aspekt që ne kemi pasur dy publikime që gjithmonë merreshin në konsideratë: shkrimi i arsytimit ligjor dhe tema e diplomës, të cilat janë botuar në revistat juridike. Kështu që, të gjithë kandidatët kanë pasur pikëzim në këtë kriter dhe jo

për efekt të publikimeve jashtë Shkollës së Magjistraturës, por kanë qenë dy publikime të detyrueshme për t'u bërë në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës.

Edhe nëse vlerësojmë apo mbajmë qëndrimin që këto janë vlerësuar një herë nga shkolla, unë mendoj që nuk mund të kemi dy qëndrime të ndryshme, pra shkolla të më vlerësojë me 4 pikë, ndërkohë që vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor të thotë që për periudhën 2013-2016 ju të vlerësoheni me 0 pikë sepse nuk keni publikime. Minimalisht duhet të merrej për referencë vetë vlerësimi që ka bërë Shkolla e Magjistraturës për sa kohë që sipas Këshillit, me sa kuptova, thuhet që nuk mund të mbahet një qëndrim i ndryshëm, pra nuk mund të rivlerësohet dy herë e njëjta periudhë.

Në vlerësimin tim, vlerësimi dy herë i të njëjtës periudhë nuk do të thotë që të zërohet fare kontributi që unë kam dhënë sepse fokusohet vetëm tek viti 2015-2016, por do të thotë që për ato që është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, me të drejtë Këshilli nuk mund të dalë me një vlerësim të ndryshëm, por duhet ta marrë të mirëqenë sepse është i njëjti kriter i cili ka shërbyer për dy qëllime të ndryshme. Nuk është vlerësuar nga shkolla puna ime si gjyqtar, është vlerësuar për efekt renditjeje. Vërtetim në fjalë jua vë në dispozicion në origjinal dhe nga shkolla nuk konfirmohet dhe nuk është dhënë asnjë e dhënë që realisht këto kanë qenë pjesë të vlerësimit nga ana e shkollës dhe kanë shërbyer për pikëzimin tim në shkollë.

Për këto arsye unë i qëndroj kundërshtimeve të mia me shkrim dhe atyre që unë kam shpjeguar përpara jush sot, në mënyrë që të merren në vlerësim nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Pogaçe!

Ka pyetje nga ana e anëtarëve?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Përshëndetje Nurjeta!

Atëherë, disa sqarime për efekt edhe të pretendimeve/kundërshtimeve që ju keni bërë lidhur me projektraportin e vlerësimit.

Kur jeni emëruar gjyqtare? Dekretin e emërimit, jo të caktimit.

{...}: Dekreti në mos gaboj ka qenë data 21 tetor 2015.

Brikena Ukperaj: Pra jeni emëruar në 2015 gjyqtare?

{...}: Po! Në dijeninë time është 21 tetor.

Brikena Ukperaj: Në 2015 jeni emëruar.

Vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, stazhin profesional, në çfarë periudhe e keni kryer?

{...}: Në periudhën shtator 2013 – qershor – korrik...

Brikena Ukperaj: 2014. Pra në korrik të 2014 e keni mbaruar.

{...}: Në korrik është prezantuar tema.

Brikena Ukperaj: Atëherë, ajo periudhë është që ju keni mbaruar vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe dekretimin e keni marrë në 2015.

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: Caktimin kur e keni marrë? Në të njëjtën periudhë? Caktimin në gjykatë.

{...}: Në tetor 2015 kam qenë në gjykatë.

Brikena Ukperaj: Në të njëjtin vit.

Dua të flas, në kohën që ju keni qenë (nuk ka qenë në fuqi ligji “Për statusin”) dhe dekretimin e gjyqtarit ne e bëmim pas përfundimit të vitit të dytë të Shkollës së

Magjistraturës dhe pastaj viti i tretë ka qenë vit stazhi profesional.

Këtë të pyeta. Kur është emërimi. Emërimi si gjyqtar ndodh vetëm një herë. Ajo tjetra pastaj është caktim. Prandaj të pyeta kur ka ndodhur.

{...}: Në 2013.

Brikena Ukperaj: Pra në përfundim të vitit të dytë, në vitin 2013, ju keni marrë dekretimin si gjyqtare. Pastaj 2013-2014 keni zhvilluar stazhin profesional dhe në vitin 2015 (pra ka kaluar një periudhë e gjatë) dhe të themi nga fillimi i korrikut 2014 deri në tetor të vitit 2015 ju e kishit mbaruar shkollën, pra nuk ishit më subjekt i shkollës dhe ishit në pritje të caktimit, duke pasur statusin e gjyqtarit.

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: Tani, në këtë periudhë, nga korriku 2014 deri në 2015, që ka qenë kjo periudha e pritjes keni ushtruar mësimdhënie?

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: Pra ka vazhduar mësimdhënia gjatë kësaj periudhe.

{...}: Është cituar tek vetë projektraporti që ka vazhduar deri në dhjetor të vitit 2014.

Brikena Ukperaj: Mësimdhënia!

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: Dhe mësimdhënia është vlerësuar.

{...}: Jo nuk është marrë në konsideratë sepse..

Brikena Ukperaj: Është marrë tek veprimtaritë ndërinstitucionale, Nurjeta.

Shikoje tek veprimtaritë ndërinstitucionale bashkë me veprimtari të tjera që keni thënë juve.

{...}: Ndërkohë kam qenë edhe pjesë e reformës në drejtësi.

Brikena Ukperaj: Edhe ajo, e shtojnë kontributet. Gjithsesi ju aty keni marrë maksimalisht. Thjesht kjo që saktësuam ishte thjesht saktësim i një kontributi të shtuar për efekt të atij kriteri.

Tani, në këtë periudhë, dhe 2015-2016, keni marrë pjesë si eksperte ose si lehtësuese në Shkollën e Magjistraturës? Në këtë periudhë flasim.

{...}: 2015-2016?

Brikena Ukperaj: Jo 2015-2016, duke filluar nga 2014, kur e kishe mbaruar Shkollën e Magjistraturës, dhe në vijim.

{...}: Jo, ato që janë cituar tek kundërshtimet.

Brikena Ukperaj: Pra nuk ke qenë lehtësuese ose eksperte gjatë kësaj kohe në Shkollën e Magjistraturës.

{...}: Në magjistraturë jo. Kam qenë eksperte tek reforma në drejtësi

Brikena Ukperaj: Lehtësuese që the në trajnimet që bëheshin në ligjin për falimentin, kur ke qenë?

{...}: Në vitin 2013.

Brikena Ukperaj: Në vitin 2013, pra gjatë kohës që ti ishe në Shkollën e Magjistraturës, në stazh profesional. Për ta sqaruar këtë gjë. Dakord.

Lidhur me “Publikimin ligjor akademik”, a mendon ti se puna e redaktuesit është krijim?

{...}: Në këtë rastin konkret besoj se po. Sepse sikurse e shpjegova, nuk ka qenë një redaktim i thjeshtë. Domethënë libri ka qenë në gjuhën angleze, sepse ka qenë botimi i parë që është bërë në Shqipëri për pjesën e falimentit dhe ka qenë një fushatë e tërë e realizuar dhe trajnimet janë pikërisht në kuadër të falimentit. Unë në fakt tek kundërshtimet e kam cituar. Ne për shkak të veçorisë dhe për shkak të rrisë që kishte ligji, kemi bërë madje edhe një testim në Shkollë dhe nuk ishte rastësore përzgjedhja ime për të marrë pjesë si redaktuese e këtij libri. Ka qenë pikërisht profesori {...} që ka udhëhequr lëndën “E drejta e falimentit”. Është realizuar atëherë me provim. Unë kam marrë 100 pikë të plota në provim dhe për shkak të diferencave të theksuara që kishin kandidatët (sepse kandidati duhet të vinte me 80 pikë) dhe duke qenë se unë vija nga një “background” ekonomik, pasi kisha përfunduar 5 vite profesionale në shkollë profesionale ekonomike, është vlerësuar që provimi i falimentit të mos vendosej në kurikulën, domethënë të mos merrej në konsideratë por të shërbente pikërisht për zgjedhjen e këtyre gjyqtarëve që do të merreshin me redaktimin e librit.

Brikena Ukperaj: Dakord. Redaktimi çfarë nënkuptonte? Nënkuptonte një përkthim teknik, të gjuhës teknike? Një përkthim në gjuhën teknike?

{...}: Përkthimi ishte realizuar.

Kishte një lloj përkthimi.

Brikena Ukperaj: Përshtatje në gjuhën teknike.

{...}: Ndërkohë që është parë komplet i gjithë libri i përkthyer, materiali që

dispononte {...}. Është lexuar i gjithi. Janë nxjerrë një sërë gabimesh, sepse nuk kishte asnjë lloj përputhje...

Brikena Ukperaj: Kur është zhvilluar kjo?

{...}: Në vitin 2013 është publikuar. Domethënë është bërë prezantimi.

Brikena Ukperaj: Në 2013 është publikuar. Pra është realizuar gjatë shkollës, një angazhim i dy kandidatëve për gjyqtar të Shkollës së Magjistraturës.

{...}: Kemi qenë tre. Siç janë cituar tek libri.

Brikena Ukperaj: A mundnit për shembull që në këtë redaktim që keni bërë të jepnit idenë tuaj apo thjesht atë ide të dhënë në gjuhën angleze e keni përshtatur në terminologjinë juridike?

{...}: Jo. Domethënë, mund ta them me bindje të plotë këtë gjë, sepse sikurse e thashë, të gjithë komunikimin në atëherë e kemi bërë në rrugë elektronike, dhe takimet me Profesorin që duhet të lëvizje jashtë shtetit kanë qenë më të kufizuara. Pothuajse është riparë i gjithë libri nga e para, sepse ishte bërë një përkthim i zakonshëm anglisht-shqip, pa asnjë lloj termi ligjor. Nuk përputheshe përkthimi që ishte realizuar dhe nënet që ishin vënë nuk përputheshin fare me përmbajtjen e ligjit, pra merreshin komplet terma të tjerë. Kështu që është parë çdo fjalë e shkruar dhe e kemi parë me seksione.

Brikena Ukperaj: Në anglisht? Në anglisht dhe është përkthyer në shqip.

{...}: Ka pasur një përkthim të bërë bruto.

Brikena Ukperaj: Është përshtatur në shqip. Përkthim teknik. E kuptoj.

{...}: Ndërkohë mua më është dashur të shkoj tek burimi që ka qenë libri në anglisht sepse nuk arrija të kuptoja përkthimin në shqip se kujt i referohej.

Brikena Ukperaj: E kuptoj. E kuptoj. Që të kuptosh kontekstin e fjalisë.

{...}: Lexoja publikimin në anglisht e kryer; lexoja atë material bruto që ishte në shqip dhe që ishte bërë një lloj përkthimi; dhe nuk kishte asnjë lloj përputhje me ligjin.

A ka shkruar vetë projekti. Madje ju kam paraqitur edhe vërtetimin.

(Ka ndërhyrje nga anëtarët pa ndezur mikrofonin.)

{...}: Jo redaktore letrare.

Jo, nuk është quajtur redaktore letrare.

Në qoftë se unë do të isha redaktore letrare, unë vlerësoj që s'kishte arsye redaktuese. Kaq.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Redaktuese konsiderohesh. Është bërë botimi dhe është dokument zyrtar. Duhet të interpretojmë se ç'është redaktimi?

{...}: Jo, përderisa zonja po më pyet.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Redaktim në libër keni vendosur ju bashkë me autorin. Tani ne nuk interpretojmë ç'është redaktimi.

{...}: Ju nuk e interpretoni por unë po ju shpjegoj realisht ku ka konsistuar redaktimi.

Atëherë, unë vlerësoj që një gjyqtar në Shkollën e Magjistraturës nuk mund të jetë redaktor letrar. Nuk kisha arsye pse të merresha unë. Ka shtëpi redaktuese për këtë punë

që merren me redaktimin gjuhësor apo gramatikor. Dhe unë nuk mendoj që ka qenë e nevojshme dhe nuk përshtatej fare me natyrën time sepse kam qenë gjyqtare në atë periudhë.

Pavarësisht se kam qenë stazhiere. Unë nuk mund të kryeja asnjë lloj aktiviteti që nuk përputhej me natyrën time si gjyqtare. Kështu që unë nuk mund të bëja një veprimtari redaktuese letrare.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

{...}: Kam qenë gjatë stazhit profesional.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

{...}: Unë po jap shpjegime sa mu kërkua.

Në qoftë se ka nevojë për një vërtetim nga zoti {...}, unë thashë, për shkak të situatës që ndodhet, unë nuk kam mundur ta kontaktoj. Por në qoftë se është e nevojshme që të kem një lloj shpjegimi për kontributin se ku ka konsistuar, po jua them me plot bindje që s'mund të isha redaktore, në kuptimin klasik "letrare" apo "gramatikore", se s'mund ta bëja një detyrë të tillë, për sa kohë isha gjyqtare. Ai libër pastaj, unë kam qenë pjesë e prezantimit të tij në të gjitha seksionet trajnuese të gjyqtarëve nëpër gjykata sepse ka qenë një publikim i ri edhe sot e kësaj dite përdoret si komentari i ligjit "Për falimentin" dhe është përshtatur i gjithi. Është korrigjuar në thelb i gjithi sepse nuk kishte fare përputhje me dispozitat ligjore, me referencat ligjore. Ky ka qenë kontributi që unë kam dhënë.

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Nuk kam pyetje.

Ilir Rusi: Ka pyetje të tjera?

Keni diçka tjetër për të shtuar zonja Pogaçe?

{...}: Jo, ishin rreth atyre që shpjegova.

Ju vë në dispozicion edhe vërtetimin.

Ilir Rusi: E ke me vetë vërtetimin?

Depozitoje pranë relatores.

Atëherë, mund të vazhdoni, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me procesin e mëtejshëm në lidhje me vlerësimin tuaj.

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja znj. Pogaçe.)

Ilir Rusi: Atëherë, për më tej fjala për zonjën Rupa si relatores.

Yllka Rupa: Atëherë, unë mendoj që kam qenë shumë ezauruese gjatë relatimit lidhur me projektraportin e vlerësimit, kështu që unë nuk kam propozim lidhur me rritje të pikëve ose të nivelit për komponentët që janë vlerësuar nga gjyqtarja. Kështu që i përmbahem në mënyrë të plotë të gjitha propozimeve.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë kam një propozim lidhur me treguesin e “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”. Duke marrë parasysh kundërshtimet e gjyqtares, provat e paraqitura të cilat flasin për një rritje të papritur të numrit të çështjeve në një periudhë të caktuar, duke marrë parasysh edhe tërësinë e çështjeve që gjyqtarja ka gjykuar në trup gjykues, të cilat nuk evidentohen në fakt por që ekzistojnë sepse ka gjykuar në seksion penal, shumica e çështjeve janë gjykuar në ligjin e kohës me tre gjyqtarë, duke marrë parasysh edhe shifrën e rendimentit nga llogaritja matematikore, vlerësoj që në këtë rast është rasti që sipas metodologjisë të kemi një rritje në nivelin e pikëzimit të gjyqtares dhe shkalla e aftësisë së saj të vlerësohet shumë e lartë, jo me 8

pikë, por me 10 pikë.

Ndërsa, për sa i përket pretendimeve të gjyqtares lidhur me dy treguesit e tjerë të “Publikimeve ligjore akademike” dhe të përfshirjes në veprimtari që lidhen me trajnimin e gjyqtarëve, mendoj që kontributet e përmendura prej saj gjatë kohës që ajo ka qenë në Shkollën e Magjistraturës, ka qenë kandidate për gjyqtare, nuk përfshihen në periudhën e gradimit, ku vlerësohet puna por dhe njëkohësisht kontributi që gjyqtari jep gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në një pozicion të caktuar tej Shkollës së Magjistraturës. Këtë qëndrim e kemi mbajtur dhe nuk mund të merren në konsideratë. Ndërkohë që, edhe sikundër gjyqtarja e tha, periudha e mësimdhënies kur ajo ka qenë në pritje të caktimit në një pozicion të gjykatë, sigurisht që do t’i shtohet (është konsideruar) tek pjesa e kontributit lidhur me marrëdhëniet ndërinstitucionale. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime apo propozimet të tjera?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Edhe unë ndaj të njëjtin qëndrim me zonjën Ukperaj lidhur me shtimin e 2 pikëve tek rendimenti, duke qenë se edhe sikurse u analizua, ka qenë një standard që tashmë e ka mbajtur Këshilli, duke iu referuar të dhënave të ngjashme.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime të tjera?

Ka propozime të tjera?

Atëherë, zonja Shehu dhe zonja Ukperaj patën një propozim për seksionin “Aftësia organizative”, tek “Aftësia për të përbashkuar ngarkesën në punë”, pika ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” kemi një vlerësim nga 8 në 10 pikë, duke i shtuar 2 pikë dhe ishte një propozim i përbashkët i zonjës Ukperaj dhe znj. Shehu. Vazhdojmë me votimin përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin për rritjen me 2 pikë në treguesin e rendimentit.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet propozimi i zonjës Ukperaj dhe znj. Shehu.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim projektvendimin në total, duke marrë në konsideratë edhe ndryshimin e bërë për shkak të votimit të propozimit të fundit të bërë nga dy anëtarët përkatëse znj. Ukperaj dhe znj. Shehu e cila u miratua me shumicë votash.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit { ... }, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI).*
6. *Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
7. *Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me rendin e ditës me pikën 5 të saj, me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni nga relatorja zonja Rupa. Nga zoti {...} nuk janë paraqitur kundërshtime dhe nuk është prezent në këtë seancë.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Atëherë, edhe për zotin {...} është përgatitur projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional i cili ka për qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit lidhur me këtë gjyqtar.

Në kushtet kur projektraporti i vlerësimit ka të pasqyruar në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, burimet e vlerësimit, unë do të prezantoj në mënyrë të shkurtër analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe pikëzimit për gjithsecilin nga katër kriteret e vlerësimit. Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave”, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, analizën e tyre, si dhe në identifikimin e normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim. Propozohet niveli shumë i lartë, pikëzimi 25 pikë.

Lidhur me “Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtari ka shfaqur aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit kryesisht atij procedural penal dhe ligjit material penal dhe civil, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Propozohet niveli i pikëzimit me 25 pikë. Niveli i vlerësimit shumë i lartë.

Për sa i përket “Arsyetimit ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është vlerësuar edhe lidhur me këtë komponent që gjyqtari të vlerësohet në nivelin e 15 pikëve për arsye sepse ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Sa i takon “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit gjyqësor”, ka rezultuar që gjyqtari ndjek një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit pavarësisht se nuk identifikon ato me tituj apo me ndarje të dukshme në aspektin vizual duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, pjesë të arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë në disa raste, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Kështu që lidhur edhe me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë. Pikëzimi 10.

Për sa i takon “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, referuar edhe në këtë rast të dhënave rezulton se për këtë tregues shfaq cilësi shumë të mira, kështu që edhe lidhur me këtë komponent propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë. Pikëzimi 25.

Kështu që në lidhje me kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, “Respektimi i afateve ligjore”, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Nga vëzhgimi i këtyre çështjeve, vetëm për një prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e saj dhe rezulton që kjo çështje të ketë përfunduar brenda afatit ligjor kështu që prezumohet që lidhur me këtë tregues, gjyqtari të respektojë afatet ligjore në të gjitha rastet e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore. Propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Në lidhje me “Plotësimin e standardit minimal kohore”, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues rezulton se për 10 çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe 3 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish-KLD. Kështu që edhe lidhur me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë.

Për sa i takon “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, ka rezultuar që në tërësi koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor. Kështu që propozohet niveli i pikëzimit 5.

Për të kaluar tek “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues rezulton se referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe vërtetimit nr. {...} prot., datë 19.01.2017, të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtari {...} për të gjithë periudhën e vlerësimit 2013-2016, paraqet këtë ngarkesë çështjesh, të ndarë për çdo vit kalendarik:

-për vitin e plotë 2013 gjyqtarit i janë caktuar 520 çështje dhe ka përfunduar 268 çështje. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 51.5%.

-për vitin e plotë 2014 gjyqtarit i janë caktuar 589 çështje dhe ka përfunduar 365 çështje. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 62%.

-për vitin e plotë 2015 gjyqtarit i janë caktuar 418 çështje dhe ka përfunduar 308 çështje. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 73.7%.

-për vitin e plotë 2016 gjyqtarit i janë caktuar 450 çështje dhe ka përfunduar 311 çështje. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 69%.

Pra, për të gjithë periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtarit i janë caktuar në total 1977 çështje dhe ka përfunduar 1252 çështje. Sipas këtyre të dhënave rendimenti rezulton në masën 63.3%, çka pikëzohet me 2 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit lidhur me këtë tregues përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së paraqitur në aktin normativ, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”. Bazuar në këtë parashikim, dhe në faktin se në Aneksin 1 “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” nuk është parashikuar standardi orientues sasior i çështjeve të gjyqtarit të apelit i cili gjykon si në dhomë civile dhe në dhomë penale, në të dyja rastet nëse i referohemi dy pikave të parashikuara në rregullore pika “h” dhe pika “i”, gjyqtari subjekt vlerësimi del me një përqindje më të madhe se 50% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik.

Referuar pikës “h” dhe pikës “i” të aneksit: për vitin e plotë 2013 gjyqtarit ka përfunduar 268 çështje dhe 78.6% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik sipas pikës “h” ose 35% sipas pikës “i” të aneksit; për vitin e plotë 2014 gjyqtarit ka përfunduar 365 çështje dhe 143% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik sipas pikës “h” ose 82.5% sipas pikës “i” të aneksit; për vitin e plotë 2015 gjyqtari ka përfunduar 308 çështje ose 107.3% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik sipas pikës “h” ose 54% sipas pikës “i” të aneksit; për vitin e plotë 2016 gjyqtari ka përfunduar 311 çështje. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 105.3% sipas pikës “h” ose 55.5% sipas pikës “i” të aneksit.

Gjithashtu duke konsideruar ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtarit, angazhimin e tij në plotësimin e trupave gjykues në gjykatën e apelit ku gjykimet zhvillohen me trup gjykues me 3 gjyqtarë, si dhe faktin se nxjerrja e çështjeve civile për gjykim në periudhën e vlerësimit, ka qenë atribut i Kryetarit të gjykatës, vlerësoj se për këtë tregues niveli i pikëzimit që përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit duhet të rritet dhe pikëzohet me 10 pikë. Kështu që lidhur me këtë tregues, propozohet niveli i pikëzimit 10 pikë.

Për sa i takon “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, nga të dhënat e analizuara më sipër, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar nga tre kategori çështjesh, vetëm për një prej tyre rezulton e tejkaluar me vetëm 5 ditë në raport me afatin 30-ditor të rekursit, analizuar më sipër në këtë tregues. Gjithashtu, për këtë kategori, rezulton se vendimi është dhënë gjatë periudhës së muajit gusht (periudha në të cilën gjyqtarët marrin lejen vjetore), gjithashtu, ky tejkalim është i papërfillshëm dhe nuk ndikon në shkallën e aftësisë së gjyqtarit në drejtim të arsyetimit në kohë të vendimeve. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë lidhur me këtë komponent.

“Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedura gjyqësore” – nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtarë (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 4 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 10 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 1.6 seanca. Gjithashtu gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Propozohet niveli i pikëzimit prej 15 pikësh.

Në lidhje me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil në Gjykatën e Apelit, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi

20.

Në lidhje me “Aftësitë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore” lidhur me “Rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes” propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë, pasi dosja paraqitet e rregullt në aspektin formal, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Në lidhje me “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes” vërehet që në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata dhe gjithashtu konstatohet mungesa e vendimit të nxjerrjes së çështjes në seancë gjyqësore, por në çështjet civile, sipas legjislacionit procedural në fuqi, caktimi i seancave bëhet nga kryetari i gjykatës dhe nuk ka qenë detyrim i gjyqtarit relator. Ndërsa, në çështjet penale, referuar parashikimeve të K.Pr.Penale parashikohej si kompetencë të gjyqtarit kryesues urdhërimin për thirrjen e palëve, por nuk përcakton mënyrën e dokumentimit të këtij urdhërimi nëpërmjet një akti formal apo nëpërmjet njoftimeve. Mungesa e aktit formal në dosje, nuk ka sjellë pasoja në zhvillimin e gjykimit, pasi urdhërimi për thirrjen e palëve në seancën e parë gjyqësore, është dokumentuar dhe realizuar nëpërmjet akteve të njoftimit.

Gjithashtu është konstatuar se në një dosje, gjendet e administruar lista e gjykimeve të një gjyqtareje tjetër dhe mungon lista e gjykimeve për atë datë për gjyqtarin, çka do të thotë se nuk i përket çështjes konkrete. Pavarësisht se kemi të bëjmë me një rast i cili nuk ka ndikuar në veprimet procedurale të kryera në atë dosje, në funksion të njoftimit të palëve duke mos sjellë parregullsi në njoftimin e tyre, nga ana e gjyqtarit duhet të ishte treguar një kujdes i shtuar sa i përket këtij fakti. Kështu që lidhur me këtë tregues, propozohet niveli i vlerësimit me 8 pikë.

Lidhur me “Aftësitë organizative të gjyqtarit” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Lidhur me kriterin tjetër “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit e këtij kriteri, gjyqtari propozohet të jetë në nivelin e pikëzimit me 100 pikë, kështu që propozimi për këtë kriter është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, që është edhe

kriteri i fundit mbi bazën e të cilit vlerësohet gjyqtari. “Aftësia e komunikimit”, “Komunikimi i qartë dhe transparent” vërehet në të gjitha aktet që janë vlerësuar në kuadër të vlerësimit të këtij komponenti. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Gjithashtu rezulton që gjyqtari të respektojë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha ato raste kur vihet në dijeni për to për shkak të funksionit, kështu që propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 15.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, shfaqet në një nivel shumë të mirë si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët apo shkëmbimit të përvojës profesionale me to, sigurisht edhe në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, kështu që propozohet niveli i pikëzimit 15 dhe 10 pikë.

Në lidhje me “Gatishmërinë e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e tij në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, sigurisht është vlerësuar në kuadrin e 20 pikëve sepse rezulton të ketë të tilla.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesionale dhe trajnimin e gjyqtarëve” është vlerësuar me 3 pikë sepse nuk rezulton që të ketë angazhime gjatë periudhës së vlerësimit për gjyqtarin {...}. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit 3 pikë.

Gjithashtu angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, propozohet të vlerësohet në nivelin e 3 pikëve, pasi gjyqtari nuk ka paraqitur akte të cilat provojnë një angazhim të tillë.

Sigurisht edhe për “Publikimet ligjore akademike” nuk vlerësohet gjyqtari pra është vlerësimi 0 pikë, për arsye sepse nuk ka paraqitur akte të cilat provojnë që ky gjyqtar ka publikime ligjore apo akademike. Në këto kushte propozohet niveli i vlerësimit me 0 pikë lidhur me këtë komponent.

Për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” për gjyqtarin propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Lidhur me nivelin e vlerësimit për secilin nga kriteret e vlerësimit është si më

poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, pikët 100, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 98, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtarin {...} është niveli është "Shkëlqyeshëm", pikëzimit 389 pikë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po, zonja Plaku, fjala për ju.

Irena Plaku: Atëherë, unë kam një diskutim dhe një propozim në fakt, lidhet me kriterin e dytë "Aftësitë organizative të gjyqtarit", konkretisht tek rendimenti.

Referuar burimeve të vlerësimit, të cilat në fakt nuk është se janë sqaruar mirë në raportin analitik, konkretisht referuar statistikave rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka gjykuar 956 çështje. Analiza e tejkalimit të standardit minimal sasior në fakt është bërë mbi bazën e këtyre çështjeve. Referuar rregullores në fakt, rendimenti llogaritet, domethënë tejkalimi i standardit sasior llogaritet mbi çështjet të cilat janë me palë kundërshtare. Nga burimet e vlerësimit, konkretisht nga të dhënat statistikore mbi bazën e të cilës është bërë edhe raporti analitik i analizimit të aftësive të gjyqtarit, i cili është çuar më pas organeve të rivlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë periudhës së vlerësimit 965 çështje nga të cilat vetëm 612 çështje janë me palë kundërshtare. Çka do të thotë që tejkalimi i standardit sasior është vetëm me 12 çështje apo 2% dhe jo me 50% apo 100 e ca për qind siç është bërë këtu. Ne e kemi mbajtur këtë standard në vlerësimin e të gjithë gjyqtarëve të apelit kur kemi pasur të dhëna statistikore, megjithëse tek aneksi i vlerësimit të gjyqtarëve nuk është përcaktuar për dhomën civile apo penale,

nuk është bërë për dy dhomat e përbashkëta por është bërë për dhomën civile dhe penale më vete, që shkon 150 dhe 200, pasur parasysh për analogji ne kemi marrë standardet e vendosura për standardin sasior të gjykatave të shkallës së parë ku kemi përcaktuar 200 çështje dhe siç e theksova më sipër, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë periudhës trevjeçare 612 çështje duke tejkuluar vetëm me 2% standardin sasior.

Nga të dhënat shikoj që këtu është ngritur standardi nga niveli 2 pikë, në 10 pikë, duke kaluar 4 nivele, të cilën ne nuk e kemi mbajtur në asnjë vlerësim. Edhe vlerësimet e mëparshme në fakt ku thashë që ishte 2 nivele. Unë propozoj që jo të kemi një nivel me 10 pikë, për sa kohë që nuk ka asnjë të dhënë tjetër se kush ka shkuar në këtë nivel por duke qenë se ky është gjyqtar i apelit dhe gjykon në trup gjykues me dy gjyqtarë, propozoj rritjen e dy niveleve, por jo katër niveleve, duke shkuar në vlerësimin 6 pikë dhe jo në nivelin 10 pikë sepse nuk e ka tejkuluar asnjëherë standardin, përkundrazi vetëm me 2%. Nuk ka asnjë të dhënë tjetër siç e kemi marrë parasysh kur kemi rritur gjyqtarët e tjerë që kanë arritur në nivel maksimal, për shembull një që kam vlerësuar unë ka qenë angazhuar edhe në kolegjin zgjedhor dhe deleguar në gjykata të tjera, këtu nuk kemi asnjë të dhënë. Standardi nuk është tejkuluar në asnjë vit, përveç me 2%. Kështu që unë propozoj nga 2 pikë që i përkon pikëzimit, të dhënave statistikore, të shkojë në 6 pikë, por jo në 10 pikë siç është propozuar.

Faleminderit!

Yllka Rupa: Irena, ju i referoheni standardit për gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e apelit nuk ka standard të përcaktuar.

(Zonja Plaku flet pa ndezur mikrofonin.)

Me sa kujtoj, vetëm për gjyqtarët e gjykatës administrative të apelit sepse ne gjithmonë kemi llogaritur rendimentin duke u mbështetur në një mesatare (çështje civile dhe çështje penale) dhe rendimenti në projektraport është llogaritur në këtë logjikë. Pra mesatarja e çështjeve civile, mesatarja e çështjeve penale të gjykuara nga gjyqtari dhe ka dalë në një rendiment që është tejkalimi disa herë i standardit.

(Zonja Plaku flet pa ndezur mikrofonin.)

Yllka Rupa: Varet nga standardi që do mbajmë atëherë.

Ka rast që është mbajtur edhe ky standard.

Megjithatë e vlerëson Këshilli.

Ilir Rusi: Ka propozime të tjera?

Atëherë, zonja Plaku propozon që tek rubrika e “Aftësitë organizative”, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, në lidhje me pikën ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve”, zonja Plaku propozon që nga 10 pikë, të vlerësohet me 6 pikë, duke u ulur 4 pikë.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Pra propozimi i zonjës Plaku nuk miratohet.

Hedhim në votim vlerësimin total të tij. Nuk ka ndryshime nga propozimi i relatores sepse propozimi i zonjës Plaku nuk u miratuar. Kalohet në votimin total të këtij vlerësimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës { ... } për vitin 2021”, i përgatitur nga relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI).*
- 6. Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 9. {...}, gjyqtare.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2021”, i përgatitur nga relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2021”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Plaku. Ka kundërshtime nga gjyqtarja. Njëkohësisht ka shprehur dëshirën për të qenë pjesë e kësaj seance.

(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

Ilir Rusi: Mirë se erdhe zonja {...}!

Atëherë ju keni paraqitur kundërshtime, njëkohësisht edhe me prezencën tuaj dëshirën për të qenë pjesë e kësaj seance për vlerësimin tuaj.

Për më tej fjalën relatores znj. Plaku. Pas relativitet nga zonja Plaku, fjala do jetë për ju.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë do ju parashtrij pak a shumë në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit, duke qenë se jeni njohur si anëtarët, ashtu dhe gjyqtarja.

Gjithashtu, gjyqtarja pasi është njohur me projektraportin, ka paraqitur kundërshtimet, të cilët janë dërguar menjëherë të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Do përqendrohemi tek ato kritere për të cilat gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, por kundërshtimet do ia lë vetë fjalën gjyqtarës t'i parashtrijë.

Atëherë, procedura e vlerësimit të gjyqtarës {...} ka filluar me vendimin e nr.521, datë 06.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku jam caktuar unë si relatore dhe nëpunëse përgjegjëse znj. {...}.

Gjithashtu, është kryer gjithë procedura. Në pjesën e parë të projektraportit është përshkruar procedura e ndjekur deri në administrimin e burimeve të vlerësimit dhe hartimin e projektraportit analitik dhe projektraportit të vlerësimit, pasi janë vlerësuar plotësimi procedurës i dokumentacionit të dosjes.

Atëherë, vlerësimi është bërë në 4 (katër) kritere, konkretisht vazhdojmë te kriteri i parë “Aftësia profesionale e gjyqtarës”, “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm apo konfliktin e çështjes”. Rezulton se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit nga shkalla e parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, po ashtu çështjet kur gjykata e apelit i është dërguar çështja për kompetencë.

Referon gjithmonë ligjin e zbatueshëm që gjen zbatim në rastin konkret duke i bërë dhe interpretim të saj. Referon dispozitat e tjera që lidhen me çështjet, në rastet kur se kur ka pasur çështje të tilla, konkretisht ligjin “Për sigurimet shoqërore”, ligjin “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit”, ligjin “Për pensionet e anëtarëve të kooperativës bujqësore” dhe një VKM “Mbi statusin e kooperativave bujqësore”.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë

tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit i normave/ normave konkrete procedurale ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është vlerësuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” - nga burimet e vlerësimit, konkretisht në 8 vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionet e arritura nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionet e arritura në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjithashtu, konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin sistematik konkretisht nenet 34, 38 të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës...”.

Në lidhje me “Interpretimin e ligjit material”, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në projektraport janë analizuar dispozitat të cilat analizohen nga ana e gjyqtarit, interpretohen konkretisht nenin 155 Kodi i Familjes, duke cituar dhe atë për çfarë është interpretuar, konkretisht interesi i ligjshëm, ekzistenca e një dokumenti në lidhje me atë që paditësi pretendon një të drejtë, etj.

Për sa i përket, “Interpretimit të dispozitave procedural” - për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale dhe penale, gjyqtarja përgjithësisht i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës jo vetëm për sa i përket të zgjidhjes në themel të çështjes, por edhe zgjidhjes së situatave procedurale, në rastin kur ngrihen çështje të procedurës në gjykimin në apel, apo kur është vetë dispozita procedural është ajo që vjen

në ndihmë të zgjidhjes së çështjes. Në çështjet civile analizon nenin 32 të K. Pr. Civile:

- në çështjen me vendimin nr.195, datë 27.10.2021, të cilës gjykatës së apelit, një çështje e cila konstatuar problematike ndër të tjera dhe vetë gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime është çështja që i përket vendimit me nr.155 datë 27.10.2021, të gjykatës së apelit, është dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër për kompetencë, për shpalljen e mos kompetencës lëndore, e cila ka vlerësuar se gjykata e apelit ka kompetencën lëndore për gjykimin e saj si juridiksion fillestar, gjyqtarja ka analizuar dispozitat e ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës, duke referuar në mbështetje të argumentit të saj edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë.

- Vendimin njësuës nr.611, datë 07.02.2018, në përmbajtjen e vendimit por edhe e dosjes gjyqësore, duket se gjykata në këtë rast ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur në gjykim në apel (në seancë gjyqësore) nga njëra prej palëve pjesëmarrëse (Avokatura e Shtetit) për shpalljen e mos kompetencës lëndore), duke vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë, pasi ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk është kompetente për shqyrtimin e saj. Pra gjykata e apelit në këtë rast ka vendosur prishjen e një vendimi, që nuk i ka shkuar në bazë të ankimit, por në bazë të vendimit të shkallës së parë që ka vlerësuar se gjykata e apelit është kompetente për shqyrtimin e saj si juridiksion fillestar, në referim të ligjit nr.133/2015. Në vendim, gjyqtarja ka cituar nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile, që në fakt referon dhe rregullon rastet kur gjykata kryesisht ose me kërkesë të palëve konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjeve, vendos mos kompetencën e saj, por nuk ka bërë një interpretim të kësaj dispozite edhe në raport me dispozitat e tjera vijuese, konkretisht të nenit 62 dhe 64 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilat përcaktohet se gjykata të cilës i dërgohet çështja për kompetencë, e pranon atë për shqyrtim dhe se konflikti i kompetencës nuk lejohet por gjykata që i është dërguar çështja parashtron qëndrimin e saj në Gjykatën e Lartë. Në nenin 64 i Kodit të Procedurës Civile përcakton Gjykatën e Lartë si gjykatën kompetente që rregullon kompetencës midis gjykatave, në rast se gjykata që i dërgohet çështja për kompetencë vlerësohet se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, i parashtron qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë. Gjyqtarja në këtë rast ka vendosur prishjen e çështjes dhe kthimin e saj

për rigjykim në referim të nenit 464 germa “ç”, që referon tek neni 467, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitën mbi juridiksionin dhe kompetencën në gjykimin e çështjes, por pa bërë një interpretim të këtyre dy dispozitave. Neni 467 i Kodit të Procedurës Civile, germa “a” përcakton rastet kur gjykata e apelit disponon me prishjen e një vendimi të shkallës së parë dhe kthimin e saj për rigjykim, që i ka shkuar gjykatës së apelit në bazë të ankimit të palës, kur gjykata e shkallës së parë ka dhënë një vendim përfundimtar në shkelje të dispozitave mbi juridiksionin dhe kompetencën. Por edhe në këtë rast, kjo dispozitë duhet të interpretohet në raport me nenin 467/b të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se kur gjykata konstaton se vendimi është i drejtë dhe është dhënë brenda kompetencave të gjykatës që i takonte çështja, gjykata e apelit nuk e prish çështjen por mjaftohet me vënien në dukje gjykatës që ka dhënë vendimin për parregullsinë e vendimet e saj.

Në vendimet penale, gjyqtarja analizon dispozitat e ligjit për të cilat gjen zbatim konkretisht pjesët e përgjithshme dhe pjesët e posaçme të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar jurisprudencën dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante të Gjykatës së Lartë në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin posaçërisht në rastet që lidhen me:

- parimin e ndalimit të dënimit dy herë për të njëjtin fakt duke përmendur jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe çështjen konkrete;
- në kushtet e nevojshme për caktimin e masës së sigurimit pasuror dhe sekuestros preventive referon Gjykatën e Lartë, përkatësisht vendimin nr. 201, të vitit 2015 të Kolegjit Penal;
- në kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes, ka identifikuar vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, të vitit 2013, etj.

Gjithashtu, gjyqtarja citon dhe përdor/aplikon parimet e së drejtës, duke cituar konkretisht, parimin e interesit më të lartë të fëmijës; parimin e ligjshmërisë, duke identifikuar dhe vendimet përkatëse ku ka rezultuar një rrethanë e tillë.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja përgjithësisht ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit

procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në zgjidhjen e çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, por edhe të GJEDNJ-së, si dhe zbaton parimet e së drejtës. Por, nuk konstatohet e njëjta shkallë kujdesi i gjyqtarës në interpretimin e dispozitave procedurale që lidhen me përcaktimin e gjykatës kompetente që rregullon kompetencën midis gjykatave të ndryshme, si dhe disponimet e gjykatës në rastet kur çështja i është dërguar asaj nga një gjykatë tjetër, që ka vlerësuar se çështja e mosmarrëveshjes është në kompetencë lëndore të gjykatës së apelit si juridiksion fillestar. Pavarësisht, se bëhet fjalë për 1 (një) çështje nga 6 (gjashtë) të zgjedhura me short, ajo është një tregues i aftësisë së gjyqtarës në interpretimin e dispozitave procedurale që lidhen me kompetencën e çështjeve në të njëjtin lloj. Ndërkohë, rezulton se dispozitat e ligjit material janë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke e pasuruar interpretimin ligjor edhe me referimin të praktikës relevante të Gjykatës së Lartë apo GJEDNJ-së. Referuar sa më sipër, pasur parasysh atë vendimmarrje të cilën unë e kam relatuar pak më lart, vlerësoj se, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “mbi mesatare” duke e pikëzuar me 20 pikë.

“Arsyetimi ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” - pasur parasysh burimet e vlerësimit në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë leximi të organizuar dhe ofron kalimin nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra në mënyrë logjike, ku dalin qartë konkluzionet e gjykatës, të cilat vijnë si rrjedhë logjike e të gjithë arsyetimit në tërësi. Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

Edhe për sa i përket treguesit, “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, dhe në këtë rast gjyqtarja është vlerësuar në nivel maksimal. Konkretisht, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin e përmbajtjes, por jo atë vizual, por duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të

mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij, megjithëse jo gjithmonë e dallueshme më aspektin vizual. Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësisë e gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, gjithnjë i plotë i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedural. Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësoj se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta.

Cilësia e analizës dhe argumentit logjik, ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve që përbëjnë shkaqe ankimi apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Referuar sa më sipër, vlerësoj se për këtë tregues aftësia e gjyqtarës është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për kriterin e parë është 95 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit të dytë “Aftësia organizative e gjyqtarës”, konkretisht “Respektimi i afateve ligjore”, referuar burimeve të vlerësimit pas rianalizimit dhe një herë të të dhënave statistikore duke zbritur çështjet të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, rezulton se numri i çështjeve me afat ligjor është 149 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (18 çështje), duke i zbritur

dhe 5 të tjera pas analizimit, rezulton 13 çështje. Raporti i numrit të çështjeve me afat ligjor dhe ato të gjykuara tej afatit, janë 8.7 %, përqindje e cila sipas pikëzohet me 15 pikë. Për këtë arsye, për këtë kriter gjyqtarja është vlerësuar maksimale, pasi ka rezultuar se ka respektuar afatin ligjor të gjykimit të çështjeve.

Sa i përket “Standardit minimal në fuqi”, referuar burimeve të vlerësimit konkretisht raportit analitik, por dhe të dhënave statistikore që janë marrë dhe një herë në analizë, duke zbritur periudhën e lejes së zakonshme dhe të pushimeve vjetore apo mbartjes së dosjeve, konkretisht ka rezultuar se, numri i çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor janë 10 çështje, nga 320 çështje, rezulton të ketë gjykuar tej standardit 3.1%. Referuar sa më sipër, duke qenë se përqindja 3.1 %, pikëzohet me 5 pikë është propozuar pikëzimi i saj me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, ka rezultuar më e shkurtër për të gjitha kategoritë e çështjeve. Koha mesatare ka rezultuar më e shkurtër për të gjitha kategoritë konkretisht për 9 (nëntë) kategoritë e çështjeve dhe nënkategorinë për secilën çështje. Referuar sa më sipër, pasur parasysh që koha që i dedikohet çdo çështjeje, është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

“Rendimenti i përfundimit të çështjes” - referuar burimeve të vlerësimit rezulton se për periudhën, konkretisht për periudhën 1-vjeçare (01.01.2021-31.12.2021), si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara 469 çështje me numrin e çështjeve të caktuara 479, rezulton në rendimentin 98 %, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë.

Referuar metodologjisë së pikëzimit për aspektin sasior, sa i përket aspektit sasior, sipas pikës 3, germa “h” të vendimit të ish-KLD-së, që është organizuar në dhomë penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit jo më pak se 150 çështjesh penale (krime e kundërvajtje), i llogaritur në periudhën 3-vjeçare jo me pak se 450 çështje në periudhën 3-vjeçare, dhe në çështjet civile në jo më pak se 200 çështje civile llogaritur për një periudhë 3-vjeçare, 600 çështje. Aneksi 1 i Sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e gjykatës së apelit që nuk është organizuar në seksione. Në këto kushte, për analogji, edhe me standardet minimale të përcaktuara për

gjiqtarin e shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, duhet të merret në konsideratë standardi minimal prej 200 çështje në vit (penale dhe civile), themeli. Rezultoi se gjatë periudhës 1-vjeçare ka gjykuar 469 çështje, nga të cilat 301 çështje janë me palë kundërshtare, duke e tejkaluar standardin minimal, me 101 çështje apo me 50.5 %.

Referuar metodologjisë së pikëzimit që përcakton se në rastet e tejkalimit me 50 % të standardit sasior mund të shkojë deri në pikëzim maksimal, për gjyqtaren propozoj rritjen me një nivel duke arritur në nivelin maksimal prej 10 pikësh.

“Koha mesatare e arsytimit të vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve për kategori të veçanta është si më poshtë:

i. “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” më e gjatë se afati procedural prej 20 ditësh.

ii. “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” është 44 ditë më e gjatë.

iii. për “familjare me palë kundërshtare” është më e gjatë.

iv. për kategorinë e “marrëdhënieve të punës” është më e gjatë se afati procedural.

v. për “krime dhe kundravajtje” është më e gjatë se afati i parashikuar prej 30 ditë.

Pra, për të gjitha kategoritë e çështjeve rezulton se afati i arsytimit të vendimeve është më i gjatë se afati i përcaktuar në ligj apo që lidhet me të drejtën e ankimit. Pra, rezulton se afati është më i gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Referuar metodologjisë së pikëzimit koha mesatare është më e gjatë se afati procedural, i korrespondon pikëzimit me 3 pikë.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, numrin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%, çka do të thotë, rritje me një nivel vlerësimi.

Referuar të dhënave statistikore siç janë arsyetuar dhe në treguesi më parë rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit ka dhënë 469 vendime, vetëm si relatore, pa pasur parasysh angazhimin e saj si anëtare. Gjithashtu, rezulton se ka

tejkualuar standardin sasior, për këtë arsye është propozuar rritje me një nivel vlerësimi referuar dhe metodologjisë së pikëzimit, duke arritur në nivelin 6 pikë, duke kategorizuar me e gjatë se afati procedural në shumicën e kategorive të çështjeve.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore” - nga burimet e vlerësimit rezulton se numri i seancave është 2.4, numri mesatar i të dyja seancave, konkretisht në çështjet penale është 2, në çështje penale themeli është 5, në seanca paraprake është 2 dhe në civile me palë kundërshtarë është 1.6, mesatarja del 2.4.

Gjithashtu, ka rezultuar se gjyqtari ka kryer me efektivitet të gjitha veprimet procedurale me qëllim zhvillimin e gjykimit brenda afateve të arsyeshme. Bazuar në sa parashtrohet më sipër duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga bashkimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave është 2.4 seanca dhe në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në pikët maksimale, duke e vlerësuar me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga raporti analitik dhe burimet të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor dhe respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtën e palëve ndërgjyqëse. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen”, konkretisht “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”. Lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik brenda një kategorie. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” - nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen

të gjitha aktet e hartuara nga gjykata. Përgjithësisht, nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjeve konkrete. Referuar sa më sipër, për këtë tregues është vlerësuar aftësia e gjyqtares me 10 pikë, aftësia “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Atëherë propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e “Aftësive organizative” është si më poshtë: pikët 91, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Për të sqaruar, për këtë tregues është ulur vetëm për sa i përket kohës mesatare të arsyetimit të vendimeve, duke qenë se rregullorja parashikon rritjen me një nivel vlerësimi e cila i është rritur gjyqtares për shkak të ngarkesës përballuar nga ana e gjyqtares.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” - për këtë kriter duke pasur parasysh burimet të vlerësimit, ku janë marrë në konsideratë dhe të dhënat e dërguara nga ILD-ja, nuk rezultojnë të dhëna për gjyqtaren të cilat mund të afektojnë këtë kriter vlerësimi. Për këtë arsye, duke qenë se për këtë kriter gjyqtarja nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim, duke qenë se është vlerësuar maksimal, vlerësoj të mos ndalem pasi vlerësimi i saj i përgjithshëm është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Nuk ka rezultuar që të ketë pasur, konkretisht tek treguesi i fundit, “numri i lartë i kërkesave”, nuk rezulton që të ketë numër të lartë të kërkesave për përjashtim.

Gjithashtu ka bashkëpunim me kolegët, me administratën. Për këtë arsye, është vlerësuar me nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, “Komunikimi i qartë dhe transparent”, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka komunikim transparent, për këtë arsye është pikëzuar me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit”, referuar burimeve të vlerësimit, nuk ka të dhëna që mund të afektojnë për këtë tregues. Për këtë arsye, është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive ligjore”. Dhe për këtë tregues, është vlerësuar niveli i aftësisë “shumë i lartë”, niveli i vlerësimit me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën”, në tërësi

rezulton që shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit është shumë e lartë. Për këtë arsye, propozohet pikëzimi me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtarit për t’u aktivizuar në veprimtari të tjera”, konkretisht “Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës”. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës 01.01.2021 deri në 31.12.2021 nuk ka marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në formularin e vetëvlerësimit gjyqtarja është shprehur që nuk ka marrë pjesë, por ka relatuar për shkak të ngarkesës si dhe faktin se ka marrë pjesë si pedagoge e jashtme në dhënien “E së drejtës familjare” në 32 orë mësimi. Gjithashtu, ka ndikuar dhe volumi i realizuar në Gjykatën e Apelit Shkodër si dhe çështjet e caktuara si gjyqtare e deleguar në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit. Ndërkohë, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin”, është përcaktuar se periudha e formimit vazhdues duhet të jetë:

a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota në pesë vitet e fundit, duke qenë se gjyqtarja ka një eksperiencë pune rreth 23 vjeçare, çka do të thotë vlerësimi i saj i zakonshëm duhet të ishte 5 vjet ;

b) dhe jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve të fundit.”

Pra kjo dispozitë përcakton se në një vit kalendarik, gjyqtari duhet të marrë pjesë në trajnimin vazhdues në jo më pak se 5 ditë trajnimi dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Referuar metodologjisë së pikëzimit që përcakton në lidhje me pikëzimin e gjyqtarës për këtë tregues, ku është përcaktuar pikëzimi sipas tabelës për shembull: për periudhën 3-vjeçare (15-20) pikëzohet me 20 pikë dhe më pak se 15 apo 120 ditë, pikëzohet me 4 pikë. Duke qenë se, që për periudhën 1-vjeçare niveli i trajnimit duhet të jetë 5-40, rezulton se gjyqtari nuk ka asnjë trajnim, për këtë arsye referuar këtyre standardeve të përcaktuara në metodologjinë e pikëzimit është propozuar pikëzimi i saj me 4 pikë, për shkak se nuk rezultoi pjesëmarrja e saj në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnues në

cilësinë e ekspertës dhe lehtësueses. Gjithashtu, nuk ka të dhëna të angazhimit të saj si udhëheqës për kandidatët për gjyqtarë. Për këtë arsye, referuar metodologjisë së pikëzimit është propozuar pikëzimi i saj me 3 pikë duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna të cilat mund të ndikojnë në rritjen me dy pikë të tjera.

Sa i përket, “Pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në veprimtari të marrëdhënie me publikun”, nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nuk ka të dhëna. Por, nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, tek treguesi “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja është miratuar pedagogje e jashtme në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021, “E drejtë familjare” me vendimin e Këshillit Drejtues 33, të vitit 2020 dhe ka dhënë mësim në semestrin e dytë, gjithsej në 32 orë mësimi, të zhvilluara në periudhën mars deri maj të 2021. Gjyqtarja në formularin e vetëdeklarimit, ka deklaruar se: “Kur ka qenë e mundur jam angazhuar në veprimtari jashtë funksionit, si mësimdhënie në universitet privat si dhe në çdo vit akademik bashkëpunoj me Shkollën e Magjistraturës si pedagogje e jashtme por edhe për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues, përmes propozimit të temave.”

Referuar sa më sipër, duke qenë se rezultojnë të dhëna të veprimtarisë ndër institucionale të gjyqtarës, është propozuar pikëzimi me 5 pikë për shkak se ka të dhëna për këtë tregues.

Sa i përket treguesit “Publikime ligjore”, referuar burimeve të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna “publikime ligjore” nga ana e gjyqtarës, për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, është 77 pikë, niveli i vlerësimit “Shumë mirë”.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtarit, 95 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”;

Aftësia organizative të gjyqtarit, 91 pikë, “Shkëlqyeshëm”;

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”;

Aftësia personale dhe angazhimi profesional është 77 pikë, niveli i vlerësimit “Shumë mirë”.

Niveli i përgjithshëm i pikëzimit është 363 pikë, niveli i vlerësimit është “Shumë mirë”.

Faleminderit!

Nuk i parashtrova në fakt kundërshtimet tuaja, duke qenë se do t’i parashtroni vetë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, fjala për ju znj. {...} për të parashtruar kundërshtimet tuaja në mënyrë sintetike, duke marrë në konsideratë ato rubrika që ju kundërshtoni.

{...}: Faleminderit!

Në fakt edhe unë nuk kam gjë tjetër për të shtuar përveç atyre që kam thënë në ankim. Gjithsesi e gjej me vend qoftë t’i evidentoj me pika problematikat, por duke ju prezantuar faktin se është e vërtetë që ka një ligj edhe një sistem vlerësimi por ky sistem vlerësimi është miratuar dhe ka parasysh situata normale të punës. E gjej të domosdoshme t’ju prezantoj situatat në të cilat kemi punuar, kam punuar unë të paktën në Gjykatën e Apelit Shkodër, që nga periudha e shtatorit të vitit 2020 dhe për vitin 2021, pasi e gjithë ajo ngarkesë e 2020 është reflektuar në rendimentin e punës time, qoftë edhe në problematikat e arsytimit të vendimeve, nuk kam asgjë me të dhënat statistikore, janë ashtu siç i ka prezantuar projektraporti, thjesht është çështja si duhen vlerësuar ato.

Siç ju thashë, në shtator të vitit 2020, në Gjykatën e Apelit Shkodër, nga 10 gjyqtarë kemi mbetur vetëm 3 gjyqtarë, që do përballonim punën e programuar edhe nga 3 gjyqtarë të tjerë që u shkarkuan në periudhën fund korriku dhe gusht të 2020.

Menjëherë, sa u bëmë 4 gjyqtarë, isha angazhuar me procesin e vetting-ut. Të gjithë ne e kemi kaluar këtë proces. E dimë se sa i nevojshëm është angazhimi në të sepse në fund të fundit sa rendiment do kem tek gjyqet në qoftë se unë nuk do arrij t’u përgjigjem institucioneve të vetting-ut, për të prezantuar atë që unë realisht kisha në të vërtetë qoftë për kriterin e pasurisë apo të profesionalizmit. E njëjta situatë ka vazhduar

më tej edhe në vitin 2021. Volumi i punës ka qenë i jashtëzakonshëm. Pavarësisht të gjithë këtij volumi, siç e relatoi edhe zonja Plaku, vetëm 13 çështje janë të gjykuara tej afateve të parashikuara në ligj dhe çështje të kësaj natyre në gjykatat e apelit ka pa fund, qoftë ato administrative penale apo kundërshtimet e veprimeve përmbartimore, pavlefshmëri titulli që u shtuan shumë në periudhën e fundit, dhe janë respektuar maksimalisht nga ana ime. Madje po të hetohen edhe ato 13 çështje, e sigurt që janë të planifikuara brenda afatit 30-ditor apo 60-ditor, por kanë qenë shkaqe të ndryshme që kanë të bëjnë me kërkesa të palëve, që janë shtyrë seancat dhe nuk kanë përfunduar në 30 ditë apo 60 ditë.

I gjithë ky volum pune, normal që ka reflektuar edhe tek aftësia për të përfunduar vendimet, për t'i arsyetuar ato në afate të duhura kohore.

Përveç ngarkesës në Gjykatën e Apelit Shkodër, çdo javë kam qenë e deleguar ose në Gjykatën e Apelit Durrës ose në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Pra të udhëtosh çdo javë, një ditë pune ngelet joefektive për gjykatën. Ma besoni, ditët e punës të javës time kanë qenë minimumi gjashtë, për të mos thënë edhe shtatë, sepse e tillë ka qenë ngarkesa. Dhe pikërisht, kjo ngarkesë ka qenë që më ka ndikuar edhe tek pamundësia për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues gjatë vitit 2021.

Është e vërtetë që nuk kam marrë pjesë në trajnime, por ligji parashikon që gjyqtarët me mbi 15 vite vjetërsi në detyrë do vlerësohen një herë në 5 vite. Prandaj në kundërshtimet e mia, ju kam prezantuar pjesëmarrjen time në trajnime për periudhën 2017 dhe 2021 që është zero (është e vërtetë) dhe numri total i trajnimeve është të paktën 42, ku përfshihen trajnimet si eksperte por edhe si pjesëmarrëse, sepse bashkëpunoj me Shkollën e Magjistraturës që nga viti 2010. Kam qenë pjesëmarrëse rregullisht në trajnime që nga fillimi i detyrës si gjyqtare me mbarimin e Shkollës së Magjistraturës në vitin 2000 kur jam emëruar, por që nga viti 2010 bashkëpunoj ngushtësisht me Shkollën për trajnimet, aq sa më lejon edhe puna, sepse në fund të fundit parësore për gjyqtarin është ushtrimi i detyrës së gjyqtarit.

Do tërhiqja vëmendjen tuaj dhe në vendimmarrjen e po këtij Këshilli të datës 15 shkurt 2022 kur janë vlerësuar aftësitë e mia profesionale për periudhën 2013-2016 dhe

aty evidentohet qartazi pjesëmarrja ime në trajnime si eksperte por edhe si pjesëmarrëse.

Jua bëra me dije të gjitha këto elemente vetëm për faktin që nuk është Valbona ajo që nuk preferon të shkojë në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës. Problem ka qenë ngarkesa e madhe në punë dhe në fund të fundit detyrimi ligjor për të përmbushur të paktën 30 ditë në 5 vite, e kam përmbushur për periudhën 2017 - 2021. Është çështje vlerësimi pastaj.

Edhe një element tjetër. Jo vetëm pjesëmarrja si eksperte në trajnimet e shkollës, por prej vitesh jam edhe pedagoge e jashtme e Shkollës së Magjistraturës. Nuk është se jam angazhuar vetëm në vitin 2021, 2022, 2023 apo edhe më herët. Pra bashkëpunimi me shkollën ka qenë i vazhdueshëm edhe në procesin e mësimdhënies. Vlerësohet vetëm me 4 pikë. E tillë është rregullorja por me thënë të drejtën do desha që të kishte pak interpretim ky element. Mësimdhënia në Shkollën e Magjistraturës kurrësi nuk mund të barazohet me mësimdhënien në një universitet tjetër. Studentët e magjistraturës janë gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm, kanë mbaruar sistemin “Bachelor” dhe “Masterin”, dhe madje kanë edhe eksperiencë pune se nuk mund të fillojnë shkollën po të mos kenë eksperiencë pune, dhe niveli i mësimdhënies aty është shumë më i lartë dhe për mua duhet të barazohet të paktën një temë me një trajnim dyditor sepse në fund të fundit para se të jap mësim unë jam e detyruar të njoh praktikat si të gjykatave të ulëta, të Gjykatës së Lartë për temën që trajtoj, por edhe vendimet e GJEDNJ-së i bëj gjithmonë prezente në mësimdhënie. Kjo është sa i përket pjesës së trajnimeve.

Arsyetimi i vendimeve është ajo që tha zonja Plaku. Po, ka vonesa, por këto vonesa nuk kanë qenë fare të pranishme në vlerësimin e vitit 2013-2016 kur ne punonim në kushte normale. Mund t’i referoheni asaj vendimmarrjeje të Këshillit për të verifikuar këtë që ju prezantoj.

Sa i përket 5 pikëve lidhur me interpretimin e ligjit procedural, për mua është një çështje e diskutueshme. Gjithsesi për një vendimmarrje, nuk më duket normale që të zbriten pikët. Kam 23 vite gjyqtare dhe ndihem pak keq me thënë të drejtën kur lexoj që “nuk është në gjendje të interpretojë ligjin procedural”. Është një çështje që ne e kemi debatuar goxha, ne gjyqtarët e apeleve, nuk është vendimi i vetëm që është dhënë në atë mënyrë. E kam bindje që ashtu duhet bërë. 466/b nuk ka vend në rastin konkret sepse

gjkata e shkallës së parë, në mënyrë të gabuar, një çështje që për kompetencë e kishte ajo, ia përcjellë gjykatës së apelit pa kryer asnjë veprim procedural. Pra nuk kishim çfarë vendimi të drejtë të vlerësonim. S’na mbetej asnjë zgjidhje tjetër përveçse të prishnim vendimin dhe ashtu siç thoshte vendimi njësoes dhe ligji 133 i viti 2015. Kaq kam.

Më koncize se kaq nuk mund të isha.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Duke qenë se është bërë nga ana ime relacioni. Në fakt, unë ndaj të njëjtin mendim sa i përket vendimmarrjes tënde në lidhje me vendimin unifikues, që çështja duhet t’i shkojë për kompetencë gjykatës së shkallës së parë. Nuk ka lidhje me këtë. Ka lidhje me atë që si procedohet. Atë që si e vlerësoj unë. Është një vendim, ke të drejtë për këtë gjë, por siç e thatë edhe vetë, është një praktikë që ju e mbani. Nuk ka lidhje me atë që interpretohet ligji 133/2015 “Për trajtimin e pronës”. Sepse edhe unë të njëjtin mendim ndaj. Duhet t’i shkojë gjykatës së shkallës së parë. Por nuk ka lidhje me këtë. Thjesht për ta sqaruar këtu.

Ilir Rusi: Ka ndonjë pyetje apo diskutime nga anëtarët prezent?

Po!

Brikena Ukperaj: Nisur nga kjo e fundit, duke qenë se bëhet fjalë për interpretim të dispozitave procedurale, do doja të dija qëndrimin tuaj, në rastet kur gjykata e shkallës së parë ju përcjell për kompetencë funksionale lëndore një çështje dhe ju si gjyqtare apeli keni vlerësuar që në fakt është në gjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e prishni në të gjitha rastet vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ktheni çështjen për rigjykim në shkallë të parë? – se kjo është çështja në fakt. Domethënë këtu është diskutimi. Nuk flasim për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, por këtu bëhet fjalë për një konflikt kompetence midis gjykatave të niveleve të ndryshme. Cila është praktika juaj si gjyqtare? Folët sikur bëhet fjalë për një vendim. Më lindi pyetja nga qëndrimi që ju mbajtët, duke

thënë që “mendoj që duhet të jetë ashtu siç kam bërë unë”, do të thotë që ju në të gjitha çështjet mbani të njëjtin qëndrim?

{...}: Atëherë, thashë që është një vendim sepse një vendim është prezantuar dhe në atë vendim, në fakt po, atë qëndrim kam. Atë qëndrim kam. E kemi diskutuar. Konflikt kompetence ka mes gjykatave të të njëjtit nivel. Gjykata më e lartë nuk mund të diskutojë konflikt kompetence me gjykatën më të ulët. Ky është qëndrimi im personal. Mund ta kem të gabuar, por ky është qëndrimi im.

Nuk e di të kem raste të tjera. Nuk e di të kem. Edhe mbase sepse volumi i punës ka qenë i tillë sepse jo vetëm ato 469 vendimet që kam dhënë unë si relatore, por për vitin 2021 kam gjykuar 1588 çështje kur Gjykata e Apelit Shkodër në total ka më pak se 2000 çështje, pra kam gjykuar mbi $\frac{3}{4}$ e Gjykatës së Apelit Shkodër. Dhe këto gjykimet e tjera pastaj jashtë rrethi. Prandaj them që janë të gjithë këto elementet objektive që kanë ndikuar në këtë prezantim timin sot.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Ka dikush tjetër pyetje?

Ndonjë diskutim?

(Nuk ka pyetje apo diskutime.)

Keni për të shtuar ndonjë gjë?

{...}: Faleminderit, nuk kam!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ju mund të vazhdoni, se ne do vazhdojmë me procedurën e mëtejshme të vlerësimit. Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja {...}.)

Ilir Rusi: Po zonja Plaku, çfarë komenti keni?

Irena Plaku: Atëherë, kam një diskutim.

Atëherë, vlerësimi i përshpejtuar... nuk kemi pasur asnjë rast tjetër. Normalisht tek ligji përcaktohet që vlerësimi i zakonshëm është trevjeçar për gjyqtarët që kanë një periudhë deri në 15 vjet dhe mbi 15 vjet është periudha e vlerësimit e zakonshme, është 5 vjet. Për këtë periudhë vlerësimi, për çështjet e trajnimeve, duhet që gjyqtari (në mos gaboj) të ketë 30-120 trajnime në periudhën 5-vjeçare. Në fakt, po të marrësh periudhën 5-vjeçare, ajo e ka plotësuar këtë. Ka qenë, patjetër, domethënë rreth 40 janë vërtetë sepse ka qenë si lehtësuese, si eksperte dhe pjesëmarrëse gjatë gjithë kohës në trajnimin vazhdues, përveç 2021 që përkon me periudhën e vlerësimit të përshpejtuar. Ne nuk kemi pasur asnjëherë këtë rast sepse nuk na është ngritur asnjëherë për diskutim nga gjyqtarët. Kështu që ky është një diskutim i parë, në rast se do përfshihen në periudhën e vlerësimit atë që gjyqtarët për të cilën vlerësohet në fakt periudha e trajnimeve. Sepse po t'i referohemi ligjit, ligji thotë në rast të mospjesëmarrjes në trajnimet vazhduese, mund të shkojë edhe në masë disiplinore. Po ta shikosh këtë gjë, ajo gjatë periudhës 5-vjeçare i ka, i plotëson, edhe si lehtësuese, edhe si eksperte dhe pjesëmarrëse, çka tregon që ajo ka pasur gjithmonë angazhim për pjesëmarrjen në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve, si eksperte, si pjesëmarrëse. Nuk e ka neglizhuar. Ka të drejtë për këtë gjë. Nuk e ka neglizhuar asnjëherë. Vlerësimi, po të ishte i zakonshëm, do të ishte 5-vjeçar. Duke qenë se ne kemi aplikuar, domethënë në rast të mungesës së vlerësimit të zakonshëm, që në rast se do të ishte në ngritje në detyrë, ne do kishim një vlerësim të zakonshëm për gjyqtarët, ajo e plotësonte, por duke qenë se kemi një periudhë 1-vjeçare, unë i jam referuar vetëm burimeve të vlerësimit, prandaj është çështje për diskutim. Kështu që unë vlerësoj që duhet ta diskutojmë të gjithë këtë gjë.

Tabela ka mospërputhje, por jo tek vlerësimi. Është në rregull tek vlerësimi.

Marçela Shehu: Irena, në qoftë se gjyqtarja nuk do të kishte kandiduar për në Gjykatën e Lartë për ngritje në detyrë dhe ne nuk do ishim të detyruar që të bënim vlerësimin e përshpejtuar, mungesa e trajnimeve nuk do ta penalizonte në vlerësim gjyqtaren.

Irena Plaku: Po, do i merrte 20 pikë.

Jo, nuk do e penalizonte. Përkundrazi do merrte pikët maksimale dhe tek kriteri tjetër që është “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr gjyqtarët”, edhe tek një kriter tjetër. Domethënë ajo do t’i merrte të gjitha pikët.

(Anëtarët flasin mbi njëri – tjetrin.)

Irena Plaku: ...23 vjet gjyqtare i plotëson

Nuk e kemi pasur asnjëherë këtë diskutim.

Kjo është për interpretim thashë, është për diskutim. Unë thjesht e ngrita për diskutim. Hajde ta diskutojmë dhe ta vendosim.

Brikena Ukperaj: Vetëm ky është diskutimi, që vlerësimi i përshpejtuar këtu nuk vjen si zgjedhje e saj, këtu vjen si detyrim...

Yllka Rupa: Si zgjedhje e saj, përderisa ajo ka konkurruar në një procedurë.

Ilir Rusi: Po zonja Shehu!

Marçela Shehu: Çfarë pasoje i vjen në vlerësim gjyqtares (që ta kemi të regjistruar) nëse nuk i konsiderohen trajnimet për këtë vit vlerësimi në lidhje me vlerësimin e ardhshëm? Çfarë pasoje sjell ky vlerësim?

Irena Plaku: Atëherë, ky vlerësim është për këtë periudhë dhe pavarësisht se është i përshpejtuar përfshin periudhën... domethënë çka nënkupton që vlerësimi i saj bëhet për periudhë 5-vjeçare, nënkupton që nga viti 2017 deri në 2021, ajo vlerësohet vetëm për këtë vit dhe nuk do të ketë më vlerësim për këtë periudhë. Jo, nuk do ketë. Vlerësimi tjetër i radhës fillon 2021 – 2026 (5 vjet).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë nëse ka diskutime të tjera apo propozime.

Po, fjala për ju zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, unë do të kisha si fillim propozimin e parë në lidhje me “Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, marrë në konsideratë konkluzionet që ka arritur relatorja dhe ndaj një opinion të ndryshëm në lidhje me këtë, në lidhje me aspektin e konfliktit të kompetencave se si duhet të trajtohet. Natyrisht në dukje më rezulton sikur po konkurrojmë arsyetimin e gjykatës, ndërkohë që në opinionin tim ligji në këtë aspekt është i qartë. Është i qartë sepse nisem pikërisht nga paragrafi 467/a i procedurës civile i cili thotë që gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë tërësisht ose pjesërisht sipas kufirit të nenit 121, etj., etj., kur gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën. Kompetenca është e rregulluar normalisht tek neni 61 dhe 64, neni 64 ku rregullohen aspekte të ndryshme. Do ndaloj pak në mënyrë të veçantë tek neni 64 i cili është një nen i cili synon të parandalojë dhe të shmangë zvarritjet e gjykimit për shkakun e vetëm si gjykatat janë të paqarta për çështjet e kompetencës, qoftë lëndore, funksionale apo tokësore. Natyrisht është një shtojcë ose të themi një zbatim i nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e cila synon të shmangë vonesat në proceset gjyqësore, pikërisht jo duke marrë për bazë sjelljet e individit por duke shmangur vonesat e gjykatës pikërisht në interpretimin e gabuar të ligjit. Dhe në këtë sens ai ka vendosur pikërisht nenin 64 i cili kërkon që çështja që dërgohet për shqyrtim nga një gjykatë në një gjykatë tjetër të së njëjtës kategori ose nga një gjykatë më e lartë, duhet të pranohet të shqyrtohet nga gjykata të cilës i dërgohet. Pra kjo do të thotë që konflikti i interesave këtu rregullohet në vijë të drejtë, pra kur dy gjykata të të njëjtit nivel kanë konflikt kompetence, ata janë të detyruar që gjykimin ta vazhdojnë dhe konfliktin ta rregullojnë nëpërmjet Gjykatës së Lartë apo anasjelltas kur një gjykatë më e lartë e prish dhe e gjykon në gjykatën e rrethit, por kurrsesi që gjykata e rrethit të detyrojë gjykatën e një niveli më të lartë (siç është gjykata e apelit) të ushtrojë kompetencat e saj për një çështje që në bazë të nenit 134 të ligjit për kompensimin e pronave nuk e ka si kompetencë. Në këtë aspekt unë mendoj që t’ia lëmë këtë arsyetim gjykatës ta mbaroj dhe të mos ndalemi nëse është zgjidhur drejt,

pasi vetë, po të shikojmë tek Gjykata e Lartë, ka disa vendime që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Disa i kam gjetur unë, të cilat pikërisht në këtë aspekt kundërshtojnë arsyetimin me njëra-tjetrën. Pra këtu, aktualisht, Gjykata e Lartë duhet të ushtrojë funksionin e vet, të unifikojë këtë praktikë, se si zgjidhen këto raste. Por ne nuk jemi, të paktën, në bazë të ligjit, ta zgjidhim sepse po konkurrojmë mbi një gjykatë dhe nuk na takon ne të konkurrojmë arsyetimin e gjykatës, kur unë në opinionin tim, jam plotësisht dakord me atë që ka zgjidhur gjykata e apelit, sepse kështu do të veproja po të isha gjyqtar; për dy aspekte: e para, ligji e ka përcaktuar; e dyta, ne humbasim një shkallë gjykimi (në qoftë se unë e gjykoj si shkallë e parë, atij i kam mohuar shkallën e parë për atë çështje lëndore); pra kam cenuar një nga parimet më thelbësore dhe nuk mund të shkoj drejt asaj zgjidhjeje. Kështu që, këto konflikte unë them t’ia lëmë gjykatave të nivelit më të lartë t’i rregullojnë, sidomos asaj të lartës e cila duhet të ushtrojë pikërisht detyrën, duke unifikuar këto praktika të paqëndrueshme dhe të pazgjidhura dhe mund të them që vetë ligji 133 “Për kompensimin e pronave” është një ligj shumë dinamik saqë ka pasur ndërhyrje jo vetëm nga GJEDNJ-ja por aktualisht ne mund ta gjejmë atë subjekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese përsëri, pasi shpirti i ligjvënësit nuk po gjen rehat për të rregulluar këtë pjesë dhe nuk e ka rregulluar ashtu siç duhet rregulluar pjesën e pronësisë së ish-pronarëve dhe në këtë aspekt, përfundimisht unë do të isha për t’i shtuar edhe 5 pikë këtij kriteri, për ta çuar në 25 në total.

Pjesën e dytë e kam për “Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit” që është nga 6 në 12 dhe unë besoj nga eksperiencia që kemi kaluar deri tani, qoftë edhe së bashku, kemi konstatuar që me të vërtetë Gjykata e Apelit Shkodër, si të gjithë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm kanë qenë jo të mbytur por të shkatërruar nga humbja në trupat gjyqësore apo nga një ngarkesë shkatërruese, jo vetëm të lëndës që ata mbulonin, por ne i kemi çuar dhe i kemi deleguar për të mbuluar aktivitetet e gjykatave të tjera. Pra ka pasur një aktivitet jashtëzakonisht të dendur dhe si e tillë ngarkesa ka qenë e papërbalueshme dhe nuk mund të fajësojmë dhe afektojmë gjyqtarin sepse i është dashur një kohë me e madhe për të zbardhur apo për të trajtuar një vendimmarrje. Nuk mund të afektojmë gjyqtarin kur e dimë mirë shkakun sepse ka rrjedhur kjo zvarritje apo vonesë në arsyetimin e vendimeve. Edhe sot e kësaj dite po të shkojmë nëpër gjykata, me siguri

do të gjeni vendime të tilla, të cilat kërkojnë shumë kohë për t'u arsyetuar, por, pikërisht për efekt të volumit të madh të punës që mbulojnë këto gjykata. Edhe këtu propozoj nga 6 të paktën, të shkojë në 12 pikë.

Aspekt tjetër është edhe pjesa e pjesëmarrjes nëpër trajnime. E kam theksuar edhe më përpara që nuk është faji i gjyqtarit të cilit i mungon ftesa apo për shkak të ngarkesës, sfilimit në punë, nuk shkon nëpër trajnime sepse detyrimi i parë i tij është të shpallë vendime (bëhet fjalë për pikën 4/c/a). Ndërkohë që nga ato trajnime që ajo ka bërë duket që në 5 vjet ajo e ka përmbushur detyrimin. Ndërkohë që për pjesën, atë komponent 1-vjeçar që është në vlerësim, na rezulton si me pasaktësi, por që në fakt edhe këtë pjesë ne nuk duhet t'ia afektojmë apo t'ia ngarkojmë gjyqtarit si përgjegjësi sepse për vetë situatën që ndodhet sistemi gjyqësor, është e pamundur që gjyqtari, përveç edhe faktit që Shkolla e Magjistraturës nuk ka funksionuar në këtë vit 2020-2021, ose nuk ka funksionuar normalisht, për shumë shkaqe që s'kanë lidhje me vullnetin e drejtuesve apo të institucionit, por të pandemisë, dhe si e tillë edhe për këtë pjesë nuk mund të rëndojmë gjyqtarin pse këtë komponent të këtij 5-vjeçari nuk e ka mbuluar me trajnime, ndërkohë që në aspektin absolut të numrit ai rezulton ta ketë përmbushur. Ndoshta krijojmë edhe një standard me këtë, që të jemi pak më elastik në trajtimin e këtij problemi. Kështu që edhe këtu propozoj për 20 pikë, pra në totalin e 20 pikëve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Fjala për ju!

Irena Plaku: Atëherë, për sa i përket pikës së fundit që propozuat rritje në nivelin e 20 pikëve, unë atë e ngrita për diskutim. Domethënë unë propozimin e parë mbi atë nivel vlerësimi, pasur parasysh se aq të dhëna kisha dhe e ngrita për diskutim si çështje. Pashë që ju e keni këtë diskutim duke qenë se duhet vlerësuar kjo periudhë 5-vjeçare.

Për sa i përket kriterit tjetër konkretisht "Aftësia për të interpretuar ligjin", në fakt nuk i kam hyrë, siç e theksova edhe më sipër, nuk i kam hyrë asaj se çfarë ka shprehur Gjykata e Lartë, pasur parasysh objektin e padisë (se në fakt nuk kishte akte në dosje),

rezultonte që i përkiste çështja juridiksionit të gjykatës së shkallës së parë Shkodër, por mënyra se si procedohet. K.Pr.Civile ka ndryshuar së fundmi dhe ka parashikuar që nuk bëhet me konflikt kompetenca dhe thotë që edhe në rast se gjykata e shkallës së parë e shqyrton një çështje në themel duke mos pasur juridiksion ose kompetencë lëndore, thotë, gjykata e apelit nuk e prish çështjen në rast se e ka zgjidhur drejt, por ia evidenton gjyqtarit. Në këtë rast vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është detyrues për apelin por mënyrën si procedohet duhet të shkojë për konflikt kompetence sepse i ka shkuar si juridiksion fillestar dhe jo sipas nenit 467 (më fal, se nuk i mbaj mend shumë mirë dispozitat), duhet të shkonte në Gjykatë të Lartë (mendoj unë). Në fakt unë kam pyetur dhe në Gjykatë të Lartë lidhur me këtë në rast se ka praktikë... *(Ka ndërhyrje nga një anëtar pa mikrofon)*. Të lutem pra, çështje lidhur me këtë çështje për ligjin 133/2015 ka plot për kompetencë dhe ka qëndrime të ndryshme. Por nuk ka pasur asnjëherë çështje se si duhet të shqyrtojë gjykata. Nuk ka praktikë të Gjykatës së Lartë sepse nuk i ka shkuar çështja Gjykatës së Lartë. Janë prishur nga apeli dhe nuk i ka shkuar... prandaj nuk ka praktikë. Në fakt për këtë çështje nuk ka praktikë të Gjykatës së Lartë. Unë me aq sa kam pyetur e dija që... Gjithsesi, pasur parasysh se me çfarë niveli kemi vlerësuar... *(Ka ndërhyrje nga një anëtar pa mikrofon)*.

Ilir Rusi: Faleminderit për diskutimet e deritanishme.

Po zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Atëherë, lidhur me “Aftësitë profesionale”, për sa i përket treguesit të interpretimit të ligjit. Duke qenë se sot në praktikën gjyqësore ka dy praktika të ndryshme të mbajtura nga gjykata e apelit dhe nuk është vetëm vendimi i dhënë nga zonja {...}. Unë prandaj edhe e pyeta enkas për të parë qëndrimin e saj. Ka edhe vendime të tjera gjyqësore. Edhe pse Gjykata e Lartë në çështjet që i kanë shkuar për konflikt kompetence ka mbajtur qëndrim dhe ka rregulluar kompetencën, pra nuk ka thënë që nuk është në kompetencë të saj për të rregulluar kompetencën dhe ka vendosur se kush nga të dy gjykatat në konflikte të posaçme do kishte kompetencë. Për sa kohë nuk kemi një vendim njësoj në këtë gjë dhe është çështje që lidhet me bindjen e brendshme të

gjqtarit për mënyrën se si e zbaton ligjin, mendoj që, për të reflektuar parimin që ne nuk ndikojmë në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale, lidhur me këtë vendim.

Për sa i përket çështjes së arsytimit me vonesë të vendimeve gjyqësore, të gjithë jemi koshient për situatën në të cilën ndodhet sistemi gjyqësor edhe për ngarkesën shumë të madhe të gjykatave. Problemi është që afati është çështja e arsytimit të vendimeve gjyqësore është një afat i përcaktuar në ligj. Kemi gjithashtu një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese të cilat flasin për cenim të afatit të arsyeshëm dhe nga ana tjetër kemi edhe një rregullim në metodologji ku ne nuk mund ta rrisim më shumë shkallën e aftësisë së gjyqtarës më shumë se një nivel, e cila në këtë rast është zbatuar nga ana e relatores. Megjithatë, shkelja e afatit ligjor për arsytimin e vendimit rezulton në ditë shumë të vogla. Duhet të kemi parasysh edhe këtë gjë. Nuk është se është tejkaluar afati me më shumë... se deri në 60 ditë, mund të konsiderohet e pranueshme deri në 60 ditë.

Në qoftë se ne do të shikonim afatin 60-ditor, jo afatin 20-ditor, për gjykatën e apelit, deri diku për arsytimin e vendimeve, mund të arrinim në një nivel më të lartë se niveli që ke parashikuar? – kjo për ta parë këtë gjë.

Ndërsa për sa i përket trajnimeve, unë kam diskutuar edhe herë tjetër, unë mendoj që të gjithë gjyqtarët duhet të vendosen në pozita të njëjta dhe të barabarta. Për sa kohë ne në të gjitha vlerësimet 1-vjeçare i kemi bërë në të njëjtat standarde, duhet edhe këtë vlerësim, edhe gjyqtarët e tjerë janë penalizuar për këtë gjë dhe kanë qenë edhe kandidatë për në Gjykatën e Lartë. Nuk është vetëm zonja {...} në këtë rast. Është e vërtetë që ajo plotëson numrin e trajnimeve për një periudhë 5-vjeçare, por periudha e vlerësimit në këtë rast është një periudhë 1-vjeçare, dhe ligji nga ana tjetër parashikon që jo vetëm 30 ditë të plota në 5 vjet, por duhet edhe të kesh 5 ditë të plota në vit. Për shkak të këtij qëndrimi, edhe për një shkak tjetër që, me sa kam parë nga raporti (nuk e di nëse gabohem) ka pasur 30 orë mësim në Shkollën e Magjistraturës (32 orë mësimi), pra nuk shkon arsytimi që kam qenë e ngarkuar në punë dhe nuk kam shkuar dot në trajnim për 5 ditë, ndërkohë që ke shkuar për 32 orë mësimi në Shkollën e Magjistraturës. Është edhe ky diskutim.

Prandaj mendoj që për pjesën e trajnimeve, jam dakord me propozimin e bërë nga

ana e relatores, nuk mund të ketë rritje të pikëzimit.

Dakordësohem me zotin Toro për pjesën e parë për rritjen e pikëzimit për sa i përket kriterit të interpretimit të ligjit. Ndërkohë për sa i përket afatit pastaj, nëse mund të bëjmë një rillogaritje me afatin 60-ditor.

Irena Plaku: Të sqaroj?

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar” unë po jua përshkruaj të gjitha në fakt: konkretisht, tek civile të përgjithshme rezulton 69 ditë (pra më e gjatë se afati 20-ditor); tek civilet e përgjithshme pa palë kundërshtarë është 44 ditë (brenda afatit 60-ditor që ju propozoni); tek familjaret me palë kundërshtarë është 54 ditë (pra më poshtë se 60 ditë); tek marrëdhëniet e punës është 59.5 ditë (tek gjashtë dhjetëshja); tek krimet është 54 ditë; tek kundravajtjet është 56.5 ditë (po i them të gjitha që të jemi transparent); tek kërkesat penale në fakt koha mesatare është 16 ditë, është shumë e shkurtër dhe tek ato që nuk ka parashikuar afat ligjor ligji procedural është 43 ditë. I ka të gjitha, përveç njëres që është në civile të përgjithshme, që i ka kaluar 60 ditëshi, të tjerat i ka të gjitha brenda afatit 60 ditë, dhe është konkretisht tek njëra që është një afat 12 ditë dhe e ka kaluar vetëm me 2 ditë, tek njëra është për 34 ditë duke e kaluar afatin me 4 ditë, afatin e ankimit.

Unë i jam referuar vlerësimeve që janë bërë. Në qoftë se ju keni një propozim tjetër për 60 ditë.

Sa e propozove tek arsyetimi sepse nuk e kisha mendjen?

Brikena Ukperaj: Ideja ime ishte kështu. Në kushtet kur gjyqtarja në rastin konkret ka përballuar 1/3 e ngarkesës së gjykatës së apelit dhe kanë gjykuar vetëm 3 gjyqtarë, në kushtet kur gjatë kësaj kohe ka gjykuar edhe civile dhe penale, në kushtet kur afati për të arsyetuar vendimet penale është 60 ditë për çështjet komplekse por që në kushtet e ngarkesës mund të shkojë për të gjitha çështjet; duke pasur një mesatare të tillë dhe duke llogaritur kohën mesatare për çdo kategori çështjesh, mund të shkojmë në pikëzimin e 12 pikëve sipas propozimit të Albanit.

Ilir Rusi: Në vijim të diskutimeve, propozimeve të bëra dhe komenteve të bëra nga relatorja, atëherë janë tre propozime të bëra nga zoti Toro dhe dy propozime janë nga zonja Ukperaj, të cilat në tre prej tyre, dy janë të njëjta si nga zoti Toro dhe zonja Ukperaj. Konkretisht, po vazhdojmë tani me prezantimin e propozimeve dhe votimin e tyre. Tek rubrika “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” u propozua fillimisht nga zoti Toro një vlerësim nga 20 në 25 pikë, pra duke shtuar 5 pikë, propozim i cili është i njëjtë me propozimin e zonjës Ukperaj. Vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Atëherë, tek interpretimi i ligjit në fakt unë i qëndroj qëndrimit të mbajtur për sa i përket, për mua është një interpretim jo i drejtë i ligjit, por pasur parasysh që nuk ka një praktikë të unifikuar nga Gjykata e Lartë, në fakt nuk ka një praktikë të shprehur lidhur me këto gjëra, vlerësoj që të shkojmë në pikët maksimale me 25 pikë. I bashkohem.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord, jo vetëm për faktin që siç edhe e thanë edhe kolegët nuk ka një qëndrim të unifikuar nga Gjykata e Lartë lidhur me interpretimin e rastit konkret, por vlerësoj gjithashtu se jemi duke vlerësuar një gjyqtare që sikurse e thamë, në 2013-2016 ka një vlerësim shkëlqyer me aftësi, në lidhje me interpretimin e ligjit të shkëlqyera, ndaj mendoj që edhe nëse do diskutonim për një interpretim jo siç duhet të ligjit në këtë rast, vetëm një vendim mendoj që nuk duhet ta afektojë në këtë rast vlerësimin që Këshilli duhet t’i bëjë aftësisë interpretuese të gjyqtares. Kështu që edhe unë jam dakord me propozimin për ta vlerësuar me pikët maksimale.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(9 vota pro dhe 1 votë kundër. Miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Kalojmë tek propozimi i dytë i zotit Toro, e cila është tek rubrika e “Aftësive organizative të gjyqtarit”, pika A., “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, pika d. “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, ka një propozim për ta vlerësuar nga 6 në 12 pikë, pra duke shtuar 6 pikë. Është propozim i njëjtë edhe me propozimin e zonjës Ukperaj. Pra dy anëtarë, zoti Toro dhe zonja Ukperaj kanë të njëjtin propozim për t’u vlerësuar rubrika që sapo e përmenda, nga 6 në 12 pikë, duke u vlerësuar me një shtesë të pikëve prej 6 pikëve. Vazhdojmë me votimin e propozimit.

Irena Plaku: Atëherë, pasur parasysh që megjithëse një qëndrim i tillë është mbajtur dhe nga Këshilli në një vlerësim tjetër që është rritur me 2 nivele, duke qenë se kam vlerësuar në atë vlerësim që kam dalë kundër, i qëndroj përsëri propozimit duke dalë kundër këtij propozimi. Megjithëse, duke e rritur vetëm me një, pavarësisht se siç e theksuam më sipër, dalin thuajse të gjitha çështjet më pak se 60 ditë dhe natyra e çështjeve komplekse, domethënë që mund të shtyhet vlerësimi deri në 60 ditë. Gjithsesi unë i qëndroj të njëjtit qëndrim, me kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(8 vota pro dhe 2 votë kundër. Miratohet propozimi.)

Miratohet propozimi i bërë nga dy anëtarët, zoti Toro dhe znj. Ukperaj.

Ilir Rusi: Kalojmë tek propozimi i tretë i zotit Toro, që është tek rubrika “Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional”, konkretisht tek “Gatishmëria e gjyqtarit për t’u

angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale”, nga zoti Toro propozohet një vlerësim nga 4 në 20 pikë, pra me një shtesë prej 16 pikësh. Vazhdojmë me votimin e propozimit.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord, me arsyetimin se të njëjtin qëndrim kam mbajtur edhe tek zoti Çekrezi kur e kemi pasur në të njëjtat kushte, pavarësisht se atje kam propozuar që nga 4 pikë të shkojë në 16 pikë, duke mos qenë dakord me vendimin e KLGJ-së që nuk ka bërë përshkallëzim por ka kaluar në ekstrem nga 4 pikë në 20 pikë; tej atij propozimi i cili u rrëzua nga mbledhja plenare, i qëndroj, jam dakord me propozimin e zotit Toro. Faleminderit!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër sepse ky është qëndrimi që kam mbajtur edhe në raste të tjera analoge.

Marçela Shehu: Dakord sepse ashtu sikurse e tha gjyqtarja, e citoi edhe zoti Toro, ndonëse në 1 vit rezultoi që gjyqtarja nuk ka trajnime vazhduese, në 5-vjeçarin e vlerësimit (sikurse e pohoi edhe relatorja) ajo e ka përmbushur detyrimin e saj ligjor. Ndaj mendoj që ky moment nuk duhet ta penalizojë.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(7 vota kundër dhe 3 vota pro. Nuk miratohet propozimi.)

Nuk miratohet propozimi i tretë i zotit Toro.

Ilir Rusi: Atëherë, vazhdojmë me votimin total të projektvlerësimit, duke reflektuar edhe ndryshimet përkatëse sipas votimeve dhe miratimet e propozimeve që u bënë nga anëtarët dhe miratimin nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas rastit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord me propozimin.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2021”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2021”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shumë mirë”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t’u caktuar në një gjykatë në nivel apeli”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).
(shtyrë nga mbledhja e datës 08.11.2023).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 17:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI).**
- 6. Sarmela Titka dhe Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.**
- 7. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. Valbona Vata, gjyqtare.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t’u caktuar në një gjykatë në nivel apeli”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). *(shtyrë nga mbledhja e datës 08.11.2023).*

Ilir Rusi: Në vijim të këtij rendi dite, vazhdojmë në kronologji me pikën 7 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t’u caktuar në një gjykatë në nivel apeli” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator është zoti Kurushi. Shqyrtimi i kësaj çështjeje është shtyrë nga mbledhja e datës 08.11.2023, me kërkesë të zotit {...}.

Alban Toro: A ka mundësi?

Ilir Rusi: Po zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, për çështjen në fjalë, unë do të dëshiroja të konsultohesha me një dokument që e konsideroj të rëndësishëm dhe ndoshta përbën edhe standard të mbajtur më parë për KLGJ-në. Ka lidhje me nenin 4 të ligjit “Për qeverisjen”, i cili i ka dhënë status anëtarëve jogjyqtarë, në këtë komponent të këtij trupi administrativ. Do të ishte me vlerë nëse do të njihesha me përfundimet apo me vullnetin e ligjvënësit të ushtruar pastaj më pas me vendimmarrje nëpërmjet miratimit të legjislacionit përkatës.

Gjithashtu, marrë në konsideratë që edhe mbrojtja ka paraqitur të azhurnuar jo më vonë se dje (*parashtrime*), pra ka qenë një kohë e shkurtër dhe veprimtaria intensive e KZHK-së nuk na ka lënë kohë të merremi me studimin e çështjes në fjalë, kështu që në këtë aspekt unë do të kërkoja shtyrje për t’u njohur jo vetëm me vullnetin, por edhe me përmbajtjen e ankimit/e pretendimeve të kandidatit për gjyqtar dhe njëkohësisht të shpresojmë që midis nesh, në vendimmarrje, të kemi edhe Kryetaren që të formatojmë në mënyrë të plotë vendimmarrjen e KLGJ-së.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Propozoj që, meqenëse zoti Toro ka kërkuar kohë që të njihet me qëndrimin e Kuvendit në lidhje me përmbajtjen e relacionit që shoqëron nenin 4, posaçërisht ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, unë mendoj që ta shtyjme këtë mbledhje sepse nuk mund të vazhdojmë më tej me vijimin e relacionit përkatës për sa kohë një nga kolegët tanë kërkon kohë për t’u njohur me relacionin përkatës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Referuar kërkesës së bërë dhe standardit të mbajtur nga ky Këshill në këto raste, atëherë kjo çështje shtyhet për t’u shqyrtuar në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj çështjeje, por që kjo pikë nuk u shqyrtua por thjesht u shty për një mbledhje të ardhshme, pika 7 e saj, çështjet e tjera që janë pjesë e këtij rendi dite, janë çështje që për shkak të të dhënave që kanë, shqyrtohen me dyer të mbyllura.

Kështu që mbledhja do të vazhdojë, por në lidhje me të tretët, komunikimi “online” do të ndërpritet.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor